

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
НАУКИ SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSIT

FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE BASHKËKOHORE
ФАКУЛТЕТ ЗА СОВРЕМЕНИ ОПШТЕСТВЕНИ
FACULTY OF CONTEMPORARY SOCIAL SCIENCES



**CIKLI I TRETË – STUDIME PASDIPLOMIKE
DISERTACION DOKTORATURE**

TEZA :

**“ASPEKTET KUSHTETUESE TË VETQEVERISJES LOKALE NË VENDET E EUROPËS JUGLINDORE ME
FOKUS NË REPUBLIKËN E KOSOVËS”.**

Mentori:

Prof. Dr. Zemri ELEZI

Kandidati:

Dardan Vuniqi

Tetovë 2019

Mirënjohje dhe Falënderime

Të rënëve për lirinë e Kosovës,

*Fillimi i një sfide të re në jetë si ajo e Doktoraturës nuk është e lehtë, angazhimi dhe kushtet e mira shëndetësore janë parakusht për një sfidë të tillë dhe pikërisht për këtë në radhë të parë duhet falënderuar **ZOTIN** për mundësin të jem këtu, ku jam sot.*

Pastaj vlen për tu falënderuar mentori im shumë i çmuar Prof.dr Zemri Elezi i cili më përkrahjen e tij të vazhdueshme në çdo kohë nuk nguroj, në këshillat vërejtjet dhe mendimet e tij që unë sot ti tregojë arritjet e mija deri tanishme. I dashur mentor, nuk do ndalem që këto vepra të ua transmetojë brezave të rinjë, të përcjell një shembull që unë mësova nga këta njerëz të mirë.

Po ashtu, edhe pse nganjëherë nuk mundë ta shprehim se çka kemi në brendi jo që nuk duam po nuk gjejmë fjalë adekuate për të përmbledhur më një fjali të përkryer por unë kam vendosur më një thënie të falënderoj prof. Kadri Kryeziun, njeriun i cili ishte promotor i arritjeve të mija “Miqësia nënkupton ndarjen e ideve, mendimeve, nevojave, ndjenjave, ëndrrave, vlerave, kohës”. Faleminderit i nderuar Profesor që ndave çdo gjë me mua, që unë të jem këtu ku jam sot.

Falënderojë miqtë, mësuesit dhe gjithë profesorët e mi.

Dhe në fund edhe pse nga rëndësia është e para, një falënderim i thellë për familjen time të cilës i detyrohem shumë për fillimin dhe finalizimin e këtij udhëtimi, sa i vështirë aq edhe i bukur. Këtë falënderim për familjen e përmbylli me një thënie të rilindësit Sami Frashri; Nëse do të mbjellësh për një vit mbillni misër e grurë, nëse kërkon të mbjellësh përgjithmonë, mbill kulturë e arsim. Andaj ju faleminderit që zgjedhët këtë të dytën dhe në fund do të doja të falënderoja edhe motivuesit më të fortë të jetës sime e bashkëshorten dhe vajzën time.

Deklaratë e ndershmërisë

Unë Dardan Vuniqu, deklaroj se punimin tim të cilin e kam përfunduar, e kam shkruajtur në mënyrë të pavarur me përjashtim të pjesët të cilat përmbajnë edhe referencat përkatëse, punimi është tërësisht punimi im autorial dhe përmbajtja e këtij punimi është përgjegjësi e vet autorit. Më tutje deklaroj se në shkrimin e punimit kam respektuar rregullat etike të punës shkencore dhe Akademike të Universitetit.

*Ky material nuk mund të rishtypet, shumëzohet ose të përcillet në çfarëdo forme tjetër elektronike, të fotokopjohet ose të regjistrohet pa miratimin më shkrim nga autori **me përjashtim tek rastet e personave të Verbër.***

E nënshkruar:_____ **Nr.id-së**_____

Kandidati: Dardan VUNIQI

Tetovë 2019

Komisioni

Mentor

Prof Dr Zemri Elezi

Universiteti i Evropës Juglindore Tetovë

Anëtar

Prof Dr Etem Aziri

Universiteti i Evropës Juglindore Tetovë

Anëtar

Prof Dr Kadri Kryeziu

Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”, Prizren

Anëtar

Prof Dr Memet Memeti

Universiteti i Evropës Juglindore Tetovë

Anëtar

Prof Dr Abdulla Azizi

Universiteti i Evropës Juglindore Tetovë

Abstrakt

Disertacioni me temë: “ASPEKTET KUSHTETUESE TË VETQEVERISJES LOKALE NË VENDET E EUROPËS JUGLINDORE ME FOKUS NË REPUBLIKËN E KOSOVËS”, është rezultat i një pune disavjeçare kërkimore-shkencore. Për realizimin e këtij punimi është shfrytëzuar një literaturë e gjerë e autorëve të vendit dhe të huaj. E kemi thënë se trendi i zhvillimeve politike, ekonomike dhe shoqërore në botë, kohëve të fundit është duke rrjedhë në dy drejtime të kundërta, në njërën anë drejt globalizimit dhe në anën tjetër drejt lokalizimit. Kjo lëvizje e gjithëmbarshme e shoqërisë njerëzore ka ndikuar në masë të madhe edhe në ndryshimet e sistemeve të qeverisjes, në veçanti të qeverisjes lokale. Sendërtimi i koncepteve politike për mbrojtjen dhe afirmimin e të drejtave të njeriut, në veçanti krijimi i sistemeve konkurruese demokratike të ekonomisë së tregut në shërbim të rritjes së mirëqenies së qytetarëve të një vendi, ka krijuar parakushtet për zhvillime të hovshme të sistemeve politike dhe administrative në shërbim të qytetarëve. Secili vend në botë sot e ka pranuar decentralizimin si instrument politik demokratik për ta zbritë pushtetin e centralizuar të vendit sa më afër qytetarëve të vetë.

Ndërtimi dhe zhvillimi i sistemit të vetëqeverisjes lokale në vendet Evropës juglindore u bazua në parimet e vlerave evropiane për qeverisje lokale, por duke ia përshtatë nevojave dhe zhvillimeve politike të vendit. Derisa në shumicën e vendeve të rajonit dhe më gjerë ndërtohen sisteme duele të vetëqeverisjes lokale, Kosova zgjodhi sistemin e thjeshtë një shkallësh të VQL. Ky sistem përfaqësohet vetëm nga të zgjedhurit e qytetarëve të komunës përkatëse dhe pushteti qendror (PQ) nuk emëron përfaqësuesit e vetë në bashkëqeverisje. Qytetarët vullnetin për udhëheqjen e tyre për një mandat prej 4 vjetëve e delegojnë në dy organe të pushtetit lokal (PL): në kuvendin e komunës dhe në kryetarin e komunës. Pjesëmarrja e femrës në vendimmarrje në nivel lokal sa vjen e shtohet. Edhe pse kemi një pjesëmarrje të vogël kjo ngase si rezultat i pushteteve teknokratike në të cilat ndodhen vendet e Evropës Juglindore në këtë fazë.

Abstract

The dissertation on the subject of: "CONSTITUTIONAL ASPECTS OF LOCAL SELF-GOVERNMENT IN THE SOUTH EAST EUROPEAN COUNTRIES WITH A FOCUS IN THE REPUBLIC OF KOSOVO", is the result of several years of scientific research and work. An extensive literature of domestic and foreign authors has been used to carry out this work. As already mention the trend of political, economic and social developments in the World has recently been flowing in two opposite directions, on the one hand towards globalization and on the other hand towards localization.

This comprehensive movement of human society has also greatly influenced changes in governance systems, in particular local government. The incorporation of political concepts for the protection and promotion of human rights, in particular the creation of competing democratic systems of a market economy in the service of enhancing the well-being of the citizens of a country, has created the preconditions for the rapid development of political and administrative systems in the country to serve its citizens. Every country in the world today has accepted decentralization as a democratic political instrument to bring the country's centralized power closer to its citizens.

Establishment and development of the system of local self-government in the countries of Southeast Europe was based on the principles of European values of local government, but in accordance with the needs and political developments of the country. While dual systems of local self-government are being built in most countries in the region and beyond, Kosovo has opted for the simple one-fold system. This system is represented only by the elected citizens of the respective municipality and the central government does not appoint its own representatives in the co-government. Citizens delegate the will to govern for a mandate of 4 years to two local government bodies: the municipal assembly and the mayor. Women's participation in decision-making at the local level is increasing. Although still little participation, this is due to the technocratic powers in which the countries of Southeast Europe are at this stage.

PËRMBAJTJA

Struktura e punimit	12
Metodat e studimit	13
Hipotezat e hulumtimit është:	14
<i>Fjalët kyçe:</i>	15
Pyetjet kërkimore të punimit janë:.....	15
Rëndësia e problemit studimor	16
Kapitulli I	17
1. Vështrim i përgjithshëm i Qeverisjes lokale.....	17
Hyrje	17
Prejardhja dhe zhvillimi i qeverisjes lokale në botë	21
QEVERISJA LOKALE NË AMERIKË.....	23
ADMINISTRIMET E QYTETIT	24
<i>QEVERIA E QARKUT</i>	25
QEVERIA DHE QEVERISJA E FSHATIT DHE KOMUNITETEVE TË VOGLA.....	25
ADMINISTRIMET TJERA KOMUNALE.....	26
VETQEVERISJA LOKALE NË ANGLI.....	28
Vetëqeverisja Lokale në Francë.....	31
TRE NIVELET E QEVERISJES VENDORE	31
Komunat.....	32
Prefektët	34
RAJONET.....	35
MODELET E VETËQEVERISJES LOKALE.....	37
Sistemi Anglosanksion.....	37
Sistemi Kontinentale Evropiane-	37
Sistemi i botës së re (vendet e lindjes).....	38
Sistemi i përzier i vetëqeverisjes lokale.....	38
DECENTRALIZIMI I PUSHTETIT LOKAL.....	39
Decentralizimi politik	39
Decentralizimi administrativ.....	40

Dekoncentrimi.....	40
Decentralizimi fiskal.....	41
Parimet e qeverisjes lokale.....	43
Kapitulli II	45
Demokracia e drejtpërdrejtë dhe mekanizmat e pjesëmarrjes së qytetarëve	45
Informimi publik dhe konsultimi	45
E drejta e peticionit	46
Iniciativa e qytetarëve	47
Referendumi.....	48
Veçoritë e pushtetit lokal	50
1. Parimet themelore të pushtetit lokal	51
Kapitulli III	52
Aspektet krahasues në disa vende Evropës juglindore	52
Veçoritë e pushtetit lokal në Shqipëri.....	52
Komunikimi dhe informimi, konsultimi dhe kontrollimi i punës së organeve në nivel Qendror dhe Lokal	53
Njësitë e vetëqeverisjes Lokale në Republikën e Shqipërisë.....	54
Funksionet e Bashkive dhe Qarqeve dhe kompetencat e tyre.....	55
Financat e njësive të vetëqeverisjes lokale Bashkisë dhe Qarkut	56
Bashkitë financohen nga;	56
Qarqet financohen nga;	56
Struktura e organeve të vetëqeverisjes lokale	57
Kryetari i bashkisë	59
Përbërja e këshillit të Qarkut.....	59
Veçoritë e pushtetit lokal në Republikën e Maqedonisë Veriore	60
Kompetencat e komunave.....	61
Demokracia e drejtpërdrejtë dhe mekanizmat e pjesëmarrjes së qytetarëve në Republikën e Maqedonisë Veriore.....	62
Forma e pjesëmarrjes së qytetarëve realizohen përmes;	62
Struktura e Vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut	64
Veçoritë e pushtetit lokal në Republikën e Malit të Zi	67

Njësitë e Vetëqeverisjes lokale	67
Financat e komunës përbëhen nga	68
Struktura e Organeve Komunale.....	68
Pjesëmarrja e qytetarëve në vetëqeverisje lokale në Republikën e Maqedonisë Veriore	69
Kapitulli IV	71
Pozita kushtetuese dhe juridike e komunave në Kosovë	71
Organizimi i vetëqeverisjes lokale në Kosovë.....	72
Baza kushtetuese dhe ligjore e Vetëqeverisjes lokale.....	73
Njësitë e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës	74
Statusi ligjor i komunës	75
Aktet e Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit.....	77
Organizimi i brendshëm dhe organet e komunës.....	77
Kryetari i Komunës.....	79
Administrata Komunale	80
Demokracia e drejtpërdrejtë në vetëqeverisjen lokale në Kosovë	80
Kapitulli V	83
Aktet komunale dhe rishikimi juridik i tyre.....	83
Rregullorja e punës dhe rregulloret tjera komunale.....	84
MODELET E ASOCIACIONEVE NE DISA VENDE TE EVROPËS JUGLINDORE.....	85
Modeli i Shoqatave Shqiptare	86
Misioni dhe objektivat	86
Asociacioni i Komunave në Republikën e Kroacisë.....	89
Asociacioni i komunave në Republikën e Maqedonisë Veriore	91
Misioni i Bashkësisë së njësive të vetëqeverisjes lokale të Republikës së Maqedonisë së Veriut	91
Asociacioni i Komunave në Malin e Zi	93
Misioni i këtij asociacioni është.....	93
Asociacioni i Komunave të Kosovës	94
MISIONI.....	94
Asociacioni i bashkësive lokale në Serbska.....	96
Ka tre motive për këtë:.....	96

Asociacioni i Komunave Serbe në Kosovë.....	98
Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore aspekt krahasues me legjislacionin e Kosovës .	102
Historiku dhe Konteksti i studimit empirik	114
Pyetjet	115
Konkluzionet.....	135
Rekomandime	138
Bibliografia	142

Struktura e punimit

Punimi do të ketë një strukturë të veçantë të trajtimit duke marrë parasysh edhe natyrën e veçantë të punimit që ka të bëjë me ***“ASPEKTET KUSHTETUESE TË VETQEVERISJES LOKALE NË VENDET E EUROPËS JUGLINDORE ME FOKUS NË REPUBLIKËN E KOSOVËS”***.

Do të ketë këtë strukturë të përgjithshme: **pjesa hyrëse dhe V kapituj** të trajtimit të temës dhe në fund do të jetë përfundimi dhe literatura e përdorur.

Pjesa hyrëse e punimit do të na njoftojë në lidhje me trajtimin në pika të shkurtra të temës që do të shtjellohet. Në pjesën hyrëse gjithashtu do të trajtojmë objektin e studimit të kësaj materie, gjithashtu do ti përpunojmë metodat shkencore me anë të të cilave e kemi trajtuar këtë temë, si dhe strukturën e punimit pjesën ku jemi tani.

Siç e theksuam tringun e punimit e përbëjnë V kapituj të ndarë. *Në kapitullin e parë* në përgjithësi historiku i zhvillimit të vetqeverisjes lokale në botë Amerikë, Angli dhe Francë përfshirë etapat nëpër të cilat ka kaluar qeverisja lokale deri në këtë periudhë.

Në kapitujt në vijim do të trajtojmë në mënyrë të detajuar aspektin Kushtetues të organizmit të vetëqeverisjes lokale të vendeve të rajonit, Republikën e Shqipërisë, Maqedonisë Veriore, Mali të zi.

Në fund të punimit, kemi dhënë përfundimin e saj si dhe kemi përmendur të gjithë literaturën të cilën e kemi përdorur për të trajtuar këtë temë në mënyrë adekuate dhe me një qasje profesionale.

Metodat e studimit

Për sa i takon metodologjisë së studimit në këtë punim është përdorur metoda krahasimore dhe konsultimi me literaturën profesionale të lëmit të së Drejtës Kushtetuese, përfshirë këtu librat e disa autorëve të njohur të fushës së drejtës. Vështrimi mbi subjektin e temës është bërë në mënyrë përshkruese analitike duke përdorur edhe metodën e anketimit ballë për ballë.

Metoda e krahasuar si metodë e rëndësishme këtu luan rol të rëndësishëm pasi që pothuajse në pjesën më të madhe të punimit kemi bërë krahasimin qeverisjes lokale dhe aspektin Kushtetues dhe Ligjorë të saj. Në këtë rrafsh të trajtimit me metodën e krahasuar ne kemi dhënë një kontribut të rëndësishëm në punimin tonë, pasi që në shumë pjesë me një qasje të tillë të krahasuar kemi bërë shumë krahasime për mënyrën e rregullimit të një kategorie të caktuar nga ana e shumë legjislacioneve. Po ashtu edhe Metoda empirike është pjesë e pashmangshme e këtij punimi.

Edhe metoda shkencore historike zë vend të rëndësishëm për të trajtuar institucionet në këtë punim, është prezentë pasi që përmes kësaj metode kemi arritur në përfundim, në etapat dhe sakrificat të cilat i ka kaluar qeverisja lokale, duke i mënjeluar lëkundjet e shpeshta që kanë ndodhur në të kaluarën. Këto dy metoda konsiderohen si metoda të rëndësishme shkencore, të cilat janë përdorur në këtë punim, duke na ofruar një qasje adekuate profesionale. Duke mos harruar edhe metodën e analizës të Dokumentacionit ligjor në fushën e Qeverisjes Lokale përfshirë edhe strategjitë e Shteteve sa i përket avancimit të komponentës Lokale.

Hipotezat e hulumtimit është:

Krijimi i komunave me shumicë Serbe në Republikën e Kosovës është parë si një instrument shumë i rëndësishëm për fuqizimin dhe shtrirjen e autoritetit të qeverisjes vendore në pjesën e banueshme me komunitete.

- Hipotezat kryesore të hulumtimit janë:
- Supozohet se një numër i madh i faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm ndikojnë drejtpërsëdrejti në aspektet kushtetuese të lidhur me vetëqeverisjen në Evropën juglindore dhe Kosovë dhe kjo ndikon drejtpërsëdrejti në efikasitetin e punës së sajë në vendbanime.
- Hipotezat ndihmëse:
- 1. Supozohet se Komuna si bashkësi e banorëve të një territori të caktuar, përmes organeve dhe përmes administratës si dhe veprimtarive të organizuara publike, duhet të mundëson participimin qytetarë në vendimmarrje dhe plotësimin e nevojave të përditshme jetësore të qytetarëve në mënyrë më të plotë.
- 2. Supozohet se një numër i madh i projekteve rajonale dhe bashkëpunimi ndërkufitar, ndikojnë pozitivisht në ngritjen e kualitetit të jetës dhe zhvillimit ekonomik dhe ngritjen e performancës të vetëqeverisjes lokale.
- 3. Supozohet se vetëqeverisja lokale në vendet e EJT është e ndauarshme dhe si e tillë nuk ka shfrytëzuar sa duhet projektet e zhvillimore rajonale dhe fondet e ndryshme evropiane të cilat i dedikohen bashkëpunimit të ndërsjellë
- 4. Supozohet se organizimi dhe funksionimi i vetëqeverisjes lokale në Kosovë në të ardhmen duhet të përqendrohet në zhvillimin ekonomik rural dhe mbrojtjen e ambientit jetësor veçmas në qytete (oazat e gjelbëruara, hapësira publike, menaxhimi tokës ndërtimore etj).

Fjalët kyçe:

Shqipëri, Kosovë, Amerikë, Angli, Francë Maqedoni, Mal i zi, Qeveri, komunë, Administratë reformë, decentralizim, administrim, centralizim, legjislacion, asociacion.

Pyetjet kërkimore të punimit janë:

- Cilat janë sfidat e Qeverisjes Lokale në vendet e Evropës Juglindore?
- Cili është roli i politikës Qendrore në atë lokal?
- Cila është rruga që shtetet duhet ndjekur për harmonizimin e politikave lokale ndërshtetërore?
- A duhet rritur kompetencat vetanake për qeverisjen lokale?
- Si duhet zhvilluar koncepti i balancimit ndërmjet pavarësisë së pushtetit lokal dhe autoritetit qendror?

Rëndësia e problemit studimor

Problemi studimor i propozuar në këtë temë është:

“ASPEKTET KUSHTETUESE TË VETQEVERISJES LOKALE NË VENDET E EUROPËS JUGLINDORE ME FOKUS NË REPUBLIKËN E KOSOVËS”.

Trajtimi i kësaj teme është i një rëndësie të veçantë duke filluar nga mungesa e literaturës bazë në këtë fushë, përfshirë këtu edhe krizat e shpeshta në organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes lokale dhe mos koordinimit ndërmjet Kryetarit të komunës dhe Kuvendeve komunale, pjesëmarrjes së vogël së qytetarëve në vendimmarrje.

Qëllimi i këtij studimi është që të ofrojë një diagnozë fillestare mbi problemet e qeverisjes dhe administratës lokale në Evropës Juglindore dhe t’i sugjerojë disa opsione për përmirësimin e gjendjes.

Andaj ky punim nuk duhet konsideruar si një *studim gjithëpërfshirës* i të gjitha aspekteve të qeverisjes dhe administratës lokale, por si udhërrëfyes në disa fusha thelbësore të qeverisjes, administratës dhe financave komunale. Analiza jonë mundohet që po ashtu të vë në pah aspekte të tjera të qeverisjes lokale që kanë nevojë për studim më të thellë. Ky punim ka për qëllim ta ngris nivelin e *transparencës* së institucioneve komunale, të stimulojë qeverisje më të mirë dhe shërbime më të mira, si dhe të stimulojë konkurrencë të partive politike në nivel lokal. Nëse ky studim duket se prezanton një realitet kryesisht negativ të qeverisjes dhe administratës lokale në vendet e Evropës Juglindore në mënyrë të veçantë në Kosovë, kjo është sepse prioriteti ynë ishte identifikimi i pikave të fërkimit në sistemin ekzistues që kanë nevojë për përkujdesje urgjente dhe të sugjerojmë përmirësime efektive të këtyre problemeve. Kjo asesi nuk do të thotë që nuk bëhet punë meritore ose që nuk ka iniciativa pozitive në nivelin lokal. Ky punim synon të jetë i lexuar pikësëpari nga hartuesit kyç të politikave në nivelin qendror dhe komunal – qoftë nga strukturat vendore, qoftë nga ato ndërkombëtare.

1. Vështrim i përgjithshëm i Qeverisjes lokale

Hyrje

Në këtë punim të disertacionit do të trajtojmë temën **“Aspektet Kushtetuese të Vetëqeverisjes Lokale në disa vende të Evropës Juglindore në relacion me vetëqeverisjen lokale në Republikën e Kosovës”**. Qeverisja lokale nënkupton njërin nga të drejtat themelore të shoqërisë që në bashkësinë e caktuar territoriale dhe në mënyrë të pavarur të qeverisin punët e tyre, nëpërmjet organeve të cilat i zgjedhin vetë në mënyrë të drejtpërdrejtë¹. Si njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në disa shtete të Evropës juglindore përdryshim se është komuna, si hapësirë që iu takon të gjithëve që jetojnë në të. Aty të gjithë i gjejnë mundësitë dhe mjetet për t’i përmbushur nevojat e tyre ekonomike, dhe për të jetësuar të drejtat e tyre politike, shoqërore e mjedisore. Është vendi ku ndërtohen marrëdhënie solidariteti dhe merren përsipër detyrat e përbashkëta. Kështu Komunën e shohim si të kundërtën e së veçantës, sepse si e përbashkët ajo është e së përgjithshmes, si e drejtë, si interes dhe si e mirë publike. Komuna nuk diskriminon. E drejta për Komunën shkon përtej lirisë individuale për të pasur qasje në të mirat urbane: ajo është e drejta për ta ndryshuar vetveten dhe mënyrën e jetesës, duke e ndryshuar qytetin. Aty ku njerëzit janë bashkuar për të diskutuar mbi çështjet e qytetit, kemi parë edhe lindjen e bashkësisë politike. Hapësira e Komunës është vendi ku nis politika. Aty fillon të ndërtohet bazamenti i marrëdhënies midis qytetarëve dhe shtetit, por edhe midis vetë qytetarëve me njëri-tjetrin. Qytetarët e organizuar rreth çështjeve të përbashkëta janë garanti më i mirë për funksionimin e Komunës².

Duhet ditur se po thuajse, çdo shtet – në fakt ka një kushtetutë apo një sërë rregullat përmes të cilave pushteti ndahet ndërmjet nivelit qendror dhe atë lokal. Shumica e shteteve kanë

¹<https://shtetiweb.org/2012/09/06/ceshte-qeverisja-vendore/>, (qasur me datë 11.06.2018).

² https://www.vetevendosje.org/wp-content/uploads/2019/01/Deklarata_e_Komunes1494292699.pdf qasur me datë 10.06.2019

kushtetutën dhe si pjesë të saj një sërë rregullash që skicojnë mënyrat me të cilat ata i zgjedhin çështjet e tyre³.

Kushtetutat moderne sanksionojnë se kush është kompetent për zbatimin funksioneve kryesore të politikës qendrore dhe asaj lokale (si, të propozojë, të vendos mbi ligjet dhe t'i vërë ato në zbatim); përcakton se si duhet të zgjedhën strukturat e qeverisjes kombëtare dhe asaj lokale.

Me një kapitull të veçantë përcaktohen të drejtat dhe liritë themelore dhe garancie kushtetuese për mbrojtjen e tyre. Kushtetuta përcakton parimet baze të organizimit shtetëror, si ndarjen e pushteteve shtetërore, sundimin e ligjit, përgjegjësinë e atyre që e ushtrojnë pushtetin, si dhe funksionimin e Qeverisjes Lokale⁴.

Qeverisje lokale në vendet e Evropës Juglindore si parim nënkupton një qeverisje sa më afër Qytetarëve. Sipas fjalorit të Gjuhës së Sotme shqipe me Qeverisje Lokale nënkuptojmë: “Njësi administrative lokale, që përfshin zakonisht disa fshatra ose një krahinë; organ shtetëror lokal i një njësie të tillë; ndërtesa ku është vendosur ky organ (në disa vende të tjera; në të kaluarën edhe në Shqipëri). Tokat e komunës”⁵. Por termi qeverisje lokale apo vendore në Anglisht përdoret si Local Government, në Gjermanishte si Selbstverwaltung si dhe në vendet e lindjes së mesme si Mesnoe samouravljanje⁶.

Duhet theksuar se trendi apo rruga e zhvillimeve politike, ekonomike dhe shoqërore në botë, kohëve të fundit është duke rrjedhë në dy drejtime të kundërta, në njërën anë drejt globalizimit dhe në anën tjetër drejt lokalizimit⁷.

³Kadri Kryeziu E drejta Kushtetuese, fq 21 Prizren, 2017

⁴Philips Shively, “Hyrje në Shkencat Politike – Pushteti dhe Zgjedhja”, Tirane 2010, fq, 269-270.

⁵Fjalori i gjuhës së sotme shqipe (Online), <http://ëëë.shkenca.org/content/vieë/142/27/> (qasur me datë 7 Qershor 2008).

⁶Qeverisja Lokale, Njoftime themelore dhe shqyrtime Krahasonimtare, Agni Aliu dhe Esat Stavilevci Tetovë-Prishtinë 2009 fq 21

⁷<https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2018/03/ORGANIZIMI-DHE-FUNKSIONIMI-I-VETEQEVERISJES-LOKALE-NE-KOSOVE.pdf>. Qasur me datë (07 Qershor 2018).

Kjo lëvizje e gjithëmbarshme e shoqërisë njerëzore ka ndikuar në masë të madhe edhe në ndryshimet e sistemeve të qeverisjes, në veçanti të qeverisjes lokale. Se ndërtimi i koncepteve politike për mbrojtjen dhe afirmimin e të drejtave të njeriut, në veçanti krijimi i sistemeve konkurruese demokratike të ekonomisë së tregut në shërbim të rritjes së mirëqenies së qytetarëve të një vendi, ka krijuar parakushtet për zhvillime të hovshme të sistemeve politike dhe administrative në shërbim të qytetarëve⁸.

Fokusi i trajtimit të qeverisjes lokale për vendet e Evropës Juglindore, është tema kryesore e trajtimit në doktoratës specifike në bazë të kushtetutave të **(Kosovës, Shqipërisë, Maqedonia Veriore dhe Mali i zi)**, . Këto vende kanë një të kaluar të njëjtë historike dhe kanë ndjekur dhe ndjekin rrugë me nuanca të ndryshme në zhvillimin e Qeverisjes e në veçanti të Qeverisjes lokale.

Problemet ndëretnike ende mbetën barre në funksionimin e Pushtetit Lokal në disa vende të Evropës Juglindore, posaçërisht sa vijnë e shtohen për shkak të ndikimit të politikave Serbe. Shpërbërja e dhunshme e ish-Jugosllavisë ka lënë trashëgimi mosbesime dhe armiqësi të thella midis etnive shumicë dhe pakicë në shtetet e reja që u shfaqën nga ajo.

Përrjashtim nga kjo rregull është Shqipëria, ku marrëdhëniet ndëretnike midis shumicës shqiptare dhe minoriteteve greke, maqedonase dhe të tjera, janë relativisht të mira⁹.

Kjo nga se Republika e Shqipërisë ka një të kaluar më të largët historike me këto vende dhe ndikimi Komunistë ka qenë i theksuar. Pos kësaj, forcat fetare dhe etnike janë dobësuar nga ideologjia komuniste, që identitetit shoqëror i jepte parësi ndaj identiteteve primordiale¹⁰.

⁸Po aty fq 5

⁹Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave, PUNIM I POLITIKAVE Nr. 6/14 – DHJETOR 2014, fq 4

¹⁰Barjarba, Kosta, "Migration and Ethnicity in Albania: Synergies and Interdependencies," *Broën Journal of Eorld Affairs*, Vol. XI, Issue 1, Verë/Vjeshtë 2004, fq. 233.

Shih edhe Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave, PUNIM I POLITIKAVE Nr. 6/14 – DHJETOR 2014, fq 8.

Bazamenti kryesor i funksionimit të Qeverisjes lokale për shtete e Evropës juglindore është Karta për Qeverisje Lokale si dokument me relevante e cila e sanksionon Qeverisjen lokale si: “Autonomi vendore, ku kuptohet e drejta dhe aftësia efektive e bashkësive vendore për të rregulluar e për të drejtuar, brenda ligjit, nën përgjegjësinë e tyre dhe në të mirë të popullsisë së tyre, një pjese të mirë të çështjeve publike”¹¹.

Kjo kartë u rekomandon shteteve që në Kushtetutat e tyre të rregullohet funksionimi i Qeverisjes lokale me kapituj dhe me dispozita të veçanta normative.

Edhe **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**, i kushton rëndësi të veçantë qeverisjes lokale duke e përkufizuar si: Njësi themelore territoriale të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës komunitat¹².

Republika e Shqipërisë, e cila në kushtetutën e sajë, ka sanksionuar se qeverisja vendore ngrihet në bazë të parimit të *decentralizimit* të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore¹³. Ku më tej theksohet se: “Njësitë e qeverisjes vendore janë komunitat ose bashkitë dhe qarqet. Njësi të tjera të qeverisjes vendore rregullohen me ligj”¹⁴.

Me që pjesë e këtij studimi është edhe në **Republikën e Maqedonisë Veriore**, njësitë e administrimit lokal janë komunitat¹⁵, organizmi dhe funksionimi i tyre pastaj rregullohet me ligj.

Kurse pjesa e fundit do të jetë edhe funksionimi i qeverisjes lokale në **Malin e Zi**, e që më tej në Kushtetutën e saj theksohet se: “Forma themelore e vetëqeverisjes lokale është komuna”¹⁶.

¹¹Karta evropiane për vetëqeverisje lokale, 15 tetor 1985 neni r, fq 3.

¹²Kushtetuta e Republikës së Kosovës hyn në fuqi më 15 qershor 2008 FQ 150, NENIN 124.

¹³KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, Miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 të Kuvendit Popullor. Miratuar me referendum më 22.11.1998 Shpallur me dekretin nr. 2260, datë 28.11.1998 të Presidentit të Republikës, Rexhep Mejdani Ndryshuar me ligjin nr. 9675, datë 13.1.2007 Ndryshuar me ligjin nr. 9904, datë 21.4.2008. Neni 13 i Kushtetutës.

¹⁴KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, Miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 të Kuvendit Popullor. Miratuar me referendum më 22.11.1998 Shpallur me dekretin nr. 2260, datë 28.11.1998 të Presidentit të Republikës, Rexhep Mejdani Ndryshuar me ligjin nr. 9675, datë 13.1.2007 Ndryshuar me ligjin nr. 9904, datë 21.4.2008, neni 108 fq 21.

¹⁵Kushtetuta e Republikës Së Maqedonisë, Nr 08 4642/1 e datës 17 nëntor 1991 me amendamente të nenit Neni 114, paragrafi 5 i Kushtetutës së RM-së është zëvendësuar me Amendamentin XVI, pika 1. Neni 115, paragrafi 1 i Kushtetutës së RM-së është zëvendësuar me Amendamentin XVII, pika 1. Neni 117, paragrafi 2 i Kushtetutës së RM-së është zëvendësuar me Amendamentin XVII, pika 2.

Edhe pse Qeverisja lokale qoftë si fenomen qoftë si praktikë është e hershme por edhe në ditët e sotme studimi i saj paraqet një ndër fushat më të ndjeshme të praktikës dhe të interesimit shkencor në domenin kushtetues dhe ligjor¹⁷.

Prejardhja dhe zhvillimi i qeverisjes lokale në botë

Qeverisja lokale si disiplinë paraqitet me shumë tipare të veçanta, që nga lindja dhe gjatë zhvillimit të saj¹⁸. Qytetërimi i parë filloi në shtetet e qytetit të Egjiptit, Mesopotamisë, Indisë, Kinës, Meksikës dhe vendeve të tjera ku komunitetet e vogla ku edhe u lindën mbretëritë¹⁹. Por rrënjët e para të Qeverisjes lokale datojnë që nga Shtet-Qytetet Greke, kur themeloheshin kuvendet (“agra”) dhe këshilli i qytetit²⁰.

Me zhvillimin e qyteteve, zhvillohet dhe veprimtaria prodhuese në këtë vend. Me zhvillimin e kësaj prodhimtarie lindin raportet ndërmjet shteteve dhe me këtë rast vije deri te lindja e perandorisë Romake dhe Bizantine²¹.

Me lindjen e Romës së lashtë, e cila u krijua që nga viti (750 p.e.s – 509 p.e.s)²², fillon edhe krijimi i qyteteve të para, qytete këto të cilat krijuan edhe Asamblëtë Popullore (Comitia curiata)²³, të cilat janë formuar sipas lidhjeve farefisnore dhe klanore edhe pse në këtë periudhë ishte si karakteristik kryesore primitivizmi²⁴.

¹⁶Kushtetuta e Malit të Zi, të cilën e ka miratuar Kuvendi Kushtetues i Republikës së Malit të Zi, në mbledhjen e tretë të seancës së dytë të rregullt të vitit 2007, me datën 19 tetor 2007 Neni 114, fq 22

¹⁷Qeverisja Lokale, Njoftime themelore dhe shqyrtime Krahassimtare, Agni Aliu dhe Esat Stavilevci Tetove-Prishtine 2009 fq 7

¹⁸Qeverisja Lokale, Njoftime themelore dhe shqyrtime Krahassimtare, Agni Aliu dhe Esat Stavilevci Tetove-Prishtine 2009 fq 43.

¹⁹<http://www.worldhistorysite.com/r&fCivl.html> (qasur me date 11.06.2018)

²⁰Qeverisja Lokale, Njoftime themelore dhe shqyrtime Krahassimtare, Agni Aliu dhe Esat Stavilevci Tetove-Prishtine 2009 fq 49

²¹Po aty fq 49

²²Kadri Kryesiu e drejta Romake, Prizren 2017 fq 27.

²³Fjala “Curiata”, nënkupton mbledhjen e burrave

²⁴Kadri Kryesiu e drejta Romake, Prizren 2017 fq 35

Po ashtu lindja e qeverisjes lokale daton që në paraqitjen e Kushtetutave të para ne botë ku fillon ndarja e pushtetit Shtetëror në Legjislativ, Ekzekutiv dhe Gjyqësor. Çështja territoriale, administrative organizimit të shtetit është njëra prej çështjeve kyçe të qeverisjes së shtetit demokratik, e cila konkretizohet në decentralizimin e mirëfilltë si formë më demokratike²⁵.

Historia e Vetëqeverisjes lokale lidhet ngushtë edhe me Kushtetutën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Është fakt notor që Amerika është djep i lindjes së shteti dhe ndarjes së pushtetit: Shfaqja e qeverisë lokale amerikane përkonte me lindjen e qeverisë federale amerikane sipas Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara në 1789²⁶.

Edhe pse qeveria e qytetit amerikan tashmë ekzistonte në epokën koloniale britanike në Shtetet e Bashkuara, qeveritë lokale të epokës së hershme nuk ishin të organizuara dhe nuk ofruan shërbimet komunale ose shërbime të tjera²⁷.

²⁵E drejta Kushtetuese Botimi i pare, Prishtinë 2017, fq 401

²⁶*25 Maj 1787 :Konventa Kushtetuese hapet me një kuorum prej shtatë shteteve në Filadelfia.

*17 shtator 1787:Të gjitha 12 delegacionet shtetërore miratojnë Kushtetutën, 39 delegatët e nënshkruajnë atë nga 42 të pranishëm, dhe Konventa mbyllet zyrtarisht.

*21 qershor 1788:Kushtetuta hyn në fuqi pas ratifikimit nga shteti i nëntë(New Hampshire).

*4 mars 1789: Kongresi i parë sipas Kushtetutës mblidhet në New York.

*30 prill 1789: George Washington është inauguruar si Presidenti i parë i Shteteve të Bashkuara.

*8 qershor 1789: James Madison hodhi në propozim Kartën e të Drejtave në Dhomën e Përfaqësuesve.

*24 shtator 1789: Kongresi krijon një Gjykatë Supreme, 13 gjykatat e qarkut, tre ad hoc gjykatat e qarkut, si dhe pozicionin e Prokurorit të Përgjithshëm.

*25 shtator 1789: Kongresi miraton 12 amendamente dhe i dërgon ato në shtetet për ratifikim.

*15 dhjetor 1791: Virginia ratifikon Kartën e të Drejtave, dhe 10 nga 12 amendamentet e propozuara bëhen pjesë e Kushtetutës së SHBA.

*2 shkurt 1790: Gjykata Supreme mblidhet për herë të parë pas një përpjekjeje të pasuksesshme më 1 Shkurt,(një ditë më pas).

*4 mars 1789: Kongresi i parë sipas Kushtetutës mblidhet në New York.

*25 shtator 1789: Kongresi miraton 12 amendamente dhe i dërgon ato në shtetet për ratifikim.

²⁷ Van Riper 1983 ofron një vlerësim historik për shtetin administrativ të SHBA.

QEVERISJA LOKALE NË AMERIKË

Forma e parë moderne e shtetit administrativ amerikan ishte nën kujdesin Federalist-Jeffersonian midis 1789 (Uashington) dhe 1829 (Adams).

Në këtë epokë, procedurat administrative racionale të mbështetura nga Alexander Hamilton, të tilla si struktura hierarkike e departamenteve, sistemi i meritave, vendimmarrja racionale dhe sistematike dhe mbajtja e të dhënave, u prezantuan në qeverinë kombëtare dhe gjithashtu ndikuan në funksionimin e qeverive lokale.

Kështu, Tocqueville 2000 e konsideron *qeverisjen lokale si themelin e të gjithë qeverisë së lirë republikane dhe mbrojtjen e të drejtat e pakicave nga të gjitha kombinimet e mëdha politike*. Pas njohjes së rolit kritik të qeverisë lokale në shtetin administrativ të SHBA, Griffith dhe Adrian 1938 dokumentojnë shfaqjen dhe evoluimin e qeverive të hershme lokale. Bazuar në punën e mëparshme, autori i njohur Adrian shpjegon transformimin e qeverive lokale që u zhvilluan nga viti 1920 deri më 1945²⁸.

Qeverisja lokale sot në shtetet e Bashkuara të Amerikës organizohet në bazë të modelit Anglez me një game me te gjere te kompetencave nga ana e qyteteve ne raport me fshatra²⁹ te cilat janë të ndara në ***Qarqe, Qytete te mëdha, Komuna dhe qytete te vogla si dhe Rrethe shkollore dhe Rrethe Speciale***. Organizimi dhe funksionalizimi i saj behet ne kuadër të pushtetit Federativ njëherit konsiderohet edhe nder vendet me te mëdha me pushtet federativ.

²⁸ Adrian, Charles R. *A History of American City Government: The Emergence of the Metropolis, 1920–1945*. Lanham, MD: University Press of America, 1987.

²⁹ Osborne M. Reynolds, Jr., *Local Government Law*, 3rd ed. (St. Paul: West, 2009), 30.

ADMINISTRIMET E QYTETIT³⁰

Shtetet e Bashkuara kanë qenë kryesisht rurale, por sot është një vend shumë i urbanizuar. Rreth 80 përqind e amerikanëve sot jetojnë në qytete, qytete apo periferi urbane. Këto statistika tregojnë rëndësinë vendimtare të administratave të qytetit në sistemin e përgjithshëm të qeverisjes amerikane. Më shumë se në nivelin provincial apo shtetëror, qyteti është drejtpërdrejt në shërbim të popullit dhe u siguron atyre të gjitha shërbimet nga policia dhe zjarrfikësit mbi rregulloret shëndetësore, arsimin, transportin publik në strehim.

Administrimi i qyteteve amerikane është një çështje mjaft komplekse. Vetëm sa i përket popullsisë, Nju Jorku është më i madh se 41 nga 50 shtetet. Kjo është arsyeja pse shpesh pohohet se pozita udhëheqëse më e vështirë në vend, pranë zyrës së Presidentit, është zyra e kryetarit të Nju Jorkut³¹.

Komunat janë të autorizuar nga shtetet dhe kushtetuta e tyre përshkruajnë qëllimet dhe kompetencat e pushtetit vendor. Në shumë mënyra, qytetet punojnë në mënyrë të pavarur nga shtetet. Për shumicën e qyteteve të mëdha, puna me organizatat shtetërore është thelbësore për përmbushjen e nevojave të banorëve të tyre.

Në të gjithë vendin ekzistojnë forma të ndryshme të administratës së qytetit. Sidoqoftë, shumica e tyre kanë një lloj elektoral të këshillit qendror dhe një drejtor të administratës i cili ndihmohet nga drejtues të shumtë të departamenteve në menaxhimin e punëve të qytetit³².

Ekzistojnë tri lloje themelore të administratës së qytetit: kombinimi i kryetarit të bashkisë dhe këshillit të qytetit, komisionit dhe të ashtuquajturit *menaxher i qytetit*.

³⁰<https://usa.usembassy.de/etexts/outusgov/ch7.htm>

³¹City Hall New York , NY 10007

³²<https://usa.usembassy.de/etexts/outusgov/ch7.htm>

QEVERIA E QARKUT

Qarku është një qeveri rajonale dhe zakonisht përmban - por jo gjithmonë - të paktën dy qarqe administrative dhe disa komuna. Nju Jorku është aq i madh sa që ndahet në pesë qytete, secila me statusin e vet administrativ: Bronx, Manhattan, Brooklyn, Queens dhe Staten Island. Në të kundërt, Arlington County, Virxhinia, në të gjithë Uashingtonin nga lumi Potomac, është urbane dhe periferike, qeverisur nga një këshill i vetëm i qarkut.

Në shumicën e vendeve të Amerikës, ekziston një kryeqytet i qarkut ku ndodhen zyrat e qeverisë dhe ku takohen zyrtarët administrativë të bordit të këshillit të qarkut. Në rrethe të vogla përcaktohet bordi i drejtorëve të të gjithë rrethit, në rrethet individuale më të mëdha ose në komuna përfaqësohen nga bordet administrative të qarkut. Bordet ngrenë taksat, huazojnë dhe shpërndajnë fonde, përcaktojnë pagat e stafit të qarkut, monitorojnë zgjedhjet, ndërtojnë dhe mbajnë autostrada dhe ura federale dhe menaxhojnë programet e mirëqenies në nivel shtetëror dhe të qarkut.

QEVERIA DHE QEVERISJA E FSHATIT DHE KOMUNITETEVE TË VOGLA

Mijëra rrethe administrative janë shumë të vogla për administratën e tyre të qytetit. Ata janë konsideruar qytete të vogla dhe komuniteteve dhe për çështjet lokale të tilla si ndërtimi i rrugëve dhe ndriçimit të rrugëve, duke siguruar furnizimin me ujë, policisë dhe njësitë e zjarrfikësve, futja e rregulloreve lokale shëndetësore, mbledhja e mbeturinave, kanalizimit dhe forma të tjera të hedhjes së mbeturinave, mbledhja e taksave për të financuar të projekteve qeveritare dhe, së bashku me shtetin dhe qarkun, për të drejtuar sistemin shkollor lokal³³.

Administrata zakonisht i besohet një komiteti ose këshillit të zgjedhur, i cili mund të ketë një shumëllojshmëri emrash: *këshillit të qytetit ose këshillit bashkiak, këshillit të këshillit të qytetit, organit vetëqeverisës ose bordit administrativ*. Bordi mund të ketë një kryetar ose president i

³³ A publication of the U.S. Department of State, Office of International Information Programs, Copyright and Print Publications Team (IIP/T/CP). Links to other Internet sites should not be construed as an endorsement of the views contained therein

cili vepron si drejtor administrativ, ose ka një kryebashkiak të zgjedhur. Punonjësit e sekretarisë, arkëtarët, oficerët e policisë, zjarrfikësit dhe shërbyesit civilë në sektorin e shëndetësisë dhe mirëqenies mund të llogariten si administratorë.

Një aspekt unik i qeverisë lokale, që ekziston kryesisht në zonën e Nju-Angli, është "Asambleja e Qytetit". Një herë në vit, ndonjëherë më shpesh, sipas nevojës, votuesit e regjistruar të një qyteti takohen në publik për të zgjedhur zyrtarë, për të diskutuar çështjet e interesit lokal dhe për të miratuar ligje që ndikojnë në punën e administratës. Si një organ, ata vendosin për ndërtimin dhe rehabilitimin e rrugëve, ndërtimin e ndërtesave dhe objekteve publike, normat e taksave dhe buxhetin e vendit. Këshilli i qytetit, i cili ka ekzistuar për më shumë se dy shekuj, shpesh quhet një demokraci e drejtpërdrejtë në formën më të pastër, në të cilën pushteti qeverisës nuk delegohet, por ushtrohet drejtpërdrejt dhe rregullisht nga të gjithë njerëzit.

ADMINISTRIMET TJERA KOMUNALE

Strukturat qeveritare dhe administrative të vendit, shtetit dhe pushtetit vendor, të diskutuara këtu, nuk mbulojnë në tërësi të gjithë spektrin e njësive administrative amerikane. Zyra Federale e Regjistrimit të SHBA (pjesë e Departamentit të Tregtisë) ka më shumë se 84,955 njësi administrative në Shtetet e Bashkuara. Këto përfshijnë rrethet, komunat, shkollat dhe rrethet e veçanta.

Amerikanët sot mbështeten në qeveritë e tyre në një shumëllojshmëri rolesh; Detyrat që ata bënë vetë në vitet e hershme të Republikës. Gjatë epokës koloniale, kishte pak policë ose zjarrfikës edhe në qytetet e mëdha. Në atë kohë qeveria nuk siguroi dritat e rrugëve apo pastruesit e rrugëve. Për pjesën më të madhe, njerëzit ruanin pronën e tyre dhe kujdesen për nevojat e familjeve të tyre.

Kënaqësia e këtyre nevojave tani konsiderohet si përgjegjësi e të gjithë komunitetit dhe është marrë nga shteti. Edhe në qytete të vogla, detyrat e policisë, zjarrfikësve, ndihmës sociale dhe kujdesit shëndetësor ushtrohen nga shteti. Prandaj shuma e mahnitshme e përgjegjësive i

takon shtetit³⁴. Në këtë mënyrë sistemi i Qeverisjes lokale në Amerikë mbete model i një qeverisje të mirë dhe në interes të komuniteteve, llogaridhënia dhe transparencia janë në stadin më të lartë të zhvillimit duke krijuar hapësirë që qytetarët të kenë qasje edhe nëvendimmarrje përmes organeve të zgjedhura nga ta.

³⁴ *A publication of the U.S. Department of State, Office of International Information Programs, Copyright and Print Publications Team (IIP/T/CP). Links to other Internet sites should not be construed as an endorsement of the views contained therein*

VETQEVERISJA LOKALE NË ANGLI

Qeverisja lokale në Angli në të kaluarën historike është paraqitur si mjaft e ndërlikuar është një ndryshim gradual dhe evolucion që nga Mesjeta. Anglia nuk ka pasur kurrë një kushtetutë të shkruar formale, me të cilën administrata moderne (dhe sistemi gjyqësor) bazohet në precedent dhe rrjedh nga kompetencat administrative të dhëna (zakonisht nga Kurora) në sisteme të vjetra, të tilla si ato të shirës.

Koncepti i qeverisjes vendore në Angli përmbledhet në historinë e Anglosaksone, në Angli (rreth 700-1066), dhe aspekte të caktuara të sistemit të saj modern rrjedhin drejtpërsëdrejti nga kjo kohë; veçanërisht paradigma që qytetet dhe fshatrat duhet të administrohen veç e veç. Në këtë kontekst, sistemi feudal i futur nga Normanët, dhe mbase 300 vjet, mund të shihet si 'blip', përpara se modelet e mëparshme të administratës të rihapen.

Rritja dramatike e popullsisë dhe ndryshimi në shpërndarjen e popullsisë të shkaktuar nga Revolucioni Industrial kërkonte një reformë të ngjashme dramatike në administratën lokale në Angli, e cila u arrit gradualisht gjatë shekullit të 19-të. Pjesa më e madhe e shekullit të 20 u shpenzua në kërkim të një sistemi të idealizuar të qeverisjes lokale. Ndryshimi më i gjerë në atë periudhë ishte Ligji për Qeverisjen Vendore 1972, i cili rezultoi në një sistem uniform të dy niveleve të qarqeve dhe rretheve që u prezantuan në vitin 1974; megjithatë, valët e mëtejshme të reformës kanë çuar në një sistem më heterogjen në përdorim sot

Por Anglia që nga Sistemi i ri i qeverisjes vendore hyri në fuqi më 1 prill 1974, por në rast se uniformiteti ishte i shkurtër. Pasi që në këtë vit ishte bërë edhe heqja e këshillave të qarkut metropolitane. Ky sistem me dy nivele uniforme zgjati vetëm 12 vjet.

Në vitin 1986, këshillat e qarkut metropol dhe Greater London u hoqën sipas Ligjit të Pushtetit Lokal 1985. Kjo autonomi e rivendosur (në fakt statusi i vjetër i qarkut të qarkut) në lagjet metropolitane dhe Londër. Ndërsa heqja e Këshillit të Londrës së Madhe ishte shumë e

diskutueshme, heqja e MCC-ve³⁵ ishte më pak e vogël. Arsyeja e deklaruar e qeverisë për heqjen e MCC-ve, në dokumentin e saj të vitit 1983, duke e përmirësuar qytetin, ishte bazuar në efikasitetin dhe tejkalimin e tyre. Megjithatë, fakti që të gjitha këshillat e qarkut u kontrolluan në atë kohë nga Partia Laburiste e opozitës çuan në akuzat se heqja e tyre ishte e motivuar nga politika e partisë: sekretari i përgjithshëm i NALGO e përshkroi atë si një "manovër krejtësisht cinike"³⁶. Kjo krijoi një situatë të pazakontë ku shtatë qarqe administrativisht, kishin pushuar së ekzistuari, por zona nuk ishte aneksuar në asnjë qark tjetër. Prandaj qarqet metropolitane vazhduan të ekzistojnë si njësi gjeografike dhe jetuan një gjysmë ekzistencë në hije, pasi shërbimet të tilla si forca policore vazhduan ta quanin veten p.sh. 'Policia e Madhe e Mançesterit'. Kjo gjë krijoi konceptin e 'qarkut ceremonial'. Nga pikëpamja gjeografike dhe ceremoniale, Anglia vazhdon të përbëhet nga qarqet e themeluara në vitin 1974, me një ose dy përjashtime (shih më poshtë). Këto qytete ende kanë një nëntoger dhe sherif, dhe për këtë arsye zakonisht quhen qarqe ceremoniale³⁷.

Aktualisht në shumicën e Anglisë, ekzistojnë dy nivele të qeverisjes lokale - qarku dhe distrikti - me përgjegjësi për shërbime të ndara në mes të dy niveleve. Këshillat e qarkut mbulojnë të gjithë zonën e qarkut dhe sigurojnë rreth 80 për qind të shërbimeve. Brenda qarkut, ka disa këshilla rrethi që mbulojnë një zonë më të vogël dhe ofrojnë më shumë shërbime lokale³⁸. Si dhe ekzistojnë pesë lloje të autoriteteve lokale: këshillat e qarkut, këshillat e rrethit, autoritetet unitare, rrethet metropolitane dhe lagjet e Londrës³⁹.

Siç theksuam edhe më lartë se në shumë pjesë të Anglisë kanë 2 nivele të qeverisjes vendore:

- këshillat e qarkut
- qarkut, bashkisë ose këshillit të qytetit

³⁵Shkurtesa e këshillave të qarkut metropolitane

³⁶Angry reaction to councils Èhite Paper. The Times. 8 October 1983.

³⁷politics.co.uk Issue Brief and Jonathan Raële's ëebsite (qasur me date 12.06.2018)

³⁸<https://www.lgiu.org.uk/local-government-facts-and-figures/>(qasur me date 12.06.2018)

³⁹<http://www.politics.co.uk/reference/local-government-structure>(qasur me date 13.06.2018)

Në disa pjesë të vendit, ekziston vetëm një nivel (unitar) i qeverisjes vendore që ofron të gjitha shërbimet lokale. 3 llojet kryesore janë:

- autoritetet unitare në zonat e mbrojtura,
- Lagjet e Londrës.
- qytetet metropolitane⁴⁰.

Disa pjesë të Anglisë kanë një nivel të tretë të qeverisjes vendore. Këshillat e qytetit dhe të famullisë janë përgjegjëse për shërbime më të vogla lokale si parqet, qendrat e komunitetit, ndarjet dhe përmendoret e luftës.

Në të dy Uellsit dhe Skocinë ekziston një sistem i vetëm i qeverisjes vendore që ofron të gjitha shërbimet e qeverisjes vendore. Në Irlandën e Veriut ekzistojnë bashki të zgjedhur lokale, këshillat e qytetit dhe të rretheve të cilat ofrojnë shërbime si deponimi i mbeturinave, pastrimi i rrugëve dhe rekreacioni; megjithatë shumica e shërbimeve janë përgjegjësi e organizatave të tjera⁴¹.

⁴⁰<https://www.gov.uk/understand-how-your-council-works>

⁴¹<http://www.politics.co.uk/reference/local-government-structure>(casur me date 13.06.2018)

Vetëqeverisja Lokale në Francë

Franca ka të implementuar sistemin Centralistë të pushtetit lokal. Pasi që qeverisja lokale në Francë ka një histori të gjatë të centralizimit, 20 vitet e fundit kanë sjellë disa ndryshime rrënjësore. Në shikim të parë, sistemi mund të duket i ndërlikuar. Franca është një nga vendet e pakta në Bashkimin Evropian me katër nivele të qeverisjes - shteti ose qeveria qendrore, rajoni, departamenti dhe 'komuna'⁴².

Ligji i decentralizimit i 2 marsit 1982 dhe legjislacioni që përmbushi atë, shënoi dëshirën e qeverisë së Parisit për të ndryshuar balancën e pushtetit midis shtetit dhe autoriteteve lokale (qarqe, departamente dhe komuna). Ajo dha autonomi shumë më të madhe në vendimmarrje duke ndarë detyrat administrative dhe buxhetore ndërmjet autoriteteve qendrore dhe lokale.

TRE NIVELET E QEVERISJES VENDORE

Në Francë ekzistojnë tre nivele kryesore të administratës lokale: **komuna**, **departamenti dhe rajoni**. Këto janë dy rrethe në të cilat kryhen vendimet administrative në nivel kombëtar dhe autoritetet lokale me kompetenca të tyre. Ligjërisht, një autoritet lokal është një korporatë publike me emrin e saj, territorin, buxhetin, punonjësit etj., Dhe ka kompetenca specifike dhe një shkallë të caktuar të autonomisë kundrejt qeverisë qendrore. Përveç kësaj, ka territore jashtë Francës dhe organe rajonale (collectivités territoriales) me status të veçantë (Paris, Marsejë, Lyon, Korsikë, Mayotte dhe Saint-Pierre-et-Miquelon).

⁴²http://www.citymayors.com/france/france_gov.html (qasur me date 11.06.2018)

Komunat

Komuna, e cila daton nga 1789, është niveli më i ulët i hierarkisë administrative franceze. Franca kontinentale përbëhet nga 36,569 bashki (komuna) në 22 rajone. Përveç kësaj, ka 212 komuna në territoret franceze jashtë shtetit⁴³, shumë më tepër se ato që gjenden në vendet e tjera të Bashkimit Evropian.

Komunat janë zonat më të vogla administrative në Francë. Krijuar gjatë Revolucionit Francez⁴⁴, ata zëvendësuan famullitë ekzistuese historike para-revolucionare dhe qytetet e lira. Pas krijimit të komunës së parë në Paris në vitin 1789⁴⁵, komunat u krijuan (fillimisht në mënyrë spontane, por më vonë u përfshinë në ligj nga Asambleja Kombëtare) në të gjithë Francën⁴⁶.

Në Francë termi komuna zbatohet për të gjitha komunat pavarësisht madhësisë së tyre - 80 për qind e tyre kanë më pak se 1,000 banorë. Kjo situatë ka bërë që qeveria të inkurajojë bashkitë më të vogla të bashkohen për të formuar bashkësitë urbane (komunitetet urbaines) ose të grupojnë së bashku në asociacionet e disa komunave (syndicats intercommunaux). Përveç kësaj, ligji i 6 shkurtit 1992 sugjeroi forma të reja të bashkëpunimit për të racionalizuar administratën komunale duke marrë në konsideratë interesat e përbashkëta. Në të vërtetë, lidhjet më të ngushta shpesh nuk shkojnë më shumë se bashkimi i disa shërbimeve dhe bashkimet janë jashtëzakonisht të rralla, pasi që banorët dhe këshilltarët vendor shpesh mbajnë një ndjenjë të fortë identiteti me komunat e tyre.

Ashtu si departamenti dhe rajoni, komuna ka një organ vendimmarrës ose vendimmarrës (këshilli bashkiak) dhe një ekzekutiv (kryetari), i zgjedhur nga këshilli bashkiak. Numri i këshilltarëve komunal është proporcional me popullsinë. Zgjedhur për gjashtë vjet me votim të drejtpërdrejtë të drejtpërdrejtë, këshilltarët komunalë përcaktojnë udhëzimet për politikën

⁴³ Article by Jean Luc Igaut, mayor of Ancy, 2007, <http://ëëë.citymayors.com/mayors/french-mayors.html> (Çasur me date 11.06.2018)

⁴⁴ **RESOURCES:** FRANCE IN THE 1980s - John Ardagh. Pub: Penguin. | THE NEË REGIME - Isser Woloch. Pub: www. Norton & Co. | INSTITUT NATIONAL DE LA STATISTIQUE: www.insee.fr/fr/

⁴⁵ http://buyahouseinfrance.info/france_regionshistory.html, (qasur me date 11.06.2018)

⁴⁶ Sipas Institutit Kombëtar të Statistikave dhe të Çështjeve Ek+onomike (I.N.S.E.E.), numri i komunave në Francë metropolitane në janar 2010 ishte 36.570.

komunale, miratojnë buxhetin, menaxhojnë asetet komunale, veçanërisht ndërtesat dhe pajisjet e shkollave fillore dhe vendosin se si duhet të funksionojë administrata komunale.

Kryetari ka dy kapele, pasi ai ose ajo është edhe autoriteti i zgjedhur i komunës dhe përfaqësuesi i shtetit në të. Si shefi ekzekutiv i komunës, kryetari kryen vendimet e këshillit bashkiak. Si përfaqësues ligjor i komunës, kryetari propozon dhe zbaton buxhetin, siguron ruajtjen dhe menaxhimin e mjedisit natyror të komunës dhe ndërton trashëgiminë dhe lëshon leje ndërtimi. Kryetarët gjithashtu kanë kompetenca në të drejtën e tyre, duke qenë përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin publik dhe që kanë në dispozicion administratën komunale, të cilën ata drejtojnë. Si përfaqësues i shtetit, kryebashkiaku është regjistruar i lindjeve, martesave (në të cilat ai / ajo është zyrtarizuar) dhe vdekjeve dhe është një oficer i policisë 'judiciaire' dhe kështu ka të drejtë të ushtrojë kompetenca të veçanta në lidhje me represionin e krimit nën autoritetin e prokurorit publik. Së fundmi, ai / ajo është përgjegjës për detyra të ndryshme administrative përfshirë publikimin e ligjeve dhe rregulloreve dhe hartimin e regjistrit zgjedhor.

Veprat e kryetarit të komunës janë akte administrative unilaterale, në përgjithësi urdhra, ligjshmëria e të cilave i nënshtrohet një kontrolli nga gjykatat kur ato lëshohen nga kryetari i komunës si kryeshefi ekzekutiv i komunës dhe me miratimin e prefektit (shih më poshtë) të cilit kryetari është vartës kur duke vepruar në cilësinë e përfaqësuesit të shtetit.

Pra, kompetencat e komunës mbulojnë aktivitete që ndikojnë në jetën e përditshme të banorëve të saj. Shkurtimi i saj ekonomik dhe shoqëror, i kufizuar për dhënien e ndihmës për krijimin e vendeve të punës dhe ndihmën e familjeve në nevojë, është zgjeruar për t'iu mundësuar asaj që të luajë një rol të rëndësishëm në luftën kundër papunësisë dhe përjashtimit social dhe të angazhohet në mënyrë aktive në ristrukturimin ekonomik dhe zhvillimin e aktiviteteve të reja. Departamentet Janë 100 departamente në Francë, 96 në Francë metropolitane dhe katër jashtë (Martinique, Guadeloupe, Réunion dhe French Guiana). Themeluar në 1789, departamenti është zhvilluar nga një autoritet lokal i decentralizuar pjesërisht në një me fuqi të plotë të tij (që nga viti 1982). Ajo ka luajtur një rol të rëndësishëm në organizimin administrativ dhe gjeografik të vendit. Departamenti në thelb ka kompetencë në

shërbimet shëndetësore dhe sociale, punët e kapitalit rural, rrugët e departamenteve, dhe shpenzimet kapitale dhe shpenzimet operative të kolegjeve.

Prefektët

Për pothuajse 200 vjet (1800 deri në 1982), Prefektët rajonale mbanin pushtetin ekzekutiv në departamente, por ligji i marsit 1982 ndryshoi fuqitë e tyre. I emëruar nga qeveria, Prefekti është ende personi i vetëm i autorizuar për të vepruar në emër të shtetit në departament. Prefektët përfaqësojnë Kryeministrin dhe të gjithë anëtarët e qeverisë, ka autoritet mbi shërbimet e jashtme të shtetit në departament dhe siguron mbikëqyrjen administrative të autoriteteve lokale të departamentit.

Megjithatë, ligji i 2 marsit 1982 i dha autoritet ekzekutiv për departamentin për kryetarin e këshillit të përgjithshëm. Këshilli i përgjithshëm është organi vendimmarrës i departamentit. Ajo përbëhet nga këshilltarë të përgjithshëm të zgjedhur për një mandat gjashtë-vjeçar në një sondazh me shumicë votash me dy votime. Secili departament është i ndarë në kantone (Franca ka 3.500 kantone) që shërbejnë si zgjedhore për zgjedhjet. Zgjedhur nga këshilltarët për një mandat gjashtë-vjeçar, kryetari përgatit debatet e këshillit dhe zbaton vendimet e tij, duke përfshirë vendimet për çështjet buxhetore. Ai përfaqëson departamentin në nivel ligjor, drejton stafin dhe shërbimet e departamentit dhe së fundi, si personi përgjegjës për drejtimin e departamentit, ushtron kompetenca të caktuara policore në fushat e ruajtjes dhe autostradave të departamenteve (pa paragjykuar kompetencat e kryetarët e komunave dhe Prefektin në këto zona).

RAJONET

Franca ka 26 rajone, 22 në Francë metropolitane dhe 4 jashtë. Këto të fundit kanë një status të veçantë, duke qenë në të njëjtën kohë departamentet dhe regionet. Krijuar në vitin 1955 për të siguruar një kornizë për planifikimin rajonal të qytetit dhe vendit, rajoni u bë një autoritet lokal në vitin 1982. Sferat e tij kryesore të kompetencës janë planifikimi, planifikimi i qytetit dhe vendit, zhvillimi ekonomik, trajnimi profesional, ndërtimi, pajisjet dhe drejtimi shpenzimet e shkollave (lycées).

Organi vendimmarrës është këshilli rajonal, anëtarët e të cilit zgjidhen për gjashtë vjet. Ato ndihmohen nga një komitet ekonomik dhe social, i cili është një asamble konsultative e përbërë nga përfaqësues të bizneseve, profesioneve, sindikatave dhe organizatave të punonjësve të tjerë, organizatave vullnetare rajonale etj. Ky komitet duhet të konsultohet për përgatitjen dhe zbatimin e planet kombëtare, krijimin e planit të zhvillimit rajonal dhe udhëzimet kryesore për buxhetin rajonal.

Komisioni është gjithashtu i lirë të komentojë mbi çdo çështje rajonale ose, me iniciativën e kryetarit të këshillit të qarkut, çdo propozim ekonomik, social ose kulturor. Kryetarët e këshillit rajonal, të zgjedhur nga këshilltarët, janë autoriteti ekzekutiv i rajonit. Përgjegjësitë e tyre janë identike me ato të kryetarit të këshillit të përgjithshëm në fushat brenda sferës së kompetencës së rajonit.

Pra, ndërsa parimet bazë dhe strukturat nuk kanë ndryshuar dhe ekziston një dallim i qartë ndërmjet sferave të kompetencave të niveleve të ndryshme, legjislacioni i decentralizimit ka sjellë disa inovacione, veçanërisht në lidhje me mbikëqyrjen. Një shkallë e monitorimit ex post facto e veprimeve të qeverisë lokale është e nevojshme për të pajtuar faktin se autoritetet janë vetë-qeverisëse me nevojën për veprim të koordinuar brenda një shteti unitar dhe sigurojnë që parimi i barazisë së të gjithë qytetarëve të mos e anashkalojë interesat e përgjithshme të kombit në tërësi.

Ligji i Marsit 1982 gjithashtu bëri disa ndryshime në lidhje me financimin. Çdo transferim i kompetencës shtetërore tek një autoritet lokal duhet të shoqërohet nga një transferim i burimeve (kryesisht fiskale). Në praktikë, taksat vendore kanë tendencë të rriten. Reforma gjithashtu shtriu përgjegjësitë e kontabilistëve komunalë, departamentale dhe rajonale, duke u dhënë atyre statusin e shefit të kontabilitetit, përgjegjës direkt në thesarin. Së fundi, ligji i vitit 1982 u caktua në një gjykatë të re, në dhomën e auditimit rajonal, përgjegjësinë për një auditim të mëvonshëm të llogarive të autoriteteve lokale.

Procesi i decentralizimit ka ndryshuar thellësisht qeverisjen lokale në Francë. Sistemi i ri është padyshim më i kushtueshëm se sa i vjetër për *çantën* publike dhe ka çuar në një fragmentim të detyrave dhe objektivave, pasi autoritetet lokale veprojnë kryesisht në interesin e tyre dhe jo në interesin kombëtar. Megjithatë, decentralizimi po ndihmon për të siguruar që detyrat të kryhen në nivelin më të përshtatshëm të përgjegjësisë në të gjithë sektorët e jetës publike, duke sjellë kështu demokraci më të madhe në administratën dhe menaxhimin e vendit.

MODELET E VETËQEVERISJES LOKALE

Praktika botërore demonstroi disa lloje dhe forma të vetëqeverisjes lokale, të cilat ndryshojnë nga njëra tjetra nga shtrirja e ndikimit të autoriteteve të nivelit qendror në atë të vetëqeverisjes lokale⁴⁷:

Sistemi Anglosakson

Për këtë lloj modeli, një shkallë të lartë decentralizimi i funksioneve shtetërore në fushën sociale dhe ekonomike është tipike. Disa nga vendet të cilat përfaqësojnë këtë model SHBA, Kanada, Australi, Zelandë e Re dhe shumë vende të tjera me sistemin juridik Anglosakson, organet përfaqësuese lokale shërbejnë zyrtarisht si aktorë në mënyrë të pavarur brenda kompetencave të tyre, dhe nuk kanë nënshtrim të drejtpërdrejtë nga niveli qendror⁴⁸.

Sistemi Kontinentale Evropiane-

I njohur edhe si lloji francez i vetëqeverisjes lokale karakterizohet nga fakti se administrata kryesore dhe njësitë territoriale janë formacione lokale mirë të koordinuara me ato qendrore. Quhet modeli kontinentale evropiane për faktin se ky sistem komunal bazohet në modelin francez të qeveria lokale, në literaturën shkencore quhet 'modeli francez' dhe është e natyrshme në Francë, disa vende të cilat përfaqësojnë këtë model janë; Itali, Spanjë, Belgjikë, Hollandë, Poloni, Bullgari dhe Turqia, Senegali dhe vende të tjera. Ky model përfaqëson një 'piramidë hierarkike'. Ajo bazohet në një kombinim e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive zgjedhore të vetëqeverisjes lokale .

⁴⁷ Public Policy Research Center (PPRC), Office 401, 65, Kazybek bi str., 480091, Almaty.
<http://unpan1.un.org/intradoc/groups/public/documents/APCITY/UNPAN018209.pdf>

⁴⁸ Nakonechniy V.V., PhD in Political Sciences, assistant professor of the regional management and local self-government department Kharkiv Regional Institute of National Academy of Public Administration

Sistemi i botës së re (vendet e lindjes)

Lloji i pushtetit lokal të vendeve të lindjes i cili kryesisht përfaqësohet në tri nivele dhe ka filluar të pavarësohet nga ai qendror duke nxjerr ligje të posaçme të vetëqeverisjes lokale.

Sistemi i përzier i vetëqeverisjes lokale

Lloji i përzier i vetëqeverisjes lokale ka komponent të dy sistemeve ai më i ngjashëm është në disa vende (Austri, Gjermani, Japoni) një sistem të përzier lokal qeveria është determinuese, ky model ngjashmëri me të dy sistemet atë anglosaksonë dhe kontinentale, duke pasur veçori specifike, që sugjeron një lloj hibrid të sistemeve të kombinuara formave 'të përziara', 'hibride' të qeverisjes lokale.

Këto janë disa nga modelet e vetëqeverisjes lokale të cilat funksionojnë në kohën moderne, përsosja e këtyre sistemeve vetëm sa vjen e shtohet.

DECENTRALIZIMI I PUSHTETIT LOKAL

Decentralizimi dhe Reforma e Pushtetit Lokal Aktualisht trendët e zhvillimit të qeverisjes në botë, janë duke u zhvilluar në një masë të madhe dhe të shpejtë. Në njërin anë, në kuptimin e jashtëm, është duke shkuar drejt globalizimit dhe në anën tjetër, në kuptimin e brendshëm, është duke shkuar drejt lokalizimit apo fuqizimit të vetëqeverisjes lokale - Decentralizimit.

Në këtë kuptim, të gjitha vendet e botës kanë të ndërtuara sisteme të qeverisjes lokale në përputhje me zhvillimet politike, ekonomike dhe nevojat e qytetarëve.

Ngritja e të menduarit publik dhe presioni i lartë i komuniteteve lokale për pjesëmarrje më të madhe në procesin e vendimmarrjes, ka shkaktuar vendosjen e autoriteteve lokale ballë për ballë me kërkesa të reja⁴⁹. Përmbushja e kërkesave të komunitetit lokal po e sjellë nevojën e decentralizimit të qeverisjes nga pushteti qendror në autoritetet lokale.

Autoritetet lokale gjithnjë e më shumë po fitojnë liri të veprimit nga niveli qendror dhe në përgjithësi kanë pushtet që krijojnë burime nga të hyrat vetanake dhe që gjithashtu pranojnë ndihmë nga qeveria.

Në përgjithësi po përvijohen tri koncepte themelore të decentralizimit dhe të organizimit të

Decentralizimi politik

- Koncepti i parë ka të bëjë me llojin e **decentralizimit të orientuar në përfshirjen e komuniteteve në qeverisje**, që ndryshe quhet si **decentralizim politik** i cili synon t'u japë qytetarëve ose përfaqësuesve të tyre më shumë pushtet në vendimmarrjen publike. Shpesh lidhet me politikën pluraliste dhe qeverinë përfaqësuese, por gjithashtu mund të mbështesë demokratizimin duke u dhënë qytetarëve ose përfaqësuesve të tyre më shumë ndikim në formulimin dhe zbatimin e politikave. Te decentralizimit politik supozojnë që vendimet e marra me pjesëmarrje më të madhe të vendimmarrjes lokale qytetarët do të jenë më të informuara

⁴⁹Robin Hambleton: "Modernising Political Management in Local Governments", 37 URBAN STUDIES 931, 931 (2000).

dhe më relevante për interesat e tyre sesa ato të bëra vetëm nga autoritetet politike të nivelit qendror.

Koncepti nënkupton që përzgjedhja e përfaqësuesve nga juridiksionet lokale zgjedhore u mundëson qytetarëve të njohin më mirë përfaqësuesit e tyre politikë dhe u mundëson zyrtarëve të zgjedhur të njohin më mirë nevojat dhe dëshirat e zgjedhësve të tyre. Realizimi i Decentralizimit politik shpesh kërkon reforma kushtetuese apo statutore, zhvillimin e partive politike pluraliste, forcimin e legjislaturës, krijimin e njësive politike lokale dhe inkurajimin e grupeve efektive të interesit publik.

Decentralizimi administrativ

- Koncepti i dytë ka të bëjë me llojin i decentralizimit të orientuar në ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët, që ndryshe quhet si **decentralizim administrativ**. Decentralizimi administrativ kërkon të rishpërndajë autoritetin, përgjegjësinë dhe burimet financiare për ofrimin e shërbimeve publike ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes. Është transferimi i përgjegjësisë për planifikimin, financimin dhe menaxhimin e funksioneve të **caktuara** publike nga qeveria qendrore dhe agjencitë e saj në njësitë vartëse ose niveleve të qeverisjes.

Tre format kryesore të decentralizimit administrativ - dekoncentrimi, delegimi dhe transferimi - secili ka karakteristika të ndryshme.

Dekoncentrimi.

Dekoncentrimi - i cili shpesh konsiderohet si forma më e dobët e decentralizimit dhe përdoret më shpesh në shtetet unitare - rishpërndan autoritetin vendimmarrës dhe përgjegjësitë financiare dhe të menaxhimit midis niveleve të ndryshme të qeverisë **qendrore**.

Dekoncentrimi, thjesht mund të zhvendosë përgjegjësitë nga zyrtarët e qeverisë qendrore në ato lokale ose mund të krijojë një administratë të fortë në terren ose kapacitete administrative lokale nën mbikëqyrjen e ministrive të qeverisë qendrore.

Delegimi

Delegimi është një formë më e gjerë e decentralizimit. Përmes delegimit, qeveritë qendrore transferojnë përgjegjësinë për vendimmarrje dhe administrimin e funksioneve publike në organizata gjysmë-autonome që nuk janë tërësisht të kontrolluara nga qeveria qendrore, por në fund të fundit janë përgjegjëse për të. Qeveritë delegojnë kompetencat e tyre në ato lokale.

Transferim

Një lloj i tretë i decentralizimit administrativ është transferimi. Kur qeveritë i kalojnë funksionet, ata transferojnë autoritetin për vendimmarrje, financa dhe menaxhim në njësitë kuaze-autonome të qeverisjes vendore.

Decentralizimi fiskal

Përgjegjësia financiare është një komponent thelbësor i decentralizimit. Nëse qeveritë vendore dhe organizatat private do të kryejnë funksione të decentralizuara në mënyrë efektive, ata duhet të kenë të hyra të mjaftueshme për të marrë vendime brenda territorit të vetë.

Decentralizimi fiskal mund të marrë shumë forma, duke përfshirë:

- a) Vetëfinancimin ose rikuperimin e kostos përmes tarifave të lokale;
- b) Bashkëfinancimin ose bashkëprodhimin nëpërmjet të cilit niveli lokal marrin pjesë në ofrimin e shërbimeve dhe infrastrukturës nëpërmjet kontributeve monetare ose të punës;
- c) Zgjerimi i të ardhurave vendore nëpërmjet taksave të pronës ose shitjes, ose pagesave indirekte;
- d) Transferet ndërqeveritare që zhvendosin të ardhurat e përgjithshme nga taksat e mbledhura nga qeveria qendrore tek qeveritë lokale për përdorime të përgjithshme ose specifike; dhe
- e) Autorizimin e huamarrjes komunale dhe mobilizimin e burimeve kombëtare ose lokale përmes garancive të huave. Në shumë vende në zhvillim, qeveritë lokale ose njësitë

administrative kanë autoritetin ligjor për vendosjen e taksave, por baza e taksave është atë e dobët dhe varësia nga subvencionet e qeverisë qendrore ka qenë atë e rrënjësuar sa nuk bëhet asnjë përpjekje për ta ushtruar atë autoritet.

- Koncepti i tretë është përzierje e dy koncepteve, që është i orientuar në përfshirjen e komuniteteve dhe ofrimin e shërbimeve cilësore.

Në kushte të përshtatshme, të gjitha format e decentralizimit mund të luajnë rol të rëndësishëm në zgjerimin e pjesëmarrjes së komunitetit lokal në aktivitetet politike, ekonomike dhe sociale në vendet në zhvillim. Ku funksionon në mënyrë efektive, decentralizimi ndihmon në zbutjen e pengesave në vendimmarrje që shpesh shkaktohen nga planifikimi i qeverisë qendrore dhe kontrolli i aktiviteteve të rëndësishme ekonomike dhe sociale në nivel lokal.

Decentralizimi mund të ndihmojë në uljen e procedurave komplekse burokratike dhe mund të rrisë ndjeshmërinë e zyrtarëve qeveritarë ndaj kushteve dhe nevojave lokale.

Decentralizimi përkufizohet si procesi i kalimit të kompetencave politike, fiskale dhe vendimmarrëse nga niveli qendror i qeverisjes në nivel lokal⁵⁰. Koncepti i decentralizimit është koncept kompleks dhe shumëdimensional⁵¹. Në vendet e Evropës juglindore çdo ditë e më shumë shohim rritjen e decentralizimit. Por mungesa e unifikimit të decentralizimit fiskal ka shkaktuar dhe vazhdon të shkaktojë problem për qeveritë lokale. Kjo ngase të hyrat vetanake nuk mbulojnë as gjysmën e shpenzimeve dhe shpërndarja e mjeteve mbetet peng i vullnetit politik. Por decentralizmi di të jetë edhe kompleks te punët e standardizuara andaj Centralizimi dhe decentralizimi nuk janë "as-ose" kushte. Në shumicën e vendeve një ekuilibër i duhur i centralizimit dhe decentralizimit është thelbësor për funksionimin efektiv dhe efikas të qeverisë. Jo të gjitha funksionet mund ose duhet të financohen dhe menaxhohen në mënyrë të decentralizuar.

⁵⁰ Rethinking Decentralization in Developing Countries, fq 4

⁵¹ **Mr. Sc. Arben GASHI**, Magjistër i zhvillimit Lokal,

http://www.trepca.net/2005/08/050824_ag_decentralizim_apo_reforme_e_pushtetit.htm

Parimet e qeverisjes lokale

Vetëqeverisja lokale funksionon mbi bazën e parimeve të qeverisjes së mirë, transparencës⁵², efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre⁵³. Parimi i subsidiaritetit, Komunitat i ushtrojnë kompetencat e tyre sipas parimit të subsidiaritetit. Po ashtu parim shumë i rëndësishëm është edhe parimi *i Transparencës*⁵⁴, përmjet këtij parimi bëhet më e lehtë edhe qasja e qytetarëve në vendimmarrjen nga ana e nivelit lokal ngase tashmë në kohën moderne qeverisja lokale është një 'ofrues shërbimesh'⁵⁵ dhe jo një qeverisje e cila nuk mbështet në parimin e llogaridhënies siç ka ekzistuar në të kaluarën.

Transparenca e të dhënave, dhe procesi i vendimmarrjes brenda qeverisjes është një fushë e rëndësishme e cila mund të përmirësohet përmes përpjekjeve të transformimit digjital.

Duke treguar qytetarëve se çfarë po ndodh në komunën e tyre përmes platformave digjitale kjo mënyrë luan një rol të rëndësishëm në rritjen e ndjenjës së llogaridhënies dhe besimit që ekziston midis qytetarit dhe shtetit për çështjet të cilat janë esenciale për përmirësimin e mirëqenien e popullsisë e cila jeton në atë vend⁵⁶.

Qeveritë lokale mund ta bëjnë këtë në mënyra të shumta:

- a.) Kjo mund të bëhet duke krijuar një platformë elektronike në të cilën njerëzit mund të shohin punët të cilat realizohen brenda një dite, jave apo muaji në komunat e tyre
- b.) Shpërndarjen e "shënimeve javore" dhe broshurave përmes emailëve dhe rrjeteve sociale.

⁵²Korniza ligjore në Kosovë ofron mjaft hapësirë dhe mekanizma, të cilat komunat mund t'i shfrytëzojnë me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies së tyre kundruall qytetarëve. Megjithatë, zbatimi në praktikë i këtyre mekanizmave dallon nga komuna në komunë dhe në përgjithësi ato nuk kanë qenë në gjendje të përmbushin obligimet ligjore

⁵³Kushtetuta e Republikës së Kosovës hyn në fuqi më 15 qershor 2008 FQ 150, NENIN 123 fq 56

⁵⁴https://www.ca-ilg.org/sites/main/files/file-attachments/principles_of_local_government_public_engagement_kp_6.pdf qasur me datë 27.05.2019

⁵⁵<http://leofoley.com/principles-of-local-government.htm#.XOsIMYhKjIU> qasur me datë 27.05.2019

⁵⁶OECD Digital Government Project The impact of digital government on citizen well-being, GOV/PGC/EGOV(2019)2 <https://www.oecd-ilibrary.org/docserver/24bac82f-en.pdf?expires=1558917086&id=id&accname=guest&checksum=1297D9AE95E8AE0FF7D2D705C4F74266> çasur me dt 27.05.2019

Kjo formë mund të e informimit mund të bëhet në vazhdimësi gjatë gjithë vitit duke bërë publikimin e raporteve të veçanta për secilin vendbanim, lagje apo fshatë veç e veç .

Po ashtu të bëhet publike matja e performancës së nëpunësve, dhe realizimit të projekteve kjo formë ua mundëson qytetarëve të gjykojnë vetë efektivitetin e organeve të nivelit lokal.

Këto aktivitete janë të domosdoshme krahas përpjekjeve për të krijuar hapësirë për përfshirjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve në formimin e rezultateve të ndërlidhura.

Për më tepër, çështja e transparencës dhe llogaridhënies mund të zbatohet edhe për çështjet që më pak kanë ndikim të drejtpërdrejtë në publik.

Për shembull, përpjekjet për të luftuar mashtrimet dhe korrupsioni nuk është menjëherë e dukshëm për publikun por që do të ndikonin në jetën e qytetarëve në rastet kur Komunitat do të bënin publike dhënien e kontratave për realizimin e të mirave të qytetarëve.

Demokracia e drejtpërdrejtë dhe mekanizmat e pjesëmarrjes së qytetarëve

Informimi publik dhe konsultimi

Konsultimi publik është një nga mjetet kryesore rregullative të përdorura për të përmirësuar transparencën, efikasitetin dhe efektivitetin e vendimmarrjes në nivel lokal⁵⁷.

Konsultimi, në vete përfshinë: ***Informimin, konsultimin dhe participimin***⁵⁸. Këto forma vetëm sa ndihmojnë krerët komunal për një qeverisje sa më afër qytetarëve.

Realizimi i demokracisë së drejtpërdrejtë është njëra ndër format më të vjetra të pjesëmarrjes së qytetarëve për realizimin e interesave të tyre. Ndonëse kjo formë tashmë është fare pak e mundur ngase në shumicën e vendeve të botës zbatohet demokracia e tërthortë dhe konsultimi i qytetarëve përmjet demokracisë së drejtpërdrejtë realizohet vetëm në rastet kur kemi ndryshime të mëdha politike, juridike në një vend. Ngase në kohën bashkëkohore edhe me anë ***Informimit publik dhe konsultimit*** të qytetarëve nga ana e pushtetit lokal është kusht dhe obligim në raport me qytetarët. Por kjo mënyrë e konsultimit tashmë ka filluar të realizohet edhe përmes formave digjitale, madje kjo formë e informimit ka lehtësuar qasjen e një qytetarie aktive. Ngase Kulturat digjitale, teknologjitë e shekullit të njëzetë e një dhe fuqia e të dhënave po ndryshojnë mënyra në të cilën qytetarët përjetojnë shërbimet publike dhe rrisin pjesëmarrjen e qytetarëve në hapësirën ku ata jetojnë.

Ndonëse komunat kanë obligim ligjor të mbajë takime periodike me qytetarët të paktën 2 herë në vit e ndarë në dy pjesë të vitit⁵⁹ por nga studimi empirik i cili ndodhet në fund të këtij përfundimi kemi arritur të kuptojmë se pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje në nivel

⁵⁷ <http://www.oecd.org/mena/governance/36785341.pdf> qasur me datë 28.05.2019

⁵⁸ Po aty

⁵⁹ Ligji Për Vetëqeverisjen Lokale, neni 68 i datës 20.02.2008

lokal është fare e vogël. Kjo ngase qytetarët kanë zbehur mundësinë e realizimit të fjalës së tyre.

E drejta e peticionit

E drejta e peticionit u jep subjekteve të së drejtës, jo vetëm lirinë për të dalë dhe për të kundërshtuar padrejtësitë që ndiejnë, por gjithashtu jep atyre edhe fuqinë për të ndihmuar në ndryshimin e këtyre padrejtësive. Peticioni si njëri ndër parimet themelore të së drejtës është **një drejtë e qytetarëve për të kërkuar nga qeveria qendore apo lokale zgjidhjen e ankesave** dhe problemeve që ata ballafaqohen është edhe një e drejtë e garantuar me akte Kushtetuese dhe ligjore për të bërë një ankesë ose për të kërkuar ndihmën e qeverisë së tij, pa frikë nga ndëshkimi ose hakmarrja.

"Njerëzit kanë të drejtë të ankohen në vendimet apo edhe në mënyrën e qeverisjes por edhe të deklarohej në favor të ose kundër politikave publike, politika këto që prekin interesat e tyre. Peticioni si e drejtë dhe liri themelore ***përfshin të drejtën për të mbledhur nënshkrime në mbështetje të një kauze dhe për të lobuar në organet e nivelit qendror apo lokal për apo kundër politikave që aplikohen***⁶⁰. Një përkufizim më i thjeshtë i të drejtës për peticion, është "***e drejta për t'i paraqitur kërkesa qeverisë pa dënim ose ndëshkim***. Kjo e drejtë është e garantuar në Amendamentin e Parë të Kushtetutës së SHB-ve (1791)⁶¹".

Shikuar në kontekstin historik peticioni si e drejtë fundamentale ekziston që nga dokumentet e para të shkruara: Bill of rights apo i njohur si ligji për të drejtat i vitit 1689 dhe Peticioni i të drejtave në vitin 1628 si dhe nga Magna Karta Libertatum i viti 1215 si dhe nga Karta e Medinës. Kjo formë e realizimit të demokracisë së drejtpërdrejt, tashmë e drejta e realizimit të peticionit u zgjerua në të gjitha vendet e botës dhe kjo e drejtë u përket qytetarëve.

Mund të themi se peticioni si e drejtë fundamentale është garantuar edhe në vendet e Bashkimit Europian në një sërë konventash dhe akteve ndërkombëtare por edhe me Neni 44

⁶⁰<https://www.learningtogive.org/resources/right-petition-government>, qasur me datë 28.05.2019

⁶¹<https://www.freedomforuminstitute.org/first-amendment-center/> qasur me datë 28.05.2019

të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian kartë, siguron të drejtën e qytetarëve për të dërguar peticion në Parlamentin Evropian⁶².

E drejta e Peticionit është garantuar edhe me Ligjin për Qeverisjen lokale në Republikën e Kosovës ku me teje thuhet se “Çdo person apo organizatë me interes në komunë ka të drejtën e prezantimit të peticionit në kuvendin e komunës për çfarëdo çështje lidhur me përgjegjësitë dhe kompetencat e komunës. Kuvendi i komunës shqyrton peticionin në pajtim me statutin dhe rregulloren e punës”⁶³. Dhe në afat ligjor prej 30 ditësh Komuna është e obliguar tu përgjigjet qytetarëve. Në praktikën e përgjithshme në Republikën e Kosovës kemi hasur në disa peticione edhe pse në shumicën e tyre kanë hasur në “veshë të shurdhët”.

Iniciativa e qytetarëve

Është një instrument i pjesëmarrjes së qytetarëve në demokracinë e drejtpërdrejtë ku qytetarët mund të sugjerojnë ndryshime konkrete ligjore në çdo fushë, për dallim nga Peticioni në legjislacionin aktual në fuqi në shumicën e vendeve të Evropës juglindore lejon të drejtën për iniciativë të tilla ku qytetarët kanë të drejtë për të kërkuar nga Komuna apo bashkësia lokale ku ata jetojnë për të propozuar hartimin e rregulloreve komunale. 15% të qytetarëve të cilët jetojnë në atë komunë dhe kanë mbushur moshën 18 vjeçare dhe kanë të drejtë vote mund të marrin iniciativave për hartimin e një draft rregulloreje e cila më pastaj do të vendoset në kuvend komunal për tu shqyrtuar⁶⁴. Dhe në rastet kur ajo merr mbështetje nga Kuvendi Komunal pastaj fiton statusin e dokumentit të obliguar për territorin në të cilin nxjerrët. Por initiative qytetare është e realizueshme edhe vendet e bashkimit Evropian ku qytetarët kanë të drejtën e organizimit iniciativave dhe kjo realizohet kryesisht përmjet Komisionit Evropian. Organizimi i një initiative të tillë bëhet në çdo fushë, ku Komisioni Evropian ka fuqinë për të propozuar legjislacionin, si: mjedisi, bujqësia, energjia, transporti ose tregtia qytetarët mund të

⁶²Versioni i konsoliduar i traktatit të bashkimit evropian dhe traktatit për funksionimin e bashkimit evropian neni 44 fq 383. Ky botim përmban edhe Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, e cila është shpallur në Strasburg, më 12 dhjetor 2007 nga Parlamenti Evropian, Këshilli dhe Komisioni (GZ C 303, 14.12.2007, fq. 1).

⁶³Ligji Për Vetëqeverisjen Lokale, neni 69 i datës 20.02.2008

⁶⁴Ligji Për Vetëqeverisjen Lokale, neni 70 i datës 20.02.2008

marrin pjesë iniciativa të tilla dhe brenda një afati tre mujor do të marrin përgjigje konkrete dhe të detajuara dhe e njëjta u paraqitet Parlamentit dhe Këshillit të Evropës në disa raste i paraqitet vetëm këshillit dhe nëse një nismë e tillë miratohet pastaj ai bëhet ligj dhe të përkthehet në të gjitha gjuhët zyrtare⁶⁵.

Referendumi

Etimologjia e fjalës Referendum rrjedhë nga gjuha latine e cila mendohet se për herë të kuptimi i tij modernë është përdorur nga mesi i shekullit të XIX.

E që ka kuptimin *e një votim të përgjithshëm nga ana e elektoratit për një çështje të vetme politike e cila u është referuar atyre për një vendim të drejtpërdrejtë*⁶⁶.

Mendohet se emri dhe përdorimi i referendumit ka origjinën në kantonin Zvicëran të Graubunden dhe ishte përdorur në fillim të shekullit të XVI⁶⁷. I ngjashëm me referendumin është edhe Plebishiti i cili është përdorur edhe i cili fillimisht nënkuptonte një dekret të Këshillit Plebis (Plebei), asambleja popullore e Republikës Romake. Sot, një referendum mund të përmendet shpesh si një plebishit, por në disa vende dy termat përdoren ndryshe për t'iu referuar votave me lloje të ndryshme të pasojave ligjore. Për shembull, Australia përkufizon "referendumin" si një votë për të ndryshuar kushtetutën dhe "plebishit" si një votë që nuk ndikon në kushtetutë⁶⁹.

Referendumi mund të ndahet në dy lloje kryesore i cili pastaj mund të realizohet në formë të ndryshme por ndarja kryesore është në referendum të detyrueshëm dhe në referendum këshillues⁷⁰.

⁶⁵<http://ec.europa.eu/citizens-initiative/public/basic-facts> qasur me datë 27.05.2019

⁶⁶<https://www.merriam-webster.com/dictionary/referendum>, qasur me 28.05.2019

⁶⁷Barber, Benjamin R.. The Death of Communal Liberty: A History of Freedom in a Swiss Mountain Canton. Princeton University Press, 1974, p. 179.

⁶⁸Vincent, J.M.. State and Federal Government in Switzerland, Johns Hopkins University Press, 2009, p. 122

⁶⁹Green, Antony (12 August 2015). "Plebiscite or Referendum - What's the Difference". ABC. Retrieved 23 August 2015.

⁷⁰Vreese, Claes H. (2007). "Context, Elites, Media and Public Opinion in Reerendums: When Campaigns Really Matter". The Dynamics of Referendum Campaigns: An International Perspective. Palgrave Macmillan. pp. 2–3.

Në kohën moderne këndvështrimi politiko-filozofik referendumet mund të konsiderohen si shprehje e demokracisë direkte, por sot shumica e tyre kuptohen brenda kontekstit të demokracisë përfaqësuese pyetjet në referendum parashtrohen në atë formë që përgjigja të jetë me PO ose Jo.

Vendet e Evropës Juglindore, kanë një traditë të përdorimit të referendumit nga Mali i zi me datë 26.05.2019⁷¹, është organizuar një referendum me të cilin Mli i Zi, është ndarë nga Jugosllavia dhe ka fituar pavarësinë e tij me 55.5%, e këtë referendum e kanë njohur menjëherë pesë vendet e përhershme të këshillit të sigurimit⁷².

Referendumi është njëri ndër instrumentet më të rëndësishme në realizimin e demokracisë së drejtpërdrejt, pavarësisht se në kohën moderne shtetet qoftë në nivelin qendror apo lokal kanë përqafuar demokracinë e tërthortë. Në disa çështje të cilat janë të rëndësishme së veçantë për qytetarët atëherë me doemos duhet konsultuar edhe vullneti i tyre. Kosova, edhe në nivel lokal u epë mundësinë qytetarëve që rregulloret të cilat miratohen nga niveli lokal mund ti nënshtrohen referendumit⁷³. Edhe kuvendi i Komunës në afat prej 30 ditësh i jepe përgjigje. Por parimisht një referendum i tillë të jetë i mbështetur nga 10% të votuesve të regjistruar në atë komunë⁷⁴.

Mënyra e realizimit të referendumit në Kosovë mbetet sfidë në vete kjo nga shkakut se mungon edhe ligji për referendumin dhe mungesa e një ligji të tillë pa mundëson organizimin e një referendumi zyrtar i cili do të krijonte parakushte për deklarimin e vullnetit qytetar në nivel qendror apo lokal karshi zhvillimeve ekonomike dhe politike në vend.

⁷¹ Nohlen, D & Stöver, P (2010) Elections in Europe: A data handbook, p1372 ISBN 978-3-8329-5609-7

⁷²Referendum Commission of Montenegro at the Wayback Machine (archive index)

⁷³Ligji Për Vetëqeverisjen Lokale, neni 71 i datës 20.02.2008

⁷⁴Po aty 71.2

Veçoritë e pushtetit lokal

Funksionimi dhe veçoritë e Vetëqeverisjes lokale në vendet e Evropës Juglindore përfshirë edhe Kosovë rregullohen me Kushtetutë, me Ligje organike si dhe me ligje speciale. Organizimi dhe funksionimi i vetëqeverisjes lokale bëhet edhe në frymën e Kartës Evropiane për vetëqeverisje lokale. E cila në masë të madhe rrit autonomin e pushtetit lokal në raport me atë qendror. Pushteti lokal (Modern), karakterizohet me;

- **Sovranitet në zgjedhor;** Kjo u jep komunave të drejtën për të zgjedhur, angazhuar, promovuar dhe shkarkuar stafin.
 - **Sovraniteti organizativ:** Kjo përfshin të drejtën që komunat të organizojnë vetë mënyrën e funksionimit të administratës shtetërore.
 - **Planifikimin e strategjive dhe menaxhimin e territorit:** Kjo u jep komunave fuqinë për të organizuar dhe formuar territorin e komunës nën përgjegjësinë e tyre duke hartuar plane zhvillimore urbane (përdorimi i tokës dhe planet e ndërtimit).
 - **Sovraniteti legjislativ:** Kjo përfshin të drejtën për të miratuar aktet nënligjore të komunës, statutin dhe aktet të tjera juridike politike.
 - **Sovraniteti financiar:** Kjo i jep të drejtë komunave të jenë përgjegjëse për menaxhimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të tyre.
 - **Sovraniteti tatimor:** Kjo u jep komunave të drejtën për të rritur taksat (me kusht që kjo e drejtë të mos jetë revokuar nga ligji për taksat dhe tatimet)⁷⁵.
- Mbrojtje juridike Kushtetuese;** Komunat gëzojnë të drejtën për mbrojtje kushtetuese dhe ligjore për vendimet e nivelit qendror me atë lokal.

⁷⁵<https://germanlawarchive.iuscomp.org/?p=380#fn1> qasur me dt 07,05,2019

Parimet themelore të pushtetit lokal

Në shoqëritë bashkëkohore funksionimi i i sisteme të qeverisjes e në veçanti i pushtetit lokal mbështet në parimet të forta dhe në interesit dhe vlerave të komunitetit lokal dhe në interes të qytetarëve në nivel kombëtar.

Varësisht nga shkalla dhe rrethanat e zhvillimeve shoqërore e politike, vendet e ndryshme, përcaktojnë parime të ndryshme për qeverisjen e tyre në nivel lokal, por në përgjithësi zotërojnë disa parime themelore apo vitale nëpërmjet të cilave përcaktohet karakteri i qeverisjes, ashtu siç është konstatuar edhe në dokumentin vlerësues të kompetencave të katër vendeve anëtare të BE⁷⁶, sipas këtij dokumenti qeveritë e shteteve të vendeve duhet të udhëhiqen në bazë të këtyre parimeve: ***Proporcionalitetit, subsidiaritetit, diversitetit dhe fleksibilitetit.***

Në Republikën e Kosovës, qeverisja lokale është e bazuar *në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, subsidiaritetit, ofrimit të shërbimeve në mënyrë efikase dhe efektive, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre*⁷⁷.

Parimi i autonomisë lokale tani po zëvendësohet me parimin e vetëqeverisjes lokale, nga se autonomia po identifikohet si rrugë e federalizmit të njësive lokale dhe largimi nga interesi i drejtpërdrejt i qytetarit. Qeverisja lokale në Kosovë përpiket që t'i zbatojë në praktikë të gjitha këto parime të vendeve të BE por duke ia përshtat rrethanave aktuale⁷⁸.

⁷⁶OECD, SIGMA, BE: "Assessing Competencies and Functions to Local Self – government, a comparative review", UNED, Madrid 2005.

⁷⁷"Kushtetuta e Republikës së Kosovës", neni 123, pika 4 dhe LVQL, neni 15

⁷⁸<https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2018/03/ORGANIZIMI-DHE-FUNKSIONIMI-I-VETEQEVERISJES-LOKALE-NE-KOSOVE.pdf> çasur me datë 30.05.2019

Aspektet krahasues në disa vende Evropës juglindore

Veçoritë e pushtetit lokal në Shqipëri

Shqipëria si një vend i pavarur që nga viti 1912, ka filluar edhe krijimin e institucioneve qendrore dhe atyre lokale por deri në vitet e 90, Shqipëria është përballur me një proces të centralizuar të vendimmarrjes. Shqipëria në vitin 1992, ka filluar organizimin e zgjedhjeve të lira⁷⁹. Megjithëse vitet e para të organizimit të strukturave lokale po thuhet të tëra kanë qenë të shpërndara në çështje të decentralizimit politik. Megjithatë me kushtetutën e vitit 1988⁸⁰.

Fillojë të krijon një hapësirë të re nën petkun e një demokracie të mirëfilltë dhe në respektim të akteve ndërkombëtare.

Republika e Shqipërisë, e cila në kushtetutën e sajë, ka sanksionuar se qeverisja vendore ngrihet në bazë të parimit të *decentralizimit* të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore⁸¹. Organizimi i vetëqeverisjes vendore në Shqipëri është i rregulluar në “Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë Komunitat⁸² ose bashkitë dhe qarqet, të cilat realizojnë vetëqeverisjen vendore në Republikën e Shqipërisë⁸³”. Funksionimi i qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë është i rregulluar me ligj të veçantë dhe me akte të tjera nënligjore akte këto të cilat janë në frymën e Kartës Evropiane të vetëqeverisjes lokale⁸⁴. Aktualisht organizimi i qeverisjes lokale në Shqipëri është i ndarë në dy nivele në Bashki dhe Qarqe të cilat mundësojnë funksionimin e Qeverisjes lokale.

⁷⁹Disertacion Politikat dhe instrumentat e zhvillimit lokal Oriona Muçollari, fq 3

⁸⁰Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr.8417, datë 21.10.1998)

⁸¹KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, Miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 të Kuvendit Popullor. Miratuar me referendum më 22.11.1998 Shpallur me dekretin nr. 2260, datë 28.11.1998 të Presidentit të Republikës, Rexhep Mejdani Ndryshuar me ligjin nr. 9675, datë 13.1.2007 Ndryshuar me ligjin nr. 9904, datë 21.4.2008. Neni 13 i Kushtetutës.

⁸²Po aty neni 108

⁸³LIGJ Nr. 139/2015 PËR VETËQEVERISJEN VENDORE Në mbështetje të neneve 13, 78, 81, pika 2, 83, pika 1, dhe 108 – 115 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave neni 5.

⁸⁴Karta Evropiane e veqeverisjes Lokale u nënshkrua nga Shqipëria më 27.05.1998 dhe u ratifikua me 04.04.2000.

Republika e Shqipërisë ka bërë progres të dukshëm, në respektimin e standardeve dhe parimeve ndërkombëtare. Marrëdhëniet ndërmjet institucioneve në qeverisjen lokale në Shqipëri bazohen në bazë të parimeve si: subsidiaritetit, të konsultimit dhe të bashkëpunimit për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta⁸⁵. Respektimi i këtyre parimeve mund të themi se krijon parakushte të mira për ushtrimin e autoriteteve në interes dhe të mirë të qytetarëve.

Komunikimi dhe informimi, konsultimi dhe kontrollimi i punës së organeve në nivel Qendror dhe Lokal

Raporti ndërmjet organeve të nivelit lokal më atë qendror është mirë i koordinuar, organet e nivelit lokal përmes raporteve periodike u përgjigjen pushtetit qendror, po ashtu edhe organet e nivelit qendror janë të obliguar në ndihmë në lidhje me situatat në të cilat pushteti lokal⁸⁶.

Qeverisja qendrore realizon konsultim me njësitë e qeverisjes vendore për politikën publike dhe legjislacionin që mund të kanë ndikim në punët e vetëqeverisjes lokale. Niveli lokal këto konsultime i kryen përmjet përfaqësuesve apo edhe shoqatave përfaqësuese vendore, struktura dhe mënyra e organizimit në lidhje me konsultimit përcaktohet me vendim të këshillit të ministrave. Kjo mënyrë e komunikimit vënë në pah rritjen transparencës dhe llogaridhënies së ndërsjellët të institucioneve madje, madje rrit edhe efikasitetin e një qeverisje model për vendet e rajonit. Kontrolli i punëve në nivel lokal ushtrohet përmes kontrollit hierarkie dhe instancional. I cili jo rrallë herë, i nënshtrohet edhe kontrollit të detajuar financiar. Vendimet të cilat merren nga niveli lokal i nënshtrohen dhe procesit të ligjshmërisë nga autoritet e përcaktuara me ligje të veçanta.

Funksionet dhe kompetencat e pushtetit lokal në Republikën e Shqipërisë

Njësitë e vetëqeverisja lokale në Shqipëri ushtrojnë; Funksione, kompetenca si dhe funksione të deleguara⁸⁷. Këto lloj kompetencash janë kompetenca të garantuara me ligj ndërsa

⁸⁵ LIGJ Nr. 139/2015 PËR VETËQEVERISJEN VENDORE Në mbështetje të neneve 13, 78, 81, pika 2, 83, pika 1, dhe 108 – 115 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave neni 10.

⁸⁶ Po aty neni 11,12,13.

kompetenca të tjera mund të delegohen nga pushteti qendror me anë të akteve të tjera ligjore të gjitha funksionet e deleguara duhet të kenë edhe delegim financiar në mënyrë që të bëhet realizimi i tyre.

Vetëqeverisja lokale në Shqipëri ushtron funksionet e veta në mënyrë krejtësisht të pavarur duke u mbështetur në Kushtetutë, Kartën Evropiane të qeverisjes lokale dhe legjislacionin në fuqi. Ushtrimi i funksioneve në nivel lokal bëhet mbi bazën e politikave kombëtare dhe i fqinjësisë së mirë me vendet e rajonit duke u mbështetur në krijimin e një qeverisjes sa më afër qytetarëve për në situatat kur qeverisja lokale nuk arrin të zotërojë fonde të mjaftueshme për realizimin e funksioneve të veta atëherë ajo kërkon fonde nga niveli qendro. Apo përmes huas nga institucionet financiare ndërkombëtare⁸⁸.

Njësitë e vetëqeverisjes Lokale në Republikën e Shqipërisë

Realizimi i vetëqeverisjes lokale në Republikën e Shqipërisë ushtrohet nga Bashkitë dhe Qarqet. Bashkia është organ i cili përfaqëson unitetin administrativo-territorial dhe bashki banorësh dhe njeherit është bazë e vetëqeverisjes lokale⁸⁹. Bashkia përbëhet nga disa njësi administrative, sipas lidhjeve tradicionale, historike, ekonomike dhe sociale.

Të gjitha bashkitë kanë edhe organet e veta përfaqësuese të cilat kryejnë veprime në emër dhe llogari të bashkisë.

Për dallim nga Bashkia, Qarku është nivel i dytë i vetëqeverisjes lokale.

Njësitë administrative përbëhen nga qytetet dhe fshatrat, qytetet mund të ndahen në njësi të vogla të cilat edhe emërtohen si lagje. Një lagje mund të krijohet vetëm pasi që në atë territor me mbi 20 mijë banorë. Organet përfaqësuese në Bashki është Këshilli bashkiak, ndërsa organ

⁸⁷Po aty neni 21

⁸⁸Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore dhe raporti shpjegues Traktate dhe raporte Botimi në frëngjisht: Charte européenne de l'autonomie locale et rapport explicatif ISBN 92-871-0859-5 Botim i Këshillit të Evropës F-67075 Strasbourg Cedex ISBN 92-871-0860-9 Këshilli i Evropës, 1986 Riprintuar në vitin 1996, mars 1998, tetor 1998, tetor 1999 Botuar në Këshillin e Evropës neni 9 paragrafi 8

⁸⁹LIGJ Nr. 139/2015 PËR VETËQEVERISJEN VENDORE Në mbështetje të neneve 5,6,7,8.

ekzekutiv i bashkisë është kryetari i bashkisë. Ndërsa në Qar, organ përfaqësues është këshilli i qarkut ndërsa funksionet ekzekutiv në Qark kryhen nga Kryetari dhe klshilli i qarkut.

Organet e vetëqeverisës lokale në Shqipëri kanë të drejta dhe detyrime, pasi që gëzojnë statusin e personit juridik dhe menaxhojnë me territorin administrativ të njësive të tyre⁹⁰.

Funksionet e Bashkive dhe Qarqeve dhe kompetencat e tyre

Funksionet e bashkive shtrihen kryesisht në këto fusha⁹¹;

- a.) Infrastruktura dhe shërbime publike
 - b.) Shërbime sociale
 - c.) Kulturë, sport dhe shërbime argetuese
 - d.) Mbrojtjen e mjedisit
 - e.) Bujqësi, zhvillim rural, pyejeve dhe kullotave, natyres dhe biodiversitetit
 - f.) Zhvillim ekonomik lokal
 - g.) Në fushën e sigurisë publike si dhe
 - h.) Kompetencat e deleguara
- ***Funksionet e Qarkut shtrihen kryesisht në këto fusha⁹²;***
 - a) Ndërtimin dhe zbatimin e politikave rajonale, harmonizimin e tyre me politikat shtetërore, në nivel qarku.
 - b) Funksione të deleguara nga niveli qendror dhe ai bashkiak

⁹⁰Po aty neni 6

⁹¹Po aty neni 25-30

⁹²LIGJ Nr. 139/2015 PËR VETËQEVERISJEN VENDORE Në mbështetje të neni 31,32

Financat e njësive të vetëqeverisjes lokale Bashkisë dhe Qarkut

Padyshim se një vend të veçantë në vetëqeverisjen lokale kanë financat, pasi që janë mjetë për të përmbushur edhe kërkesat e qytetarëve. Politikat publike garantojnë një shumëllojshmëri të burimeve financiare lokale.

Bashkitë financohen nga;

- a.) Të **hyrat vetanake (vendore)**, si të hyrat nga mbledhja e taksave dhe tatimeve në nivel lokal, donacionet dhe dhuratat dhe tarifat të tjera të përkohshme.
- b.) **Të ardhurat tjera nga burimet tjera të bashive si;** dhënia me qëra të aseteve në pronë të bashkive, nga investimet kapitale, nga ndërmarrjet publike, nga partneriteti publiko privat, nga gjobat, shitja e pronave, ndihma sociale apo përfitimet nga veprimtaria kulturore dhe sportive⁹³.
- c.) **Të hyrat nga niveli kombëtar si;** Taksat dhe tatimet përfshirë edhe të ardhurat personale, transferet e pakushtëzuara dhe të kushtëzuara nga niveli qendror në mënyrë që të realizohet barazia e burimeve financiare.

Qarqet financohen nga;

- a.) Nga të hyrat vetanake (Vendore),
- b.) Transfere nga buxheti i pakushtëzuar i shtetit
- c.) Taksat në nivel Qarku si dhe
- d.) Nga kuotat e anëtarësisë së bashkësive përkatëse.

⁹³Po aty neni 34, 35, 36

Njësitë e vetëqeverisjes lokale kanë të drejtë edhe në marrjen hua, të ndryshme për plotësimin e nevojave të komunitetit lokal.

Shpenzimi i të hyrave lokale bëhet mbi bazën e parimit të ligjshmërisë dhe në dobi të qytetarëve, duke ju nënshtruar një kontrolli të “Rreptë” financiar. Përmjet auditimit të brendshëm dhe atij të jashtëm si dhe përmes raporteve vjetore⁹⁴.

Struktura e organeve të vetëqeverisjes lokale

Këshilli Bashkiak, përbëhet nga anëtarët e zgjedhur përmes votave të drejtpërdrejta⁹⁵.

Numri i anëtarëve të këshillit bashiak përcaktohet edhe nga numri i qytetarëve që jetojnë në atë pjesë duke filluar nga 15 anëtarë deri në 61⁹⁶. Anëtarët e Këshillit bashkiak nuk mund të mbajnë poste tjera politike në atë vend si deputet, ministër, nënpunës të administratës dhe nuk mund të jenë të zgjedhur në më shumë se një këshill. Pas përfundimit të zgjedhjeve mbledhjen e parë të këshillit bashkiak e kryeson, më i vjetri në mesin e anëtarëve. Në mbledhjen e parë konstituive këshillat bashkiak zgjedhin strukturat e tyre dhe bëjnë betimin për fillimin e mbledhjes fillimisht konstatohet kuorumi i pjesëmarrësve e që zakonisht duhet të jenë më shumë se gjysma e anëtarëve të zgjedhur. Mandati i këshilltarëve u jepet me vendim të këshilli bashkiak dhe i njëjti mund të mbaroj para afati nëse ndryshojnë qëllimet e zgjedhjes, p.sh. ndërrimi i vendbanimit, humbja e zotësisë së veprimit, dhe sipas fakteve të tjera notore⁹⁷.

Këshilltarët kanë të drejta dhe detyrime, për punën e tyre ata marrin 10% të pagës mujore të kryetarit. Këshilltarët me kërkesën e tyre informohen në çdo kohë për punën e bashkisë. Puna e anëtarëve të këshillit bashkiak bëhet mbi bazën e respektimit të parimeve të larta morale duke ju shmangur konfliktit të interesit në ndonjë interes personal në vendimmarrje.

⁹⁴ LIGJ Nr. 139/2015 PËR VETËQEVERISJEN VENDORE Në mbështetje të neni 36-44

⁹⁵ Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë 30.06.2003 neni 76

⁹⁶ LIGJ Nr. 139/2015 PËR VETËQEVERISJEN VENDORE Në mbështetje të nenit 47

⁹⁷ Po aty neni 49

Këshilli bashkiak ka një sërë kompetencash si; Miraton rregulloren e brendshme për funksionimin e saj emëron sekretarin, zgjedh përfaqësuesit e këshillit bashkiak në këshillin e qarkut duke respektuar edhe parimin e barazisë gjinore. Jepe dekorata dhe tituj të tjerë nderi⁹⁸.

Mënyra e votimit në këshill është me vota të hapura dhe të mbyllura. Për mënyrën e votimit vendosin anëtarët e këshillit të votimit. Përgjashtimisht votimi i buxhetit dhe i akteve tjera financiare është i hapur.

Këshilli i bashkisë kryesohet nga kryetari i këshillit i cili zgjidhet nga anëtarët e këtij këshilli ai ndihmohet nga zëvendës kryetari dhe kanë rolin e kryesuesit të këshillit në drejtimin e seancave dhe nënshkruan akte të cilat nxjerrë këshilli.

Kryetari për punën e tij ndihmohet nga sekretari i cili kryen të gjitha punët administrative dhe mbikëqyr edhe respektimin e rregullores së funksionimit të këshillit⁹⁹.

Shpërndarja e parakohshme e këshillit bëhet nëse nuk mblidhet për një periudhë prej tre muaj, nuk e miraton buxhetin, kryen shkelje të rënda kushtetuese dhe ligjore si dhe me vendim të këshillit të ministrave janë këto disa nga rastet e shpërndarjes së parakohshme¹⁰⁰.

⁹⁸LIGJ Nr. 139/2015 PËR VETËQEVERISJEN VENDORE Në mbështetje të nenit 54

⁹⁹Po aty neni 55-57

¹⁰⁰Po aty neni 58

Kryetari i bashkisë

Çdo bashki udhëhiqet nga kryetari i cili vije në pozitë më anë të zgjedhjeve të lira ferë dhe demokratike i cili mund të zgjedhet për 3 mandate të njëpasnjëshme në krye të bashkësisë¹⁰¹. Kryetari ndihmohet nga një a po më shumë nënkryetar varësisht edhe numrit të banorëve emërohen edhe zëvendëskryetarët të cilët nuk mund të jenë anëtarë të Këshillit bashkiak. Mandati i kryetarit të bashkisë fillon me rastin e dhënies së betimit pranë këshillit. I njëjti mund të përfundojë para kohe në rast të mos përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe sipas fakteve notore. Kompetencat e tij janë kompetenca ekzekutive dhe vendimmarrëse.

Në kuadër të funksionimit të vetëqeverisjes lokale funksionon administrata e cila drejtohet nga administratori i cili emërohet dhe shkarkohet nga kryetari i bashkisë. Po ashtu ekzistojnë edhe këshillat komunitare në lagje të cilat kryejnë punë të deleguara nga këshilli. Po ashtu edhe në fshatra ekzistojnë Kryesitë dhe kryetarët e fshatërave të cilët kanë rol këshillues për kryetarin e bashkisë.

Përbërja e këshillit të Qarkut

a.) Këshilli i Qarkut

b.) Kryetari i Qarkut

c.) Sekretari i Qarkut

Qarku funksionon mbi bazën e një pune të hapur, në mënyrë që të realizohet parimi i subordinimit për një qeverisje sa më afër qytetarëve, mënyra e funksionimit, kompetencat dhe mandati i strukturave të Qarkut është i rregulluar me ligj dhe në përputhje me Kartën Evropiane të vetëqeverisjes lokale.

¹⁰¹Në nenin 59, ligjvënësi ka ngatrruar fjalën zgjedhet me zgjidhet si dhe ka lënë pa kjarhtësi në ushtrimin e mandateve.

Veçoritë e pushtetit lokal në Republikën e Maqedonisë Veriore

Vetëqeverisja lokale në **Republikën e Maqedonisë Veriore**, është në frymën e një materie Kushtetuese¹⁰². Ku njësitë e administrimit lokal janë komunat¹⁰³, organizmi dhe funksionimi i tyre pastaj është mirë i rregulluar me ligj. Shkupi është njësi e veçantë edhe si kategori kushtetuese¹⁰⁴.

Rajonin e Qytetit të Shkupit e përbëjnë edhe disa rajone të komunave të tjera. Qyteti i Shkupit ka edhe organet e veta si Kryetarin dhe Këshillin e komunës, të cilët kanë kompetenca ekzekutive. Dhe financimi i Qytetit të Shkupit përbëhet nga të hyrat, vetanake, tatimet dhe nga buxheti Republikës¹⁰⁵.

Njësitë e vetëqeverisjes lokale janë Komunitat, të cilat realizojnë kompetencat e veta përmjet organeve të zgjedhura drejtpërsëdrejti nga qytetarët. Komunitat, janë të obliguara në publikimin e vendimeve të tyre më përjashtim të vendimeve të cilat prekin interesat e shtetit, apo palëve sipas akteve ndërkombëtare¹⁰⁶.

Komunitat në R.Maqedonisë Veriore kanë territorin e vetë ngjashëm me të vendeve tjera të Evropës Juglindore duke përfshirë edhe stemën dhe flamurin vetë. Bashkëpunimi ndërkomunal është i realizueshëm me qëllim të realizimit të një qeverisje në të mirë të qytetarëve. Bashkëpunimi ndërkomunal mund të zhvillohet edhe me komuna të vendeve tjera dhe me organizata ndërkombëtare.

¹⁰²Në frymën e Konventës Evropiane për vetëqeverisje lokale më saktë neni 2 nga konventa që thotë : “Parimi i vetëqeverisjes lokale përcaktohet me ligjdhënien e çdo vendi kontraktues, atje ku nuk është e mundur me kushtetutë

¹⁰³Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Nr 08 4642/1 e dates 17 nëntor 1991 me amendamente të nenit Nenit 114, paragrafi 5 i Kushtetutës së RM-së është zëvendësuar me Amendamentin XVI, pika 1. Nenit 115, paragrafi 1 i Kushtetutës së RM-së është zëvendësuar me Amendamentin XVII, pika 1. Nenit 117, paragrafi 2 i Kushtetutës së RM-së është zëvendësuar me Amendamentin XVII, pika 2.

¹⁰⁴Po aty neni 117

¹⁰⁵ligji për qytetin e shkupi

<http://mls.gov.mk/images/laws/Ligji%20per%20qytetin%20e%20Shkupit.pdf>

¹⁰⁶Ligji për vetëqeverisje lokale i Republikës së Maqedonisë Veriore

<http://mls.gov.mk/images/laws/Ligji%20i%20veteqeverisjes%20lokale.pdf>

Krejtë ky bashkëpunim është nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Vetëqeverisjes lokale.

Financimi i komunave përbëhen nga;

a.) Të hyrat vetanake

b.) Burimet tjera¹⁰⁷

Burimet vetanake kryesisht realizohen në përshtatshmëri me politikat ekonomike të shtetit përmjet tatimeve dhe taksave lokale. Ndërsa burimet të tjera kryesisht realizohen nga grandet qeveritare dhe përmes fondeve ndërkombëtare.

Republika e Maqedonisë Veriore i jep fokus në ndarjen e mjeteve tjera edhe viseve më pak të zhvilluara siç janë vendet në zona rurale ku ekonomia është më e ulët. Përmjet këtyre të hyrave Komuna siguron edhe buxhetin e vetë të cilin e rregullon me ligj.

Kompetencat e komunave

Ndahen në dy grupe në kompetencat vetanake dhe të deleguara;

a.) Planifikimin urbanistik

b.) Zhvillim ekonomik lokal

c.) Shkencë, Kulturë, rini dhe sport

d.) Punët sociale etj.

Ndahen në dy grupe në kompetencat vetanake dhe të deleguara; kompetencat e deleguara nga niveli qendror dhe të njëjtat barten së bashku me buxhetin për realizimin e tyre. Realizimi i

¹⁰⁷Ligji për vetëqeverisje lokale i Republikës së Maqedonisë Veriore neni 11
<http://mls.gov.mk/images/laws/Ligji%20i%20veteqeverisjes%20lokale.pdf>

kompetencave mund të themelojnë edhe veprimtari publike, si dhe të delegohen edhe të subjektet tjera¹⁰⁸.

Demokracia e drejtpërdrejtë dhe mekanizmat e pjesëmarrjes së qytetarëve në Republikën e Maqedonisë Veriore

Konsultimi publik është një nga mjetet kryesore në realizimin e demokracisë së drejtpërdrejt edhe qytetarët në Republikën e Maqedonisë veriore kanë mundësi në pjesëmarrje dhe konsultim për vendimet me interes të tyre. Kjo madje për dallim prej vendeve fqinje në Evropën Juglindore në Republikën e Maqedonisë Veriore, shpenzimet për pjesëmarrjen e qytetarëve bijën në ngarkesë të shtetit¹⁰⁹.

Forma e pjesëmarrjes së qytetarëve realizohen përmes;

- a.) Iniciativës Qytetare
- b.) Tubimeve të Qytetarëve
- c.) Referendumit
- d.) Parashtresa dhe propozimet
- e.) Tribuna e hapura, anketat dhe propozimit

a.a **Iniciativa qytetare**, mund të iniciohet për çështje të caktuara me të cilat preken interesat e qytetarëve në nivel lokal, si psh nxjerrjen e akteve në fushën administrative apo për rregullimin e infrastrukturës, vendosjen e emrave dhe çështje të tjera. Por iniciativa qytetare nuk mund të paraqitet për çështje kadrovike dhe financiare. Iniciativa qytetare i propozohet këshillit, nga të paktën 10% e qytetarëve me të drejtë vote në atë

¹⁰⁸Po aty neni 12-24

¹⁰⁹Ligji për vetqeverisje lokale i Republikës së Maqedonisë Veriore neni 25
<http://mls.gov.mk/images/laws/Ligji%20i%20veteqeverisjes%20lokale.pdf>

komunë. Këshilli ka obligim që të debatojë dhe për një afat ligjor jo më të gjatë se 90 ditë duhet të informojë opinionin për vendimin e marr në lidhje me çështjen e ngritur nga qytetarët¹¹⁰.

b.b Tubimi i qytetarëve, është i mundur të organizohet për tërë territorin apo për një pjesë të territorit të komunës. Tubimi, thirret nga prefekti i komunës me iniciativën e tij apo edhe me kërkesën e të paktën 10% të banorëve me të drejte vote në atë komunë. Gjatë mbajtjes së tubimit organet komunale janë të obliguara në mbajtjen e shënimeve në lidhje me diskutimet të cilat zhvillohen dhe më pastaj të njëjtat ti trajtojnë gjatë marrjes së vendimeve në një afat ligjor jo më të gjatë se 90 ditë dhe për vendimet e veta pastaj ti informojnë qytetarët¹¹¹.

c.c Referendumi, si njëra ndër format më të vjetra të realizimit të demokracisë së drejtpërdrejtë, me referendum vendoset për çështje të natyrës së rëndësishme si psh shkëmbim territori, apo edhe ndonjë ndryshim **“rrevulicionar paqësor”**. Referendumi, shpallet nga ana e këshillit kur pranë tij paraqitet kërkesa nga të paktën 20% e zgjedhësve në një komunë¹¹². Por organet e nivelit lokal mund të shpallin referendum edhe për çështjet të cila janë kompetencë e këshillit apo ndonjë organi tjetër lokal. Vendimi i cili del nga referendumi është i obliguar për palët në teorinë juridike dhe politike referendumi njihet si mjet i rëndësishëm i vendosjes. Shtetet demokratike edhe pas nxjerrjes së akteve mund të vendosin aktin në referendum për të konsultuar qytetarët me përshtatshmërinë e aktit përfshirë edhe aktin më të lartë Juridik dhe Politik Kushtetutën.

¹¹⁰Po aty neni 26

¹¹¹Ligji për vetqeverisje lokale i Republikës së Maqedonisë Veriore neni 27
<http://mls.gov.mk/images/laws/Ligji%20i%20veteqeverisjes%20lokale.pdf>

¹¹²Po aty neni 28

d.d **Parashtresat**, në teorinë juridike është i njohur komunikimi me anë të parashtresave, çdo qytetar, apo grup qytetarësh të cilët konsiderojnë se nga ana e organeve në nivel lokal u është mohuar ndonjë e drejtë elementare nga pushteti lokal të paraqesin parashtresa dhe Përfekti i komunës brenda një afati ligjor prej 60 ditësh i përgjigjet me njoftim në lidhje me shqetësimin e ngritur pranë tyre.

e.e Tribunat e hapura, anketat dhe propozimet

Puna e organeve në nivel lokal në Republikën e Maqedonisë Veriore është një punë e hapur e mbështetur mbi parimin e transparencës dhe llogaridhënies.

Komunat, mund të organizojnë tribuna, anketa dhe të kërkojnë mendimin e tyre në çështje të rëndësishme¹¹³.

Struktura e Vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Njësi të vetëqeverisjes lokale janë Komunat;

Organet e Komunës janë:

- a.) Këshilli i Komunës dhe
- b.) Përfekti i Komunës

Këshilli i Komunës, është organ përfaqësues i qytetarëve i cili vendos për çështje në nivel lokal¹¹⁴. Zgjedhja e anëtarëve të këshillit bëhet përmes zgjedhjeve të përgjithshme, drejtpërdrejta dhe të fshehta, sipas legjislacionit zgjedhor. Numri i anëtarëve në këshill nuk mund të jetë më i vogël se 9 dhe më i madh se 33. Por i njëjti përcaktohet me numër të banorëve në atë komunë.

¹¹³Ligji për vetëqeverisje lokale i Republikës së Maqedonisë Veriore neni 30
<http://mls.gov.mk/images/laws/Ligji%20i%20veteqeverisjes%20lokale.pdf>

¹¹⁴Po aty neni 31-35

Mandati i anëtarëve është 4 vjeçar, dhe mandati i tij nuk mund të revokohet. Këshilli është organ që nxjerr dhe miraton statutin e Komunës dhe vendos për çështje financiare. Si dhe për veprimtari publike etj. Mandati i këshillit fillon pas dhënies së betimit¹¹⁵. Takimet e këshillit janë publike dhe me mundësi pjesëmarrje edhe për qytetarët.

Puna e anëtarëve të këshillit ushtrohet mbi bazën e parimeve etike. Duke ju shmangur kështu edhe konfliktit të interesit. Mandati i tyre përfundon sipas kushteve ligjore dhe fakteve notore. Punën e këshillit e udhëheq kryetari i cili zdhedhet nga radhët e anëtarëve të këshillit për mandat 4 vjeçar. Vendimet e këshillit të komunës i nënshtrohen kontrollit të ligjshmërisë.

Përfekti i komunës, është përfaqësues dhe prezanton komunën. Përfekti zgjedhet për mandat 4 vjeçar me anë të zgjedhjeve të lira, drejtpërdrejta me votim të fshehtë. Përfekti ushtron punë ekzekutive e vendimmarrëse. Pas marrjes së mandatit ai zgjedh stafin e vet punës si dhe është i obliguar të bëjë zbatimin e vendimeve të këshillit, udhëheq administratën në nivel lokal etj.

Nëse përfekti pretendon se vendimi i këshillit mund të jetë në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë ai mund ta kthejë çështjen përsëri në këshill kjo mund të quhet edhe “Pocket veto”, e njohur si vota e gjepit por në raundin e dytë Këshilli mund ta obligojë Përfektin në shpalljen e vendimeve. Puna e përfektit është e mbështetur mbi bazën e një qeverisje të mirë dhe në dobi të qytetarëve. Duke ju shmangur konfliktit të interesit. Mandati i përfektit përfundon sipas fuqisë ligjore dhe sipas të drejtës natyrore (Fakteve notore).

¹¹⁵Po aty nën 38

Për punët dhe realizimin e punëve në nivel lokal organizohen nga administrata komunale. E cila është mirë e organizuar dhe kryen të gjitha punët në administrative. E cila kuptohet si veprimtari dhe shërbime publike. Ajo që mbetet sfida në Republikën e Maqedonisë Veriore, implementimi i ligjit për gjuhë edhe pse gjuhët në nivel lokal kanë qenë në përdorim vetëm në komunat me 20% të banorëve të një komuniteti. Në raste të tjera ka vendosur këshilli i komunës.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për gjuhët duhet të amandamentohet ligji përkatësisht neni 89.

Komuna gëzon edhe pozitë të mirë kushtetuese pasi që Përfekti dhe këshilli i komunës kanë të drejtë të paraqesin iniciativë kushtetuese për vlerësim kushtetues të akteve ministore¹¹⁶ me që rast rritet edhe autonomia e Komunave në vendimmarrje.

Në komuna kanë të drejta të themelohen edhe qytete e bashki urbane si dhe vendime tjera të bashkësisë lokale¹¹⁷.

¹¹⁶ Ligji për vetqeverisje lokale i Republikës së Maqedonisë Veriore neni 87
<http://mls.gov.mk/images/laws/Ligji%20i%20veteqeverisjes%20lokale.pdf>

¹¹⁷ Po aty 82

Veçoritë e pushtetit lokal në Republikën e Malit të Zi

Mali i Zi, shpallet shtet i pavarur me referendumin e vitit 2006, ky rezultat i shpalljes së pavarësisë u atribuohet edhe pjesëmarrjes masive të qytetarëve shqiptar të regjistruar si votues.

Organizimi i vetëqeverisjes lokale në Mal të zi, është në frymën e Kushtetutës së Malit të zi, ku më tej thuhet se “Forma themelore e vetëqeverisjes lokale është komuna”¹¹⁸. vetëqeverisja Lokale funksionon edhe me Ligjin për vetëqeverisjen lokale¹¹⁹.

Mali i zi ka një sistem administrativ që përbëhet nga 24 njësi administrative të ashtuquajtura komuna me dy komuna urbane si njësi të kryeqytetit.

Komunat në Republikën e Malit të zi funksionojnë mbi bazën e parimeve të demokracisë, barazisë, decentralizimit, depolitizimit, autonomisë, ligjshmërisë, profesionalizmit, efikasitetit dhe bashkëpunimit¹²⁰.

Njësitë e Vetëqeverisjes lokale

Njësitë e vetëqeverisjes lokale në Malin e Zi janë komunat të cilat kryen aktivitete në interes të drejtpërdrejtë dhe të përbashkët me popullatën. Aktivitetet dhe detyrat e komunës kryhen nën organeve të vetëqeverisjes lokale¹²¹. Komunat, gëzojnë statusin e subjektit të së drejtës me që rast janë autonome, mjetet dhe të ardhurat janë të pavarura për shfrytëzim në mënyrë të pavarur. Komunat menaxhojnë me territorin dhe pasuritë komunale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

¹¹⁸Kushtetuta e Malit të Zi, të cilën e ka miratuar Kuvendi Kushtetues i Republikës së Malit të Zi, në mbledhjen e tretë të seancës së dytë të rregullt të vitit 2007, me datën 19 tetor 2007 Neni 114, fq 22

¹¹⁹Ligjin për veqevrisjen lokale, cg nr 2/2018

<https://www.paragraf.me/propisi-crnegore/zakon-o-lokalnoj-samoupravi.html>

¹²⁰Ligjin për veqevrisjen lokale, cg nr 2/2018 neni 3

<https://www.paragraf.me/propisi-crnegore/zakon-o-lokalnoj-samoupravi.html>

¹²¹po aty neni 4 dhe 5

Financat e komunës përbëhen nga¹²²

a. Të hyrat vetanake, të Komunave përbëhen nga mbledhja e taksave dhe tatimeve në nivel lokal. Përmes menaxhimit.

b.) Të hyrat tjera nga niveli qendror, janë të hyra të cilat sigurohen përmes projekteve qeveritare dhe buxhetit të shtetit.

c.) Të hyrat nga grandet dhe dhuratat, janë të hyra të cilat mblidhen nga fondet ndërkombëtare.

Struktura e Organeve Komunale

Kuvendi i Komunës, është organ përfaqësues i qytetarëve të Komunës i cili përbëhet nga asamblastët të cilët zgjedhën në bazë të votimit të lirë me anë të zgjedhjeve të drejtpërdrejta për mandat katër vjeçar. Kuvendi i Komunës është zëri i qytetarëve. Dhe ka një sërë funksionesh si; nxjerrjen e statutit, vendime, rezoluta, rregullore, planeve strategjike etj.

Kuvendi udhëhiqet nga kryetari i cili zgjedhet nga radhët e këshilltarëve komunal i njëjti ndihmohet edhe nga nënkryetari mandati i kryetarit zgjat për mandatin e deputetëve (Këshilltarëve). Kuvendi ka edhe sekretarin e vete i cili i ndihmon në punët administrative dhe duhet të jetë jurist me provim të jurisprudencës¹²³.

¹²²Ligjin për vetëqeverisjen lokale, nr 2/2018 neni 150

<https://www.paragraf.me/propisi-crnegore/zakon-o-lokalnoj-samoupravi.html>

¹²³Po aty neni 32-54

Kryetari i Komunës, është organ ekzekutiv i komunës, funksioni i tij është profesional dhe i zgjedhur për mandat katër vjeçar¹²⁴. Nga radhët e anëtarëve të kuvendit. I njëjti jep betimin pranë kuvendit komunal. I njëjti edhe mund të shkarkohet nga kuvendi i cili në rast të mos përmbushjes së detyrave si dhe nëse nuk propozon buxhetin.

Pjesëmarrja e qytetarëve në vetëqeverisje lokale në Republikën e Malit të Zi janë:

Qytetarët informohen mbi punën e komunës së tyre përmes; (sondazheve, medieve, bordet e njoftimeve, kutive të komenteve, propozimeve dhe sugjerimeve, faqeve të internetit, linjat telefonike, organizuar seminare në komunitetet lokale, takimeve të ekspertëve dhe tryeza të rrumbullakëta dhe të ngjashme).

Ligji për vetëqeverisje lokale në republikën e Malit të Zi ka paraparë edhe mënyrën e realizimit të demokracisë së drejtpërdrejtë përmes **Referendunit, nismave, iniciativës qytetare në nivel lokal.**

Iniciativa Qytetare, qytetarët kanë të drejtë për Iniciativ Qytetare, për ndryshimin e ndonjë akti që rregullon ndonjë çështje të rëndësishme të veçantë. Organet komunale janë kompetente të përgjigjen brenda një afati sa më të shkurtër ligjor, në lidhje me kërkesat e tyre.

Referendumi lokal, mund të realizohet për qëllim të një opinioni apo një pëlqimi të qytetarëve për ndonjë çështje të caktuar cila është në kompetencë të organeve të nivelit lokal. Referendumi organizohet me qëllim të konsultimit të vullnetit burimor të popullit.

Nisma qytetare, është e drejtë ekskluzive e një individi apo grupi shoqëror për të paraqitur, kërkesë, ankesë apo nismë për hartimin e ndonjë plani apo akti të caktuar¹²⁵.

Organet e nivelit qendror mbikëqyrin punën organeve në nivel lokal përmes kontrollit të brendshëm dhe atij të jashtëm të ligjshmërisë së punës së tyre. Organeve të nivelit lokal u

¹²⁴Ligjin për vetëqeverisjen lokale, nr 2/2018 neni 55
<https://www.paragraf.me/propisi-crnegore/zakon-o-lokalnoj-samoupravi.html>

¹²⁵Ligjin për vetëqeverisjen lokale, nr 2/2018 neni 199
<https://www.paragraf.me/propisi-crnegore/zakon-o-lokalnoj-samoupravi.html>

mundësohet edhe mbrojtja juridike ndaj vendimeve të pushtetit qendror, nëse ata pretendojnë se po u shkelet ndonjë e drejtë mund të paraqesin rast pranë gjykatës kushtetuese për vlerësim të kushtetutshmërisë.

Pozita kushtetuese dhe juridike e komunave në Kosovë

Republika e Kosovës vetëqeverisjes lokale i kushton edhe një kapitull të veçantë në kushtetutën e saj. Vetëqeverisjes lokale, me që rast komunave u jep edhe një autonomi të gjerë në vendimmarrje, Kushtetuta Republikës së Kosovës Qeverisjen lokale e vendos edhe të vlerat themelore ku në nenin 12 thekson " Njësi themelore territoriale të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës janë komunat"¹²⁶. Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës por edhe legjislacionit aktual në fuqi komunat në Republikën e Kosovës gëzojnë një autonomi të gjerë të vendosjes dhe kanë tri lloje kompetencash, vetanake, të zgjeruara, dhe deleguara¹²⁷.

Por ajo që është specifike edhe në vendet e rajonit se komunat gëzojnë disa veçori si të drejtat, për të paditur dhe paditur, të posedojnë dhe menaxhojnë pasurinë e tyre, mund të jetë pronare ose bashkëpronare me ndonjë kompani, që është në interes të komunës apo qytetarëve, të lidh kontrata, të punësoj staf, të menaxhoj me zhvillimin ekonomik lokal planifikimin urban dhe rural, shfrytëzimin e territorit, turizmin, aktivitete kulturore e tjera¹²⁸.

Por, ajo që mbetet sfidë është decentralizimi fiskal, sepse për realizimin e projekteve kapitale Komunat në Republikën e Kosovës duhet kërkojnë mbështetje financiare nga pushteti qendror dhe kjo krijon shpeshherë edhe vështirësi kjo ngase vendet e Evropës Juglindore ballafaqohen dhe me një kulturë teknokratike dhe shpesh veprojnë me agenda politike. Dhe jo rrallë herë projektet hasin në vështirësi të realizimit.

¹²⁶Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 12.1, datë 15.06.2008

¹²⁷Po aty neni 124.3.

¹²⁸Ligji Për Vetëqeverisjen Lokale, i datës 20.02.2008, neni 5 dhe 18

Organizimi i vetëqeverisjes lokale në Kosovë

Organizimi i vetëqeverisjes lokale në Kosovë edhe në të kaluarën ka qenë i ngjashëm edhe në Kushtetutën e vitit 1974¹²⁹ organizimi i qeverisjes lokale ka qenë në dy nivele në atë qendror dhe lokal ai lokal pastaj ka qenë i shpërndarë në Komuna dhe bashkësi lokale.

Kjo formë e organizimit të qeverisjes lokale është instaluar edhe pas ndërhyrjes Humanitare nga faktori ndërkombëtar në vitin 1999. Organizimi i qeverisjes lokale është përcjell nën hijen e Kartës Evropiane për vetëqeverisje lokale, por fillimisht ky proces u rregullua me Rregulloren e UNMIK Nr. 2000/45, pastaj me Rregulloren e UNMIK Nr. 2007/30¹³⁰. Aktualisht organizimi i vetëqeverisjes lokale është i organizuar me ligjin për vetëqeverisjen lokale, Ligjin për kufijtë administrativ të Komunave, Ligjin për zgjedhjet lokale, Ligjin për bashkëpunim ndërkomunal, Ligjin për financat e pushtetit Lokal¹³¹.

Dhe me njëser aktesh administrative dhe udhëzime. Pra qeverisja në Republikën e Kosovës është ndarë në dy nivele në Nivel vendi dhe në atë lokal.

I tërë procesi i vetëqeverisjes lokale në Kosovë ka kaluar në organizim dhe riorganizim e ky riorganizim është quajtur reformë e pushtetit lokal. Reforma është munduar që përmes bartjes së kompetencave nga niveli lokal (Decentralizimi), të përfshi edhe qytetarët dhe subjektet tjera juridike në vendimarrje. Edhe pse ky riorganizim është mbështetur edhe në parimin e diskriminimit pozitiv me që rast ka privilegjuar komunitet jo shumicë. Por si platformë kryesor ka pasur qytetarin që të jetë në një vendimarrje sa më afër tij.

Në kreun e X të Kushtetutës së Republikës së Kosovës janë përcaktuar parimet e përgjithshme të vetëqeverisjes lokale si; Vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe

¹²⁹Kushtetuta e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës GAZETA ZYRTARE E KRAHINËS SOCIALISTE AUTONOME TË KOSOVËS Nr. 4 Prishtinë, më 27 shkurt 1974 fq 85

¹³⁰<https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2018/03/ORGANIZIMI-DHE-FUNKSIONIMI-I-VETEQEVERISJES-LOKALE-NE-KOSOVEpdf> çasur me 31.06.2019

¹³¹<https://mapl.rks-gov.net/legjislacioni-dhe-politikat/ligjet-per-veteqeverisjen-lokale/> çasur me 31.06.2019

pjesëtarëve të tyre¹³². Ndërtimi i vetëqeverisjes lokale është bërë duke ju kushtuar një kujdes të veçantë pjesëmarrjes së komuniteteve në nivel lokal e posaçërisht komunitetit serbë.

Tërë ky proces është zhvilluar mbi bazën e parimit të diskriminimit pozitiv¹³³. Organizimit dhe funksionimit të vetëqeverisjes lokale në Kosovën e pas luftës u ndihmua nga autoritetet ndërkombëtare. Vetëqeverisja lokale në Kosovës (në tekstin e më tutjeshëm VQL) gëzon autonomi në vendimmarrje madje edhe për vendimet në realizimin e kompetencave të deleguara¹³⁴. Ligji për vetëqeverisje lokale në Kosovë, tejkalon edhe kartën evropiane për vetëqeverisje lokale¹³⁵.

Baza kushtetuese dhe ligjore e Vetëqeverisjes lokale

Ka krijuar hapësirë të mjaftueshme për decentralizimi të pushtetit në organet e VQL, kjo kornizë ligjore dhe marrëveshjet për arritjen e statusit final të Kosovës kanë krijuar mundësi të mira për krijimin e komunave tashmë të krijuara serbe, komuna këto të cilat janë krijuar pa respektimin e standardeve ndërkombëtare dhe në baza etnik. Mos respektimi i institucioneve në nivel qendror është evidentuar edhe nga raporti i ministrisë së Administratës Publike ku është evidentuar se funksionimi i Kuvende Komunale në disa komuna si; Mitrovicë Veriore, Zubin Potok, Zveçanë dhe Leposaviq në disa raste nuk kanë dërguar materialet përcjellëse për punën e tyre, siç është përcaktuar me nenin 43.3, të Ligjit për Vetëqeverisje lokale¹³⁶. Po ashtu në këto komuna kemi edhe nivel të ulët të transparencës, pasi që niveli qendror nuk arrin të bëjë monitorimin e punës së tyre dhe paraqitja e raporteve është në vullnetin e krerëve të komunave¹³⁷. Krijimi i situatave të tilla lenë përshtypjen se është decentralizim i tepruar dhe ky

¹³²Kushtetuta e Republikës së Kosovës 15 qershor 2008 neni 123

¹³³Thelbi i parimit të diskriminimit pozitiv është të pasurit të drejta shumë me shumë se ajo që meriton ose e që duhet pasur.Kushtetuta e Republikës së Kosovës, ka ofruar pozitë të pa precedent komuniteteve me theks të veçantë të komuniteti serb. Kjo qendron sidomos kur është fjala për pjesëmarrjen e tyre në jetën publike dhe në vendimmarrje.

¹³⁴Council of Europe Publishing: “European Charter of Local Self – Government”, neni 4, pika 4

¹³⁵Po aty neni 1 paragrafi 3

¹³⁶RAPORTI I FUNKSIONIMIT TË KOMUNAVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS Janar - Dhjetor 2017 i publikuar në mars 2018 fq 6

¹³⁷Po aty fq 10

decentralizim mund të jetë i kthyeshëm. Sepse kjo kornizë ka krijuar mundësi në humbjen e kontrollit nga niveli qendror në atë lokal.

Njësitë e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës

Njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës janë Komunitat¹³⁸, të cilat përbëhen nga një komunitet i qytetarëve brenda një territori të caktuar, ku ushtrohet pushteti i cili nuk është i rezervuar shprehimisht për institucionet e nivelit qendror¹³⁹.

Komunitat, gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe inkurajojnë e sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale¹⁴⁰. Aktualisht në Republikën e Kosovës ekzistojnë 38 Komuna¹⁴¹. Ky organizim i vetëqeverisjes lokale është bërë në përputhje me Pakon e Ahtisarit, nën frymën e së cilës u hartua edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe një sërë ligjeve.

Ligji për vetëqeverisjen lokale u miratua nga Kuvendi i Kosovës së bashku me pakon e ligjeve të Ahtisarit pako kjo e cila i dha zgjidhje statusit final të Kosovës edhe me këtë ligj komuniteteve jo shumicë e posaçërisht komunitetit serb, i garantohen të drejtat të rezervuara mbi bazën e parimit të diskriminimit pozitiv, si në fushën e shëndetësisë edukimit në zgjedhjen e komandantit të policisë, bashkëpunimit me qeverinë serbe etj¹⁴². Mënyra e krijimit të njësitë të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës nuk është i përcaktuar me ligj apo me dispozita ligjore, ato mund të krijohen me kërkesë të një grupi të qytetarëve të cilët mund të marrin nismë për krijimin e komunave dhe të njëjtat mund të themelohen me vendim të Qeverisë¹⁴³. Baza e vetme ligjore është Ligji për Kufijtë Administrativ të Komunave. Kjo bazë ligjore nuk

¹³⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës 15 qershor 2008, neni 12

¹³⁹ LIGJI NR. 03/L-040 PËR VETËQEVERISJEN LOKALE, Nr. 28 / 04 QERSHOR 2008, neni 4

¹⁴⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës 15 qershor 2008, neni 124

¹⁴¹ <https://kk.rks-gov.net/#lista> çasur me 07.05.2019

¹⁴² LIGJI NR. 03/L-040 PËR VETËQEVERISJEN LOKALE, Nr. 28 / 04 QERSHOR 2008, neni 19

¹⁴³ Instituti për Studime të Avancuara GAP analiz politikash në krijimin e Komunave Korrik 2013, fq 19

krijon qartësi sa i përket kriterëve për themelimin e komunave të reja, e as si duhet të vazhdohet me kërkesën dhe në cilin institucion duhet dorëzuar atë¹⁴⁴.

Statusi ligjor i komunës

Komunat në Republikën e Kosovës kanë statusin e personit Juridik¹⁴⁵. Dhe çdo komunë ka kompetenca në mes të tjerash si¹⁴⁶

- a.) Të padis dhe paditet
- b.) Posedojë dhe menaxhojë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme
- c.) Të jetë pronare e ndonjë kompanie
- d.) Lidh kontrata
- e.) Punësoj staf dhe të angazhohet në aktivitete të ndryshme me qëllim të realizimit të obligimeve të marruara.

Komunat në republikën e Kosovës kanë emrat e tyre dhe kufijtë dhe mund të ndryshohen pasi të bëhet një analizë e mirëfilltë së bashku me arsyetimin e nevojave të ndryshimit psh lehtësimin e jetës së qytetarëve¹⁴⁷. Në vendet ku shumicë janë komuniteti jo shumicë në Kosovë qeveria duhet të hyjë në konsultime me ta. Të gjitha komunat kanë edhe simbolet e tyre në të cilat duhet përfshihet edhe emri i tyre simbolet e komunave mund të ndryshohen me 2/3 e votave në kuvendin Komunal¹⁴⁸. Por ndryshimi duhet bëhet në kuadër të frymës kushtetuese dhe respektimit të drejtave të komuniteteve.

Komuna e Prizrenit në vitin 2008 ka miratuar logon e re të Komunës së Prizrenit me që rast kjo logo ka qene objekt i shqyrtimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Logoja e re e Komunës së Prizrenit e miratuar me vendimin e datës 15 tetor 2008 ishte shumë e ngjashme me logon e vjetër të Komunës së Prizrenit. Ndryshimi i vetëm konsiston në faktin se tashmë në vend të fjalëve “Kuvendi Komunal – Municipality Prizren” tash

¹⁴⁴Po aty fq 19

¹⁴⁵Personat Juridik janë krijesa artificiale që shteti u njehë subjektivitetin e së drejtës dmth të drejtën për të hyrë në marrëdhënie juridike.

¹⁴⁶LIGJI NR. 03/L-040 PËR VETËQEVERISJEN LOKALE, Nr. 28 / 04 QERSHOR 2008 neni 5

¹⁴⁷LIGJI NR. 03/L-041 PËR KUFIJTË ADMINISTRATIV TË KOMUNAVE neni 11 dhe 12

¹⁴⁸LIGJI NR. 03/L-040 PËR VETËQEVERISJEN LOKALE, Nr. 28 / 04 QERSHOR 2008 neni 7

thuhet “1878 – Prizren”. Thelbi absolutisht nuk ndryshon. Objekti në të cilin është mbajtur Lidhja Shqiptare e Prizrenit me gjithë madhësinë e saj vazhdon të jetë prezent në logon e Komunës së Prizrenit¹⁴⁹. Ajo çka ishte kontestuese në këtë mes për një pjesë të qytetarëve të Komunës Prizrenit dhe për komunitetet jo shumicë që jetojnë në këtë Komunë, ishte futja e vitit 1878 (vit i mbajtjes së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit) në kuadër të logos së Komunës së Prizrenit. Kjo pjesë e qytetarëve të Komunës së Prizrenit propozuan që në vend të vitit 1878, të shkruhej “Komuna, Opstina, Belediye”, që njëkohësisht në plotni do të ishte vazhdimësi e logos së vjetër të Komunës së Prizrenit, me një ndryshim të vetëm se tashmë do të respektoheshin edhe Kushtetuta dhe ligjet tjera të Republikës së Kosovës. Dhe Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj kishte konstatuar se vendosja e nenit 7 të statutit të Komunës, në të cilën ishte miratuar logoja është në kundërshtim me frymën kushtetuese të Republikës së Kosovës¹⁵⁰. Pra, Kosova tashmë ka filluar krijimin e një kulture në të cilën respektohen parimet demokracisë.

Organet komunale

Komunat kanë organet e tyre¹⁵¹;

- a.) Kuvendin Komunal dhe
- b.) Kryetarin e Komunës

Organet komunale nxjerrin akte juridike në përputhje me rendin Kushtetues dhe juridik, në të kundërtën, mund të anulohet si në shembullin paraprak me rastin e Komunës së Prizrenit. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, kishte konsideruar se vendimi për nenin 7 të statutit të komunës së Prizrenit me të cilin kishte miratuar logon e re është vendim kundër parimeve kushtetuese me që rast kishte urdhëruar organet komunale anulimin e vendimit dhe ndryshimin e saj¹⁵².

¹⁴⁹<https://telegrafi.com/nje-perspektive-tjeter-per-logon-e-komunes-se-prizrenit/> qasur me 08.06.2019

¹⁵⁰ Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr Ko 01/09, i datës 18 mars 201 nr Agj 07/10

¹⁵¹ LIGJI NR. 03/L-040 PËR VETËQEVERISJEN LOKALE, Nr. 28 / 04 QERSHOR 2008 neni 10

¹⁵² Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr Ko 01/09, i datës 18 mars 201 nr Agj 07/10

Aktet e Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit

Ligji për vetëqeverisje lokale përcakton aktet juridike me anë të së cilave komunat rregullojnë fushë veprimtarinë e tyre. Në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë kuvendi i komunës mund të miratojë akte brenda fushës së kompetencave të tij. Akte këto të cilat vlejné në territorin e komunës që ka miratuar aktin. Këto akte përfshijnë: a) statutin e komunës; b) rregulloren e punës; c) rregulloret komunale; dhe d) çdo akt tjetër të nevojshëm apo të duhur për funksionim efikas të komunës¹⁵³. Nxjerrja e akteve juridike bëhet konform rendit juridik dhe me qëllim të zbatimit të ligjit të punës.

Organizimi i brendshëm dhe organet e komunës

Kuvendi Komunal është organi më i lartë i komunës që përbëhet prej anëtarëve të tij të zgjedhur¹⁵⁴. Zgjedhjet Komunale mbahen në bazë të votës së lirë, të përgjithshme, të barabartë, të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë në përputhje me rregullat e këtij ligji dhe rregullave të KQZ-së¹⁵⁵. Secila komunë në Republikën e Kosovës konsiderohet një zonë zgjedhore, dhe në të marrin pjesë të gjithë qytetarët e regjistruar në atë komunë¹⁵⁶. Ligji për zgjedhjet lokale favorizon pjesëmarrjen e femrës në listat zgjedhore subjektet politike duhet të kenë së paku 30 % femra. Të gjithë anëtarët e kuvendit komunal, duhet bëjnë betimin nëse brenda një muaji nuk bëjnë betimin konsiderohet se kanë hequr dorë nga anëtari i Kuvendit Komunal.

Numri i anëtarëve të kuvendit komunal është i ndarë në proporcion me numër të banorëve me përjashtim të Komunës së Prishtinës e cila ka 51 anëtarë¹⁵⁷.

Mandati i anëtarëve të Kuvendit Komunal është katër vjeçar. I njëjti mund të pushoj sipas fuqisë ligjore dhe të drejtës natyrore. Anëtarët e Kuvendit Komunal nuk mund të jenë deputet të Kuvendit të Kosovës. Gjatë punës së Kuvendit Komunal anëtarët duhet ti shmangen Konfliktit

¹⁵³ LIGJI NR. 03/L-040 PËR VETËQEVERISJEN LOKALE, Nr. 28 / 04 QERSHOR 2008 neni 12

¹⁵⁴ Po aty Neni 3

¹⁵⁵ LIGJI NR. 03/L-072 PËR ZGJEDHJET LOKALE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS neni 3.1

¹⁵⁶ Po aty neni 7

¹⁵⁷ LIGJI NR. 03/L-040 PËR VETËQEVERISJEN LOKALE, Nr. 28 / 04 QERSHOR 2008 neni 36.2

të interesit, në rast se janë anëtarë të komunitetit në pjesëmarrjen e vendimeve në çështje administrative, ku ndonjë anëtarë i familjes së tij mund të ketë interes personal¹⁵⁸.

Anëtarët e kuvendit Komunal, kanë të drejta dhe mundësi të barabarta në marrje pjesë në punimet e kuvendit si dhe të njoftohen me seancat dhe materialin e nevojshëm. Anëtarët e kuvendit komunal kanë të drejtën tu drejtohen të gjitha komisioneve dhe komitetet për çështje të ndryshme. Anëtarët e kuvendit kompensohen për punën e bërë si dhe kanë të drejtë të mungojnë për periudha të caktuara kohore¹⁵⁹.

Funksionet e kuvendit të komunës

Funksionet dhe kompetencat e veta kuvendi i komunës i ushtron në bazë të ligjit, statutit dhe akteve të tjera nënligjore.

Miraton; Statutin, rregulloren e punës dhe rregullore tjera komunale, miraton buxhetin dhe planet investuese, themelon komisione dhe komitetet, zgjedh Kryesuesin.¹⁶⁰

Kuvendi i komunës, zgjedh kryesuesin e vetë nga radhët e anëtarëve të kuvendit, mandati i kryesuesit është për 4 vite i njëjtë me mandatin e anëtarëve zgjedhja e kryesuesit bëhet me vota të fshehta për tu zgjedhur kandidati duhet të marr gjysmën e votave në Kuvend.

Kryesuesi pas marrjes se mandatit mund të theret mbledhjet e Kuvendit komunal duke njoftuar asamblistët e komunës të paktën 7 ditë me herët. Të gjitha materialet duhet të afishohen për publikun dhe të jenë në gjuhët zyrtare.

Kuvendet komunale mbajnë mbledhjet e hapura, por përjashtimisht në raste të caktuara mbledhjet mund të jenë të mbyllura.

Fillimi i mbledhjeve bëhet pasi të jetë konstatuar kuorumi, i cili konstatohet para çdo mbledhje dhe vendimi. Votimi bëhet me vota të hapura dhe të mbyllur. Kryesuesi gëzon të drejtën e votës deblllokuese në rast se kemi votim të barabartë¹⁶¹. Shpërndarja e Kuvendit bëhet sipas fuqisë ligjore dhe në rast se Ministria përkatëse konstaton mos funksionim të kuvendit Qeveria

¹⁵⁸ LIGJI NR. 03/L-040 PËR VETËQEVERISJEN LOKALE, Nr. 28 / 04 QERSHOR 2008 neni 38

¹⁵⁹ LIGJI NR. 03/L-040 PËR VETËQEVERISJEN LOKALE, Nr. 28 / 04 QERSHOR 2008 neni 39

¹⁶⁰ Po aty neni 41

¹⁶¹ Po aty neni 48

mund ta shpërndaj Kuvendin. Kuvendi themelon edhe komitete si psh të përhershme, funksionale dhe ad hoc.

Kryetari i Komunës

Është organ ekzekutiv i cili zgjedhet përmes votave të drejtpërdrejta,¹⁶². Kandidat për kryetar mund të jetë çdo banor i regjistruar në komunën të cilën është duke garuar dhe të ketë jetuar së paku 3 vite në atë komunë. Në mënyrë që të njeh problemet e atij komuniteti ku edhe garon. Kryetar i komunës zgjedhet ai i cili fiton 50%, plus një (1) votë të numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme të hedhura në atë komunë¹⁶³. Mandati i kryetarit të komunës është katër vjeçar¹⁶⁴.

Mandati i kryetarit të Komunës përfundon sipas fuqisë ligjore dhe së drejtës natyrore.

Kryetari i komunës fillon mandatin në momentin e dhënies së betimit, para anëtarëve të kuvendit Komunal i njëjti është i obliguar ta bëjë betimin para anëtarëve të kuvendit Komunal jo më larg se 30 ditë në të kundërtën do ta humb mandatin.

Kryetari i komunës përfaqëson komunën dhe vepron në emër të saj, koordinon punët e politikës lokale, menaxhon buxhetin dhe mbikëqyr punën e saj, emëron dhe shkarkon drejtorët etj.

Kryetari i komunës është i obliguar ti shmangët konfliktit të interesit në vendimmarrje. Në çdo komunë kryetari i komunës ka të paktën një nënkryetar i cili ndihmon kryetarin në ushtrimin e punëve të tij. Kryetari për ushtrimin e punëve të tij themelon zyra të ndryshme për punë administrative. Kryetari nuk ka konflikte në funksionale me kuvendin e komunës.

Në komunat në të cilat të paktën 10% janë qytetar të komuniteteve jo shumicë do të kenë një kryetar për komunitetet¹⁶⁵. Në praktikë kjo dispozitë ligjore nuk zbatohet në komunat ku shumicë janë komuniteti serb ndërsa pakicë ai shqiptar sepse kjo refuzohet nga serbët. Ndërsa

¹⁶² LIGJI NR. 03/L-072 PËR ZGJEDHJET LOKALE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS neni 9

¹⁶³ Po aty neni 9 pika 5,

¹⁶⁴ LIGJI NR. 03/L-040 PËR VETËQEVERISJEN LOKALE, Nr. 28 / 04 QERSHOR 2008 neni 56 pika 2

¹⁶⁵ <https://kk.rks-gov.net/lipjan/staff/nenkryetari-per-komunitete/>

në raste të tilla mbetet e pafuqishme Ministria përkatëse kjo ngase kemi ndërhyrje edhe të faktorit ndërkombëtar.

Administrata Komunale

Administrata e komunës është e ndërtuar dhe e organizuar në drejtori, të cilat udhëhiqen nga drejtorët e emëruar nga kryetari i komunës¹⁶⁶. Drejtorët zgjedhën nga Kryetari i komunës dhe i përgjigjen atij nr i drejtorive është i ndryshueshëm edhe pse komunat kanë të drejtat dhe përgjegjësit e njëjta. Administrata komunal përbëhet prej komponentës politike (Drejtorëve) dhe Komponentës civile stafit administrativ të cilët punësohen në përputhje me ligjin për shërbyesit civil përmes konkurseve publike. Krahas drejtorive komunat kanë edhe zyrat ndërlidhëse të cilat janë nën varësinë e drejtorëve apo kryetarit. Numri i garantuar i të punësuarve në administratën komunal është 55 të punësuar. Kjo ndoshta është edhe një arsye shtesë që qeveritë të krijojnë komuna pa kritere ekonomike por për ato politike.

Drejtorët për punën e tyre i përgjigjen kryetarit dhe të njëjtit kanë obligim në shmangien e konfliktit të interesit. Puna në administratën lokale në Kosovë kryhet mbi bazën e parimit të efikasitetit pasi që pjesa dërmuese e punëve në administratë janë digjitalizuar¹⁶⁷.

Demokracia e drejtpërdrejtë në vetëqeverisjen lokale në Kosovë

Realizohet përmes:

- a.) Informimit publik dhe konsultimit
- b.) Peticionit
- c.) Iniciativës qytetare
- d.) referendumit

¹⁶⁶“Ligji për Vetëqeverisjen Lokale”, neni 62, pika 62.1 dhe 62.2.

¹⁶⁷<https://kk.rks-gov.net/prishtine/prishtina-4/plani-i-mobilitetit-te-qendrueshem-urban-te-prishtines-pmqu/> qasur me datë 09.06.2019

faza e **informimit publik**, në komunat në Republikën e Kosovës është obligim ligjor i nivelit komunal të paktën dy herë në vit të organizojë takime me qytetarët, në të cilin takim mund të marrin pjesë të gjithë personat e interesuar. Në takime të tilla përfaqësuesit komunal informojnë qytetarët në lidhje me planin e punës¹⁶⁸. Ajo që mbetet sfidë është mos zbatimi në përpikëri i ligjit për vetëqeverisje lokale pasi që Komunat në bazë të nenit 68.1 janë të obliguar ti ftojnë debatet e tilla dy javë para mbajtjes së tyre dhe siç shihet në linkun e poshtë shënuar¹⁶⁹ komuna informon vetëm pesë ditë me herët dhe kjo edhe cenon edhe zbatimin e Ligjit¹⁷⁰.

E drejta e peticioneve është kategori ligjore, dhe të njëjtat mund të organizohen në nivel komunal dhe të përcjellën pastaj tek organet e nivelit lokal. Në Republikën e Kosovës në bazë të hulumtimit të bërë nga studimi im empirik kam konstatuar se referendumet në nivel lokal nuk janë organizuar ngase pjesa dërmuese mendojnë se zëri i tyre në organizime të tilla shko në vesh të shurdhër. Mënyra e realizimit të referendumit dhe formave të tjera rregullohet edhe me akte komunale siç është statuti¹⁷¹.

Iniciativa Qytetare, në republikën e Kosovës si kategori kushtetuese¹⁷² dhe ligjore¹⁷³, Me këtë nismë në nivel lokal nënkuptojmë të drejtën e qytetarëve të cilët jetojnë në një territor të caktuar të komunës për të propozuar rregullore brenda fushë veprimtarisë së kuvendit një nismë të tillë mund ta marrin 15% e votuesve në atë komunë organet lokale në një afat sa më të shkurtër kohor i përgjigjen nismës së tillë.

Referendumi në nivel lokal, është e drejtë e garantuar për qytetarët, me të cilin qytetarët mund tu kërkojnë organeve komunale që rregullorja komunale ti nënshtrohet vullnetit të tyre. Në Kosovë mungesa e ligjit për referendumin ka shkaktuar pamundësi në organizimin e referendumeve lokale.

¹⁶⁸<https://kk.rks-gov.net/lipjan/wp-content/uploads/sites/20/2019/05/Njoftim-per-debat-publik.pdf>

¹⁶⁹<https://kk.rks-gov.net/lipjan/wp-content/uploads/sites/20/2019/05/20190527090825030.pdf>

¹⁷⁰<https://kk.rks-gov.net/lipjan/wp-content/uploads/sites/20/2019/05/Njoftim-per-debat-publik.pdf> në këtë venim komuna ka informuar vetëm pesë ditë me herët dhe kjo pastaj zbehë edhe pjesëmarrjen e qytetarëve.

¹⁷¹<https://kk.rks-gov.net/lipjan/wp-content/uploads/sites/20/2019/05/20190527090825030.pdf> neni 65

¹⁷² Kushtetuta e Republikës së Kosovës 15 qershor 2008 neni 79

¹⁷³ LIGJI NR. 03/L-040 PËR VETËQEVERISJEN LOKALE, Nr. 28 / 04 QERSHOR 2008 neni 70

Përveç këtyre formave në nivel Lokal në Republikën e Kosovës janë edhe këshillat e vendbanimeve dhe fshatrave, takimet me qytetarë, transparenca dhe diskriminimi pozitiv për komunitetet joshumicë. Pasi që ligji përfaqëson model proporcional në vendimmarrje mbi bazën e parimeve të demokracisë lokale.

Aktet komunale dhe rishikimi juridik i tyre

Aktet komunale sipas ligjit për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës janë:

- a) statuti o komunës;
- b) rregullorja e punës;
- c) rregulloret komunale; dhe
- d) çdo akt tjetër të nevojshëm apo të duhur për funksionim efikas të komunës.

Fjala draut rrjedhe nga fjala; Statút,-i m. sh. -e(t) në vete përfshijnë përmbledhje parimesh, rregullash e normash, sipas të cilave ndërtohet dhe zhvillon veprimtarinë e vet një organizatë politike a shoqërore, një shoqatë etj¹⁷⁴. Statuti i Komunës, është akti kryesor ligjor që miratohet nga komuna dhe në pajtim me legjislacionin e qeverisë qendrore që rregullon organizimin e brendshëm të komunës¹⁷⁵.

Statuti Komunal, është akt mbi bazën e së cilit funksionojnë komunat në republikën e Kosovës, statuti miratohet dhe mund të ndryshohet me shumicën e votave në Kuvend Komunal. Me anë të statutit përcaktohet mënyra dhe forma e bashkëpunimit ndërmjet komunës, dhe fshatrave apo vendbanimeve brenda territorit të një komune, me anë të statuti si akt i përgjithshëm nënligjor në nivel lokal organet e pushtetit lokal bëjnë konkretizimin e punëve të tyre. Statuti në brendësin e vetë përmban nene të cilët janë të shënuar me numra romak dhe kanë një rrjedh kronologjike të kompetencave komunale.

Jo rrallë herë në vetëqeverisjen lokale, liderët politik ngatërrojnë nocionin status dhe atë statut. Statusi është gjendje juridike e subjektit të së drejtës qoftë atij fizik apo juridik¹⁷⁶. Për dallim nga ligji, statuti përmban dispozita konkrete për vetëqeverisjen lokale duke përfshirë në vete

¹⁷⁴ Fjalori i gjuhës së sotme shqipe 1985 tiranë.

¹⁷⁵ LIGJI NR. 03/L-040 PËR VETËQEVERISJEN LOKALE, Nr. 28 / 04 QERSHOR 2008 neni 3

¹⁷⁶ státus,-i m. libr. pozitë shoqërore, ligjore etj. e dikujt a e diçkaje në marrëdhënie me të tjerët: statusi i nëpunësit civil (drejt.).

karakteristikat që ka niveli lokal. Andaj statuti komunës dallon varësisht pozitës gjeografike, juridike dhe politike në komuna, pra me anë të statutit komuna rregullon funksionimin e saj të brendshëm.

Rregullorja e punës dhe rregulloret tjera komunale

Janë akte juridike me anë të cilave rregullohet mënyra e funksionimit të organeve në nivel lokal. Rregulloret në nivel lokal përmbajnë norma juridike me anë të së cilave organet e vetëqeverisjes lokale rregullojnë fushë veprimtarinë e vetë. Rregulloret komunale përfshirë edhe statutin mund ti nënshtrohen formës së demokracisë së drejtpërdrejtë.

Organet e nivelit lokal i nënshtrohen parimit të subordinimit dhe kontrollit të punës nga niveli qendror edhe për punët që janë kompetencë e nivelit lokal.

Vijmë në përfundim se Republika e Kosovës ka një sistem mirë të unifikuar të vetëqeverisjes lokale madje në shumë situata është dhe mbetet model për vendet fqinje ngase pavarësisht problemeve ndëretnike dhe luftës së fundit ajo ka privilegjuar komunitetet jo shumicë madje, madje ju ka dhënë edhe kompetenca të zgjeruara, si në vendimmarrje ashtu edhe në rritjen dhe pavarësinë e tyre në raport me pushtetin qendror.

Pastaj, sistemi i qeverisjes është më unik ngase ka arritur shkallë të gjerë të digjitalizimit, realizim më të mirë të demokracisë së drejtpërdrejtë.

Zgjedhjet në nivel lokal kanë arritur standarde të larta ndërkombëtare të cilat tashmë edhe janë vlerësuar nga faktori ndërkombëtar.

Infrastruktura në nivel lokal, tashmë ka filluar të jetë e dorës së dytë ngase kemi përmirësime të dukshme. Ndarja e investimeve në Kosovë nuk mbetet pre e diskriminimeve etnike si në vendet fqinje, mendësia në nivel lokal ka filluar të ndryshojë dhe ka ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies. Ajo që mbetet sfidë është pjesëmarrja e femrës në nivel lokal dhe pjesëmarrja e qytetarëve në debate publike.

MODELET E ASOCIACIONEVE NE DISA VENDE TE EVROPËS JUGLINDORE

Më poshtë do të paraqiten modelet e asociacioneve të komunave në vendet e ish Jugosllavisë dhe natyrisht pjesë e pashmangshme edhe ai Republikës së Shqipërisë;

Vendi / Rajoni	Emri	Emri lokal
 Shqipëri	Asociacioni i Komunave Shqiptare	Shoqata e Bashkive te Shqipërisë
 Kroacia	Asociacioni i Komunave të Republikës së Kroacisë	Udruga e Komunës në Republikën e Kroacisë
 Sllovenia	Asociacioni i Komunave dhe Qyteteve të Sllovenisë	Skupnost občin Slovenije
 Kosovë	Asociacioni i Komunave të Kosovës	Asociacioni i Komunave të Kosovës
 Mali i Zi	Bashkimi i Komunave të Malit të Zi	Komuniteti i Komunës së Çashkës
 Maqedonia Veriore	Asociacioni i Njësive të Vetëqeverisjes Lokale të Republikës së Maqedonisë	Заедница на единиците на локалната самоуправа
 Serbia	Konferenca e Përhershme e Qyteteve dhe Komunave	Stalna konferencija gradova i komunës - Bashkia e qyteteve dhe komunës së Serbisë

Modeli i Shoqatave Shqiptare

Misioni dhe objektivat

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë është një shoqatë jopolitike, jofetare dhe jofitimprurëse. Shoqata e Bashkive të Shqipërisë është një bashkim vullnetar dhe i pavarur i bashkive të Shqipërisë. SHBSH u themelua më 12 tetor 1993, me kërkesë të një grupi prej 10 kryetarë bashkish.

Shoqata numëron si anëtarë vullnetarë të saj, të gjitha bashkitë e Shqipërisë. SHBSH mban statusin e një organizate jofitimprurëse (OJF) me një shtrirje gjeografike në të gjithë territorin e vendit. Përpjekjet e saj të vazhdueshme kanë synuar sensibilizimin e strukturave dhe institucioneve të pushtetit qendror për përsheptimin e procesit të decentralizimit, si dhe konsolidimi i rolit të bashkive në ushtrim të rolit të tyre qeverisës, duke dhënë në vazhdimësi rezultate konkrete. Roli dhe kontributi i shoqatës sot është mjaft i vlerësuar dhe i njohur jo vetëm nga anëtarët e saj por edhe nga institucionet në pushtetin qendror, donatorët, shoqatat ndërkombëtare të autoriteteve vendore.

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë, qysh nga themelimi i saj e deri tani, ka krijuar një vizion gjithnjë e më të qartë të veprimtarisë së saj, të rolit që ajo duhet të luajë në konsolidimin e bashkive, në ushtrim nga ana e tyre të funksioneve qeverisëse¹⁷⁷

Struktura organizative e Shoqatës përbhet nga;

- a.) Drejtori Ekzekutiv
- b.) Financieri
- c.) Juristi
- d.) Specialisti për marrëdhëniet me publikun dhe menaxhimin e projekteve
- e.) Specialisti për marrëdhëniet me jashtë

¹⁷⁷ <https://aam.org.al/rreth-nesh/>

f.) Asistenti

Shoqata punon në bazë të legjislacionit vendor të Republikës së Shqipërisë¹⁷⁸.

Modeli Slloven i asociacionit;

Shoqata e Bashkive dhe Qyteteve të Sllovenisë (Slloven : *Skupnost občin Slovenije*) (SOS) është themeluar në vitin 1992 dhe është shoqata më e madhe përfaqësuese e komunave të Sllovenisë . Shoqata ka 167 komuna anëtare (nga 212 komuna) dhe me këtë mbulon gati 90% të banorëve të Sllovenisë¹⁷⁹ . Trupi më i lartë i komunitetit të komunave të Sllovenisë është Kuvendi, i cili përbëhet nga përfaqësues dhe përfaqësues të të gjitha komunave.

Krijimi i një asociacioni të tillë ka ardhur si rezultat i nevojave të ndryshme të komunitetit lokal. Asociacioni i Komunave të Slloveni organizohet në tri nivele të seksioneve si¹⁸⁰;

- a.) Seksioni i bashkive të qytetit,
- b.) Seksioni i komunave me njësi administrative të themeluara dhe
- c.) Seksioni i komunave të tjera.

Detyrat e Asociacionit të Komunave dhe Qyteteve të Sllovenisë janë, në veçanti, zbatimin dhe përfaqësimin e interesave të përbashkëta të komunitetit lokal në përpjesëtim me koordinimin me aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat me zgjidhjet e tyre ndikojnë në situatën e komunave. Midis kësaj, ka shumë detyra të tjera, ndër të tjera¹⁸¹:

- Ata hartojnë dhe kryejnë lloje të ndryshme të edukimit për komunitetet anëtare
- Ai ofron ndihmë dhe këshilla shkencore për komunitetet anëtare në ato fusha ku është e nevojshme

¹⁷⁸ <https://aam.org.al/legjislacioni/>

¹⁷⁹ emljevid" . Skupnostobcin.si. Arkivuar nga origjinal në 2010-04-23 . Marrë 2010-12-12

¹⁸⁰ <https://skupnostobcin.si/organi-in-delovna-telesa/>

¹⁸¹ Po aty

- Ajo jep efekt dhe përfaqëson interesat e përbashkëta të komunitetit ndaj autoriteteve shtetërore dhe organizatave ndërkombëtare
- Krijon projekte të përbashkëta zhvillimi
- Ai përfaqëson interesat e komunitetit në negociatat për kredi financiare të destinuara për komunitetin nga buxheti i shtetit
- Ai përfaqëson interesat e komunitetit në procedurat e bërjes së kontratës kolektive për sektorin publik
- Përgatit materiale profesionale për nevojat e komunitetit
- Ai kujdeset për informimin e rregullt të komunitetit anëtar, për çështjet që janë të rëndësishme për funksionimin e komunitetit.

Asociacioni i Komunave në Republikën e Kroacisë

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale dhe Rajonale themeloi të drejtën e njësive të vetëqeverisjes lokale dhe rajonale për të krijuar shoqatat e tyre për promovimin dhe realizimin e interesave të përbashkëta¹⁸².

është një organizatë jo-fitimprurëse , jo-qeveritare dhe jo-partizane organizatë e themeluar mbi parimin e shoqatës vullnetare.

Është themeluar nga bashkitë kroate me qëllim të promovimit dhe mbrojtjes së interesave të tyre të përbashkëta. Në vitin 2015 Shoqata e komunave numëron 284 (nga gjithsej 428) komuna nga të gjitha 20 qarqet kroate¹⁸³

Shoqata është themeluar më 19 qershor 2002. në Zagreb , në bazë të Ligjit për Shoqatat dhe Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe Rajonale. Komunitetet kroate kanë qenë anëtarë të Shoqatës së Qyteteve dhe Komunave nga viti 1975 deri në vitin 2002 deri në shpërbërjen e organizatës dhe janë krijuar tri shoqata të veçanta të qeverisjes vendore : Shoqata e Bashkive, Shoqata e Qyteteve dhe Shoqata e Qarkut Kroate. Nga viti 2012 deri në vitin 2015 ka qenë Koordinimi i Pushtetit Lokal (KOLOS) i përbërë nga Asociacioni i Komunave dhe Shoqata e Qyteteve¹⁸⁴.

Organet drejtuese të përcaktuara me Statutin e Asociacionit të Komunave:

- Presidenti¹⁸⁵
- Zëvendës presidentët (tre)¹⁸⁶
- bordi drejtues¹⁸⁷
- Asamblatë¹⁸⁸

¹⁸² <https://www.udruga-opcina.hr/hr/o-nama/lokalna-samouprava-u-rh-73>

¹⁸³ "Rreth nesh" . Asociacioni i Komunave të Republikës së Kroacisë, Kroaci . Marrë 15 maj 2015 .

¹⁸⁴ "Sfondi institucional" (në kroatisht). Asociacioni i Komunave të Republikës së Kroacisë, Kroaci

¹⁸⁵ <https://www.udruga-opcina.hr/en/managing-bodies/president>

¹⁸⁶ <https://www.udruga-opcina.hr/en/managing-bodies/vice-presidents>

¹⁸⁷ <https://www.udruga-opcina.hr/en/managing-bodies/managing-board>

¹⁸⁸ <https://www.udruga-opcina.hr/en/managing-bodies/assembly>

Aktivitetet kryesore të shoqatës përfshijnë: promovimin e bashkëpunimit dhe ndarjen e përvojave ndërmjet komunave kroate;

Promovimi i veçorive të veçanta në sferat ekonomike , kulturore dhe të tjera të jetës komunale ;

Rishikimin ligjor të legjislacionit relevant për vetëqeverisjen lokale ;

Lehtësimi i trajnimit profesional për zyrtarët dhe punonjësit vendorë;

Organizimi i konferencave dhe takimeve tematike relevante për komunat dhe interesat e tyre;

Avokimi i interesave komunale para organeve të qeverisë qendrore dhe institucioneve të tjera ;

Ndihmon anëtarët për të krijuar bashkëpunime komunat jashtë Kroacisë;

bashkëpunimi me organizatat e ngjashme si në vend ashtu edhe jashtë, si dhe me organizatat të cilat mandatet kontribuojnë në qëllimet dhe parimet kryesore të shoqatës;

Shkëmbimin e rregullt të informacionit me anëtarët e tij dhe aktivitete të ndryshme botuese dhe printimi¹⁸⁹.

¹⁸⁹ <http://www.udruga-opcina.hr/en/about-us>

Asociacioni i komunave në Republikën e Maqedonisë Veriore

Misioni i Bashkësisë së njësive të vetëqeverisjes lokale të Republikës së Maqedonisë së Veriut

U themelua në vitin 1972, por u rikonstitua më 1995, kur u soll Ligji për vetëqeverisje lokale.

Në periudhën prej 1990-1996 kur nuk kishte ligj gjithëpërfshirës për vetëqeverisje lokale, BNJVL ishte shumë aktive në emër të komunave. Bashkësia hartoi model-statute për punën e komunave dhe të njëjtat u'a distribuoi anëtarëve të saj. Gjithashtu siguroi forum për debat lidhur me këto modele, ndërsa morri pjesë edhe në hartimin e ligjit të ri për vetëqeverisje lokale. Sipas rregullatives ekzistuese të gjitha komunat detyrimisht janë anëtare.

Misioni i përgjithshëm i bashkësisë është të përmirësohen parimet e qeverisjes lokale rreth këtyre aktiviteteve:

- a.) Promovimi dhe nxitja e bashkëpunimit të përbashkët dhe shkëmbimi i informacioneve midis anëtarëve;
- b.) Të shërbejë si grup për lobim dhe të veprojë si bord këshillëdhënës i qeverisë qendrore në lëmin e vetëqeverisjes lokale;
- c.) Promovim i bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe konstruktiv i vetëqeverisjeve lokale dhe pushteteve qendrore;
- d.) Vendosje të marrëdhënieve me asociacionet nacionale dhe ndërkombëtare të pushteteve lokale;
- e.) Organizim i trajnimeve dhe konferencave për anëtarët e saja¹⁹⁰.

¹⁹⁰ <http://www.zels.org.mk/Default.aspx?id=fa0077c9-56d4-4b43-90dd-e9817c0d6fa6>

Organet drejtuese të asociacionit;

- a.)** -Kuvendi Gjeneral, i përbërë nga 9 delegatë (81 kryetarë komunash dhe 9 anëtarë të Komitetit të këshillave të BNJVL-së)
- b.)** -Bordi drejtues, i përbërë nga 22 anëtarë (19 kryetarë komunash dhe 3 anëtarë të Komitetit të këshillave të BNJVL-së)
- c.)** -Bordi mbikëqyrës, i përbërë nga 6 anëtarë (5 kryetarë komunash dhe 1 anëtar të Komitetit të këshillave të BNJVL-së)
- d.)** -Komiteti i këshillave, i përbërë nga 9 anëtar.

Asociacioni i Komunave në Malin e Zi

Objektivat e Komunitetit janë:

Bashkimi i Komunave të Malit të Zi është shoqata e bashkësive lokale për territorin e Malit të Zi, i themeluar për realizim nevojat dhe interesat e përbashkëta. Komunitetet lokale në kuptim janë: komunat.

Bashkimi i Komunave do të organizohet sipas parimeve të vullnetarizmit, komunitetit dhe komunitetit barazinë e komuniteteve lokale, respektin e ndërsjellë dhe parimet e etikës¹⁹¹.

Misioni i këtij asociacioni është

- përmirësimi, zhvillimi dhe mbrojtja e sistemit të vetëqeverisjes lokale;
 - përfaqësimi i interesave të komuniteteve lokale para autoriteteve qendrore;
 - përfaqësimi i interesave të bashkësive lokale para ndërkombëtarëve
- organizatat dhe shoqatat e autoriteteve lokale,
- realizimi i nevojave dhe interesave të tjera të komuniteteve lokale,

Organet drejtuese të asociacionit të Komunave në Malin e Zi¹⁹²

Kuvendi i Komunitetit

Bordi i Drejtorëve

Bordi Mbikëqyrës

Sekretari i Përgjithshëm i Komunitetit

Ndihmës Sekretar i Përgjithshëm

Organet punuese të Komunitetit të Komunave

¹⁹¹ STATUT ZAJEDNICE OPŠTINA CRNE GORE, Statut stupa na snagu danom donošenja. Broj:01-03/03 PREDSEDNIK ZAJEDNICE Podgorica, 24.09.2003. Relja Jovančević,s.r. Izmjene i dopune br. 01-02/07 Podgorica, 25.05.2007. Izmjene i dopune, br. 01-03/09 Podgorica, 09.04.2009. Izmjene i dopune, br. 01-08-2/11 Podgorica, 23.12.2011.

¹⁹² <http://uom.me/about/>

Asociacioni i Komunave të Kosovës

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) është formuar në vitin 2001 pas zgjedhjeve të para demokratike komunale në Kosovën e pasluftës. Themelimi i Asociacionit të Komunave të Kosovës është mbështetur në nenin 10 të Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale në kuadër të Këshillit të Evropës (e drejta për asociacion). AKK-ja është organizatë joprofitabile, është person juridik që i përfaqëson interesat e përgjithshme të anëtarëve të saj – autoritetet lokale. Anëtarë të Asociacionit janë autoritetet lokale të Kosovës.

Autoritetet lokale anëtarësohen në Asociacion nga Kuvendi i Asociacionit pas vendimit të marrë në Kuvendin Komunal.

AKK-ja angazhohet që në Kosovë të implementohen rregullat nga Karta Evropiane për Vetëqeverisjen lokale.

MISIONI

Misioni i Asociacionit të Komunave të Kosovës është të krijoj qeverisje lokale efikase, të qëndrueshme dhe demokratike përmes përpjekjeve të përbashkëta me komunat dhe përmes tyre të arrihet një performancë e kualitetit të lartë në shërbimin e nevojave për anëtarët e saj¹⁹³.

VIZIONI

Që të krijohet një qeveri lokale efikase, e qëndrueshme dhe demokratike

OBJEKTIVAT

Përmirësimi i strukturave legislative të vetëqeverisjes dhe efikasiteti praktik i implementimit të tyre;

Nxitja e decentralizimit të pushtetit, përmes mbështetjes praktike dhe bashkëpunësimit mbi baza të barabarta, mes Autoriteteve qendrore dhe atyre lokale;

¹⁹³ <http://komunat-ks.net/sqper-neenper-nesrabout-us/?lang=sq>

Zgjerimi i mbështetjes publike për demokracinë lokale që përfshin qytetarët dhe komunitetin e biznesit dhe ngritja e besimit në vetorganizimin e tyre dhe gatishmërisë së tyre për të marrë pjesë në qeverisjen lokale;

Shtimi i kompetencave, njohurive dhe kapaciteteve të Komunave për të siguruar kualitete të larta dhe efektive në shërbimet lokale;

Gjetja e burimeve alternative financiare për Komunat;

Demonstrimi se Komunat e Kosovës janë të barabarta dhe kanë partneritet kompetitiv me Autoritetet lokale në Evropë dhe në mbarë Botën;

Mbështetja e zhvillimit të Asociacionit në përputhje me ndryshimet në qarqet e brendshme dhe të jashtme.

Dokumentet themelore¹⁹⁴:

- a) Rregullorja e punës së Kuvendit të Asociacionit të Komunave të Kosovës
- b) Statuti i AKK-së
- c) Strategjia e AKK-së

Struktura Organizative e AKK-së¹⁹⁵

- a) Kuvendi i AKK-së
- b) Bordi Udhëheqës

¹⁹⁴ <http://komunat-ks.net/dokumentet-themelore/?lang=sq>

¹⁹⁵ <http://komunat-ks.net/struktura-organizative/?lang=sq>

Asociacioni i bashkësive lokale në Serbska

Shoqata e bashkive dhe qyteteve të Republikës Srpska është themeluar në Bërçko 1998. si shoqatë e pavarur, jopolitike dhe jo-partiake e autoriteteve lokale të drejtuara për përkrahjen dhe promovimin e vetëqeverisjes lokale.

Anëtarët e Asociacionit janë bashkitë dhe qytezat e mbledhura në mënyrë vullnetare për të shkëmbyer përvojat, për të përmirësuar bashkëpunimin dhe për të vepruar si një, duke synuar realizimin e interesave të përbashkëta të përcaktuara në statutin, ligjet dhe aktet e tjera ligjore të shoqatës.

Pse shfaqen shoqatat / koalicionet e autoriteteve lokale në të gjitha vendet e Evropës Lindore dhe Qendrore? Pse është e dobishme të kemi një shoqatë të autoriteteve lokale? Pse komunat me probleme financiare ekzistuese duhet të jenë gati për të financuar një shoqatë?

Ka tre motive për këtë¹⁹⁶:

Komunat përballen me probleme të kompetencës dhe financimit. Konkurrenca në lidhje me kompetencën me pushtetin qendror dhe varësinë financiare nga qeveria qendrore ekziston kudo. Autoritetet lokale konsiderojnë se mund të bëjnë punën e tyre shumë më mirë në kushte më të decentralizuara.

Motivi i dytë i bashkëpunimit me shoqatën është kursimi i parave gjatë punës së përbashkët. Shoqata është një mënyrë efektive për të organizuar aktivitete dhe funksione të specializuara që janë tepër të shtrenjta nëse komunat do të merren veçmas me ta.

Së bashku ne dimë më shumë.

Arsyeja e tretë për ekzistencën e shoqatës qëndron në arritjen e komunikimit më të mirë. Tre mënyra të komunikimit duhet të përmenden:

Komunikimi horizontal - komunikimi ndërmjet komunave me qëllim të këmbimit të ideve dhe përvojave;

¹⁹⁶ <http://www.alvrs.com/v1/index.php/en/about-alvrs/missions-and-tasks>

Komunikimi vertikal (formulimi i ideve në nivel lokal dhe transmetimi i tyre në nivelin qendror;
Komunikimi vertikal (nga poshtë lart).

-Transmetimi i ideve të reja (për shembull, për ligjet e reja) nga niveli qendror në nivelin e autoriteteve lokale.

Organet e Asociacionit

- a) Asambleja është organi më i lartë i Shoqatës.
- b) Presidenca
- c) Bordi mbikëqyrës është themeluar si organ i Kuvendit për të kontrolluar punën e organeve të Shoqatës dhe kontrollin e menaxhimit të materialit financiar.
- d) Sekretari i Përgjithshëm në mënyrë të drejtpërdrejtë kryen konkluzionet e organeve të Shoqatës.
- e) Shërbimi profesional
- f) Bordet tematike

Fokusi i tij kryesor është:

Promovimi i parimeve dhe vlerave të qeverisjes vendore,
Zhvillimi dhe mbrojtja e pushtetit lokal mbi parimet e demokracisë dhe decentralizimit,
Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve lokale dhe organizimit të tyre,
Avokimi i interesave të përbashkëta të anëtarëve të saj në nivel shtetëror. Fillimi i dialogut me përfaqësuesit e institucioneve shtetërore në emër të anëtarëve të saj.
Bashkëpunimi me asociacionet kombëtare dhe ndërkombëtare të autoriteteve lokale.

Asociacioni i Komunave Serbe në Kosovë

Sipas dokumentit prej njëzet e dy pikave, të dakorduar në vitin 2015 ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të quajtura Parimet e Përgjithshme “Asociacioni i Komunave Serbe”, mund të konsiderohet edhe në “mini shtet brenda shtetit”?!

Mënyra e funksionimit të asociacionit të komunave serbe do të ketë një statut të miratuar nga organi themelues e ngjashme me kushtetutë.

Asociacioni është pritur të ketë edhe kuvendin si trup supreme, siç është paraparë në pikën gjashtë, pastaj të gjitha aktet normative si rregullore etj. Dhe me këtë strukturë do të ketë ngjashmëri me parlamentin.

Ajo që ishte shqetësuese se asociacioni kishte parashikuar të ketë edhe president dhe zëvendëspresident, këshillin dhe bordin e vetë të cilët do të zgjidheshin nga radhët e komunave serbe.

Asociacioni i komunave serbe do të ketë edhe statutin e saj (Kushtetutën), i cili do të hartohet nga bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Asociacioni të ketë kompetenca për iniciimin e lëndëve në Gjykata Kushtetuese.

Anëtarësimi në këtë asociacion të bëhet vetëm me pranim nga katër vendet themeluese të këtij asociacioni

Financimi do të bëhet nga të hyrat vetanake, grandet e Qeverisë së Kosovës dhe nga donacionet tjera të cilat vijnë nga Republika e Serbisë¹⁹⁷

Ky asociacion është bërë shkas edhe i agjendës së bisedimeve të cilat zhvillohen ndërmjet Republikës serbe dhe Qeverisë së Kosovës, bisedime këto fillimisht të udhëhequra në nivel presidentëve të vendeve.

¹⁹⁷ Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Asociacioni_perkthimi_shqip_-_final.pdf

Karta evropiane për vetëqeverisje lokale¹⁹⁸ por edhe Ligji për vetëqeverisje lokale¹⁹⁹ lejon krijimin e asociacioneve dhe bashkëpunimi ndërkomunal. Pas miratimit të ligjit për normalizimin marrëdhënies së Republikës së Kosovës dhe asaj serbe, kuvendi i Kosovës kishte miratuar; Ligjin mbi Ratifikimin e Marrëveshjes së Parë dhe ligjet e Kosovës.

Ligj, ky i cili ishte bërë shkas që Presidentja e Kosovës në bazë të kompetencave të veta Kushtetuese të dërgoj çështjen e asociacionit të komunave serbe në Gjykatën Kushtetuese për të vlerësuar ligjshmërinë e saj me Kushtetutën e Kosovës dhe vendosjen e masave të përkohshme ndaj këtij ligji.

Gjykata Kushtetuese, pas pranueshmërisë së rastit Gjykata kushtetuese mori dy mendime si *amicus curiae*, dhe një letër nga grupi parlamentar i listës sërboska për të paraqitur argumentet e tyre por e njëjta nuk ka paraqitur fare komente.

Pas plotësimit të kushteve formale Juridike gjykata Kushtetuese kërkojë opinionet e *amicus curiae*, si në vijim²⁰⁰;

- a. Cila është natyra juridike e një asociacioni të komunave?
- b. Përkitazi me asociacionin e komunave, çfarë rregullohet zakonisht në mënyre normative dhe deri në çfarë mase?
- c. Cili është statusi i të punësuarve në administratën e asociacioneve të tilla?

Amicus Curiae, z. Istrefi dhe pallaska kishin paraqitur parashtresat e tyre²⁰¹. Të cilët kishte identifikuar bazën juridike dhe ligjore për pranueshmërinë e rastit. Për me teper *Amicus Curiae* Istrefi dhe Pallaska japin një analizë në lidhje me çështjet juridike që kanë të bëjnë me asociacionet e komunave në aspekt krahasues, duke u fokusuar në të drejtën e komunave për të formuar apo për të bashkuar asociacioneve dhe në çështjen e bashkëpunimit ndërkomunal. Dhe vijnë në përfundim se një asociacion i tillë është në kundërshtim me frymën kushtetuese të Republikës së Kosovës.

¹⁹⁸ Karta Evropiane mbi Vetëqeverisjen Lokale 1985 neni 10

¹⁹⁹ LIGJI NR. 03/L-040 PËR VETËQEVERISJEN LOKALE, Nr. 28 / 04 QERSHOR 2008 neni 32 dhe 32

²⁰⁰ Gjykata kushtetuese e Republikës së Kosovës AKTGJYKIM në Rastin nr. K0130/15 fq 4

²⁰¹ *Amicus Curiae*, z. Kushtrim Istrefi me datë 26. Nëntor 2015

Si rrjedhojë e analizimit të situatës Jurdike Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës konstaton se; krijimi i një asociacioni të tillë me kompetenca ekzekutiv nuk është në frymën e parimeve kushtetuese dhe me kapitullin III, të Kushtetutës së Kosovës, si dhe vendos masat e përkohshme në raport me ligjin e miratuar. Dhe ndanë mendim se themelimi i një asociacioni të tillë duhet bëhet në frymën e parimeve Kushtetuese²⁰². Dhe në përputhje me Kapitullin II dhe III të Kushtetutës si dhe me nenet 57,59,60,61 dhe 62 si dhe me nenet 79,81,93,101,113,123,124 dhe 137²⁰³. Kësisoj këto parime duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën e Kosovës dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese

Krijimi i një asociacioni të tillë të proklamuar nga Qeveria e Kosovës, do të ishte i dëmshëm dhe do të krijonte një “mini shtet”, brenda territorit të Kosovës ngase do me ndihmën e strukturave serbe do të krijohej edhe autonomia lokale dhe komunat serbe do të krijonin edhe status të veçantë ngase do të bënin edhe delegim te kompetencave të tyre e që një situatë e tillë është e ndaluar edhe me ligjin për vetëqeverisje lokale. Krijimi i një asociacioni të komunave serbe do të mund të krijohej ngjashëm me asociacionin e komunave të Kosovës. Asociacion ky që ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit ndërkomunal. Dhe në teorinë juridike bashkëkohore, krijimi i asociacionet mbi baza etnik do të ndikonte keq e më keq në një qeverisje sa më afër qytetarëve.

Modelet e asociacioneve në vendet Evropës juglindore janë më të ndryshme se modeli i kërkuar nga pala serbe. Madje asi ai në Republikën e Serbisë nuk është i tillë. Ajo që mbetet shqetësuese është fakti se sërbia insiston në krijimin e këtij asociacioni me qëllim të “normalizimit të raporteve ndër etnike”, por një asociacion i tillë vetëm sa zbehë raportet ndër shtetërore dhe krijon destabilitet brenda Republikës së Kosovës.

Legjislacioni aktual serb ende e trajton Kosovën si pjesë integrale të Serbisë (zyrtarisht *Krahinën Autonome të Kosovës dhe Metohisë*) edhe pse Kosova shpalli pavarësinë në vitin 2008. Kushtetua e Serbisë ende nuk është ndryshuar po ashtu edhe *Ligji*

²⁰² Gjykata kushtetuese e Republikës së Kosovës AKTGJYKIM ne Rastin nr. K0130/15 fq 39

²⁰³ Kushtetuta e Kosovës 15 qershor 2008.

mbi Organizimin e vetëqeverisjes Territorial përcakton 28 komuna dhe 1 qytet në territorin e Kosovës²⁰⁴.

Qeveria e Serbisë nuk e njeh riorganizimin territorial të Kosovës, edhe pse disa prej këtyre komunave të reja kanë shumicën serbe dhe marrin pjesë në zgjedhjet lokale²⁰⁵. Por që këto parti politike që garojnë në zgjedhjet lokale janë parti të koordinuara me qeverinë serbe. Dhe janë të ndërtuara mbi bazën e një fryme jo demokratike dhe urrejtëse.

Andaj asociacioni i komunave Serbe në Kosovë mund të krijohet ngjashëm me asociacionin e komunave të Kosovë dhe me ato të vendeve të Evropës Juglindore, dhe të funksionojë në kuadër të frymës kushtetuese dhe vendimit të Gjykatës Kushtetuese në mënyrë që një asociacion i tillë të promovojë vlera demokratike.

²⁰⁴ "Закон о територијалној организацији Републике Србије" [Ligji për Organizimin Territorial të Republikës së Serbisë]. Службени гласник Републике Србије(129): 3-41. 2007. ISSN 0353-8389 .

"Закон о именанама и допунама Закона о територијалној организацији Републике Србије" [Ligji për Ndryshimin e Ligjit për Organizimin Territorial të Republikës së Serbisë]. Службени гласник Републике Србије (18): 32-34. 2016. ISSN 0353-8389 Ligjit për Organizimin Territorial të Republikës së Serbisë]. Службени гласник Републике Србије (18): 32-34. 2016. ISSN 0353-8389

²⁰⁵ UNMIK: bojkoti serb krijon probleme të reja" . B92. 22 nëntor 2007. Arkivuar nga origjinal në 8 qershor 2011 . Marrë 4 dhjetor 200

Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore aspekt krahasues me legjislacionin e Kosovës

Kjo tabelë përmban një analizë të legjislacionit aktual për vetëqeverisje lokale dhe Kartës Evropiane për autonomi Lokale dhe zbatueshmërisë së saj në Republikën e Kosovës përmes tabelës si në vijim.

	<i>Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore</i>	<i>Statusi i vetëqeverisjes Lokale në Republikën e Kosovës 2008-2019</i>
Neni 2 *	Parimet e vetë qeverisjes lokale për t'u përfshirë në legjislacion ose mundësisht në Kushtetutë.	√ Këto parime gjenden në dispozitat Kushtetutën e Republikës së Kosovës në Kapitullin e X, neni 123
Neni 3.1 *	Përkufizime të qeverisjes vendore si të drejta dhe zotësi të pushtetit lokal për të rregulluar dhe menaxhuar funksione publike nën përgjegjësinë e tyre.	√ Kompetencat e pushtetit lokal në Republikën e Kosovës janë të sanksionuara në ligjin për Vetëqeverisje lokale i vitit 2008 LIGJI NR. 03/L-040 PËR VETËQEVERISJEN LOKALE, Nr. 28 / 04 QERSHOR 2008 Komunat i ushtrojnë kompetencat vetanake, të deleguara dhe të zgjeruara neni 16

Neni 3.2 *	Të drejtat e pushtetit lokal ushtrohen nga këshilla, anëtarët e të cilëve janë zgjedhur nga votime të lira dhe të fshehta, mbi parime të njëjta për të gjithë.	✓ LIGJI NR. 03/L-072 PËR ZGJEDHJET LOKALE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS sipas Nenit 3, Zgjedhjet Komunale mbahen në bazë të votës së lirë, të përgjithshme, të barabartë, të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë në përputhje me rregullat e këtij ligji dhe rregullave të KQZ-së. - Votuesit me të drejtë vote janë të barabartë në ushtrimin e të drejtës së
Neni 4.1 *	Përgjegjësitë dhe pushtetet kryesore duhet të jenë të parashikuara në Kushtetutë ose ligj. Megjithatë këto dispozita nuk duhet të ndalojnë dhënien e përgjegjësive të tjera specifike pushtetit lokal.	✓ Parimet bazë dhe përgjegjësitë janë përcaktuar Kushtetutën e Kosovës 15 Qershor 2008 me nenin 123 dhe janë mirë të specifikuara.
	Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore	<i>Statusi i vetëqeverisjes Lokale në Republikën e Kosovës 2008-2019</i>
Neni 4.2 *	Pushteti lokal duhet të ketë të drejta të plota në ushtrimin e iniciativave të tij në lidhje me çdo çështje që nuk përjashtuar nga kompetenca e tij ose i është dhënë një autoriteti tjetër	X Në Republikën e Kosovës, pushteti lokal nuk shfaqet me të drejta të plota në ushtrimin e iniciativave të tij, vetëm nëse një detyrë/kompetencë i është dhënë specifikisht atij. Pasi që Ministria përgjegjëse për qeverisje lokale është autoriteti mbikëqyrës.
Neni 4.3	Funksionet publike duhet në përgjithësi të ushtrohen nga ato autoritete, që janë më	✓ Sipas legjislacionit aktual në

	afër shtetasve. Dhënia e përgjegjësisë një tjetër autoriteti duhet të përcaktojë shtrirjen dhe natyrën e detyrës dhe kërkesën për mjaftueshmëri financiare.	Republikën e Kosovës, kur organet e pushtetit qendror delegojnë punët në nivelin lokal janë të obliguara edhe në mbulueshmërinë financiare
Neni 4.4 *	Pushteti i dhënë autoriteteve lokale duhet normalisht të jetë i plotë dhe ekskluziv; nuk duhet të kufizohet apo nënkuptohet nga ndonjë autoritet tjetër qendror ose rajonal.	✓ Kompetencat apo pushteti i dhënë në nivel lokal është mjaft i kuartë dhe i specifikuar me Ligjin për vetëqeverisje lokale Kreu i X
Neni 4.5	Kur pushtetit lokal i janë deleguar funksione, ai duhet në maksimumin e mundshëm të lejohet në zbatimin e këtyre detyrave, me diskrecion, sipas kushteve vendore.	✓ Ligji lejon një mundësi të tillë kjo mundësi madje tejkalon edhe Kartën Evropiane të vetëqeverisjes lokale tek kompetencat e zgjeruara, në komuna me komunitetet.
Neni 4.6	Autoritet lokale duhet të konsultohen herë pas here në mënyrën e duhur në procesin e planifikimit dhe vendimmarrjes për të gjitha çështjet që ju përkasin atyre direkt.	✓ Neni 83 i ligjit lejon konsultim paraprak me autoritet mbikëqyrëse sa i përket ligjshmërisë së akteve dhe autoritetet mbikëqyrëse janë të obliguara të përgjigjen brenda 30 ditësh.
Neni 5 *	Ndryshimet në kufijtë e pushtetit lokal nuk duhet të bëhen pa konsultime paraprake me komunitetin përkatës, mundësisht me referendum, kur është e lejuar dhe përcaktuar me ligj.	✓ Dispozitat ligjit për kufij administrativ NR. 03/L-041 lejojnë ndryshimin e kufijve administrativ i cili duhet të bëhet në konsultim me qytetaret e komunave të prekura nga ky

		ndryshim.
Neni 6.1	Pushteti lokal duhet të jetë i aftë të përcaktojë strukturën e tij të brendshme administrative në mënyrë që t'i përshtatë me nevojat lokale dhe të sigurojë menaxhim efektiv	√ Ligji për vetëqeverisje lokale lejon ndryshimin e strukturës së vetë administrative me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më afër qytetarëve. Kreu VIII i Ligjit.
	Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore	<i>Statusi i vetëqeverisjes Lokale në Republikën e Kosovës 2008-2019</i>
Neni 6.2	Kushtet e shërbimeve për punonjësit e pushtetit lokal duhet të jenë të atilla që të lejojnë rekrutimin e stafit të kualifikuar mbi bazën e konkurrimit dhe meritës; dhe të mundësisë për një trajnim të përshtatshëm, dhe progresit në karrierë.	√ Ligji për vetëqeverisje lokale mundëson rekrutimin e stafit edhe përmes partneritetit komunal neni 29 dhe ligjit për shërbyesit civil
Neni 7.1 *	Kushtet e punës së përfaqësuesve lokalë duhet të duhet të sigurojnë ushtrimin e lirë të detyrës së tyre.	√ Organet e nivelit Lokal, ushtrojnë pavarësi të jashtëzakonshme përjashtimisht rastit të kontrollit Hierarkik dhe instancional të punës së tyre.

	Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore	<i>Statusi i vetëqeverisjes Lokale në Republikën e Kosovës 2008-2019</i>
Neni 7.2	Përfaqësuesit lokal duhet të lejohen për një kompensim të përshtatshëm financiar si rrjedhojë e ushtrimit të detyrës por edhe si kompensim për punën e bërë.	√ Legjislacioni, aktual për vetëqeverisje lokale nuk përcaktojnë kompensim financiar. Por kompensimi financiar për punën e bërë dhe udhëtimet zyrtare është i rregulluar me ligjin NR. 03/L-048 , për menaxhimin e financave publike.
Neni 7.3	Çdo funksion dhe aktivitet që është i papajtueshëm me funksionin e përfaqësuesit lokal duhet të jetë i përcaktuar në ligj apo në kushtetutë.	√ Neni 38, 59 i ligjit për vetëqeverisje lokale përcaktojnë papajtueshmërinë në ushtrimin e kompetencave përkatësisht konfliktin e interesit.
	Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore	<i>Statusi i vetëqeverisjes Lokale në Republikën e Kosovës 2008-2019</i>
Neni 8.1	Çdo kontroll administrativ mund të ushtrohet vetëm sipas procedurave që në çdo rast duhet të jenë të parashikuara në kushtetutë apo ligj.	√ Neni 80 i ligjit për vetëqeverisje lokale përcaktojnë kontrollin e ligjshmërisë së punës së organeve komunale, po ashtu edhe ligji për administratën shtetërore lejon kontrollin e

		brendshëm dhe jashtëm. Edhe Kushtetuta e Kosovës lejon kontroll të punës së organeve administrative përmes kontrollit, financiar, politik, gjyqësor.
Neni 8.2 *	Kontrolli administrativ duhet të ketë si qëllim vetëm sigurimin e pajtueshmërisë me kushtetutën/ligjin.	✓ Kreu i X i ligjit për vetëqeverisje lokale dhe neni 80 obligon kryetarin e komunës të dërgojë tek autoritet mbikëqyrës të gjitha aktet e miratuara nga kuvendi i dhe kryetari për të shikuar ligjshmërinë.
	Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore	<i>Statusi i vetëqeverisjes Lokale në Republikën e Kosovës 2008-2019</i>
Neni 8.3	Kontrolli administrativ mbi Punën e organeve ne nivel lokal duhet të ushtrohet në mënyrë të atillë që ndërhyrja të jetë në proporcion me interesin që kërkohet të mbrohet.	✓ Kjo pjesë, është e rregulluar me Kushtetutë dhe me legjislacionin e administratës shtetërore organeve në nivel lokal i është dhënë hapësirë e mjaftueshme në kryerjen e punës.
Neni 9.1 *	Autoritetet lokale janë të autorizuar të kenë burime financiare të përshtatshme, të cilat mund t'i përdorin lirisht brenda kuadrit ligjor të kompetencave të tyre.	X Sipas Hulumtimeve, të bëra del se mbi 80 % e buxhetit të komunave është e varur nga ai qendror.

	Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore	<i>Statusi i vetëqeverisjes Lokale në Republikën e Kosovës 2008-2019</i>
Neni 9.2 *	Burimet financiare lokale duhet të përputhen me përgjegjësitë që i janë ngarkuar pushtetit lokal me Kushtetutë dhe ligj.	√ Komunat posedojnë buxhet të mjaftueshëm për realizimin e kompetencave të veta sipas ligjit për financat lokale.
Neni 9.3 *	Një pjesë e burimeve financiare të autoriteteve lokale duhet të vijë nga taksat lokale dhe tarifat, të cilat pushteti lokal ka autoritetin t'u përcaktojë masën.	√ SIPAS Ligjit për financat lokale janë disa mënyra të burimeve financiare KREU II Taksat Komunal e Neni 9 Taksa në Pronën e Paluajtshme Neni 10 Taksa për Lejen për Ushtrimin e Veprimtarisë Afariste Neni 11 Taksa për Lejen për Shërbime Profesionale Neni 12 Taksa për Automjetet Motorike Neni 13 Taksat Administrative Komunale Neni 14 Taksat për Lejet për Ndërtimin dhe Rrënimin e Ndërtesave dhe Strukturave të Tjera

		Neni 15 Taksat tjera Komunale Neni 16 Taksat për Lëshimin e Certifikatave dhe Dokumenteve Zyrtare e tj.
	Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore	<i>Statusi i vetëqeverisjes Lokale në Republikën e Kosovës 2008-2019</i>
Neni 9.4	Sistemi financiar i autoritetit lokal duhet të jetë mjaftueshëm i ndryshueshëm që të lejojë përputhshmërinë e tij me zhvillimin e vërtetë të kostos së detyrave të Pushtetit lokal.	X Pjesa dërmuese e financave varen nga pushteti qendror dhe shumë herë kemi interferime politike në ndarjen e buxhetit psh nëse pushteti lokal udhëhiqet nga subjekt politik opozitar në raport me atë qendror shpesh herë kemi zvogëlim të grandeve qeveritare
Neni 9.5	Mbrojtja e autoritetit lokal më të dobët financiarisht dergon në krijimin e procedurave për barazi financiare me qëllimin për të korrigjuar efektet e një shpërndarjeje të pabarabartë të burimeve potenciale	X Mungon unifikimi i sistemit të shpërndarjes së fondeve nga niveli qendror
	Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore	<i>Statusi i vetëqeverisjes Lokale në Republikën e Kosovës 2008-2019</i>
Neni 9.6	Autoritetet lokale duhet të pyeten, në mënyrën e duhur, për rrugën sesi burimet financiare do t'ju shpërndahen.	X Mungon koordinimi i nivelit lokal me atë qendror kjo varet nga vullneti politik i qeverisjes.

Neni 9.7	Sa më shumë të jetë e mundur grandet tek autoritet lokale nuk duhet të jepen për një projekt të specifikuar. Parashikimet për grandet nuk duhet të eliminojnë lirinë e autoriteteve lokale për të ushtruar një politikë diskrecionale brenda juridiksionit.	X Nuk është saktësuar me ndonjë normë juridike ndarja e tillë.
Neni 9.8	Në mënyrë që të kenë mundësi për të kërkuar hua për investime kapitale, autoritetet lokale duhet të kenë mundësi hyrjeje në tregun kombëtar të kapitaleve.	√ Komuna e Prishtinës ka hyrë në hua të tilla për blerjen e autobusëve me garancion nga Qeveria e Kosovës
Neni 10.1 *	Autoritetet lokale duhet të jenë të autorizuar, në ushtrimin e detyrave të tyre, të bashkëpunojnë, brenda kuadrit ligjor.	√ Kreu i V i vetëqeverisjes lokale lejon mundësinë e bashkëpunimit ndërmjet komunave në Republikën e Kosovës.
Neni 10.2	E drejta për t'i përkatur një shoqate për mbrojtjen dhe zhvillimin e interesave të njëjta dhe për të qenë pjesë e shoqatave ndërkombëtare, duhet të njihet nga Shteti.	√ Neni 33 i Ligjit për vetëqeverisje lokale lejon Asociacionet ndërkombëtare të autoriteteve lokale Asociacionet e komunave të Republikës së Kosovës mund të bashkëpunojnë me asociacionet ndërkombëtare të autoriteteve lokale.

	Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore	<i>Statusi i vetëqeverisjes Lokale në Republikën e Kosovës 2008-2019</i>
Neni 10.3	Autoritetet lokale duhet të jenë të autorizuar të bashkëpunojnë me të njëjtët e tyre në Shtete të tjera.	✓ Ligji për vetëqeverisje lokale lejon bashkëpunimin ndërkombëtar me qëllim të përmirësimit të jetës së qytetarëve
Neni 11 *	Autoritetet lokale duhet të kenë të drejtën t'i drejtohen gjykatës për të siguruar ushtrimin e lirë të kompetencave të tyre, parimi i vetë qeverisjes lokal. duhet të përcaktohet në ligj	✓ Dispozita kushtetuese të nenit paragrafi 4 i lejon Komunës të dërgoj çështje në Gjykatën Kushtetuese; Komuna është e autorizuar të kontestojë kushtetutshmërinë e ligjeve ose të akteve të Qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt.
Neni 10.3	Autoritetet lokale duhet të jenë të autorizuar të bashkëpunojnë me të njëjtët e tyre në Shtete të tjera.	✓ Ligji për vetëqeverisje lokale lejon bashkëpunimin ndërkombëtar me

		qëllim të përmirësimit të jetës së qytetarëve
Neni 12 *	Formulimi i parimeve të vetëqeverisjes vendore, të parashikuara në pjesën e parë të kartës, duhej të përpiquej të përfshinte larminë e gjerë të sistemeve ligjore dhe strukturave të qeverive vendor që kanë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës.	✓ Dispozita kushtetuese të Republikës së Kosovës tashmë kanë inkorporuar këto parime edhe pse Kosova nuk është palë nënshkruese e kësaj karte
Neni 13, 14, 15	Flasin për mënyrën e zbatueshmërisë së Kartës	✓ Republika e Kosovës për shkak të synimit të rrugës Evropiane tashmë një sërë aktesh ndërkombëtare i ka parashikuar në kuadër të së drejtës së brendshme.

Vijmë në përfundim se legjislacioni aktual i vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës është në përputhje me frymën evropiane të cilën e promovon edhe Karta Evropiane për vetëqeverisje lokale e vitit 1985, ndonëse kjo vije harmoni e legjislacionit vendore me atë ndërkombëtar vije si rezultat i frymës kushtetuese në Kosovë dhe aspiratave euroatlantike të cilat i ka paraqitur Kosova²⁰⁶. Republika e Kosovës në disa raste tejkalon edhe kartën për vetëqeverisje lokale ngase përmban edhe parimin e diskriminimit pozitiv në nivel lokal.

Ligji për vetëqeverisje lokale është i frymëzuar nga parimet e Kartës Evropiane mbi Vetëqeverisjen Lokale, në veçanti nga Neni 3, i cili paraqet ‘të drejtën dhe kompetencën e autoriteteve lokale, brenda kufijve të ligjit, për të rregulluar dhe për të menaxhuar një pjesë të

²⁰⁶ Premabula e Kushtetutës së Republikës së Kosovës 15 qershor 2008 fq V

konsiderueshme të punëve publike që i kanë në përgjegjësi e që janë në dobi të popullatës lokale²⁰⁷.

²⁰⁷ INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE Seria e kërkimeve politike STUDIMI #4
Qeverisja dhe administrata lokale në Kosovë: Analizë fq 59

Historiku dhe Konteksti i studimit empirik

Kjo anketë u realizua në mënyrë që të punimin e studime të Doktoraturës të bëjë më unikë dhe ti i pet ngjyrim i realitetit në të cilën ndodhet Politika Lokale në Vendete Evropës Juglindore, Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mali Zi²⁰⁸.

Për herë të parë, ne përdorëm mundësitë që ofron interneti për realizimin e anketimeve publike. Në një prej platformave të shumta që ofrojnë programe për anketim (ëëë.docs.google.com), ne koordinim të plotë me Mentorin vendosëm formularin e anketës, identik me atë që përdorëm ne terren dhe pastaj, përmes kanaleve të përshtatshme për komunikim (Facebook, listat e e-maileve, forumet).

Anketa që gjendej në formë elektronike, ofroi anonimitet të plotë për publikun e interesuar, ndërsa mundësitë e keqpërdorimeve ishin minimale fokus Grupi I kësaj ankete kanë Qytetarët e Vendeve të Evropës Juglindore, të cilët janë edhe pjesë e këtij hulumtimi ky pyetësor u realizua duke u kujdesur maksimalisht për respektimin e karakteristikave të komunitetit lokal (përfshirja territoriale, gjinore nacionale, etj.). Pyetësori ka qenë i hartuar nga 18 pyetje në të cilat janë përgjigjur gjithsej 596 qytetarë. I terë materiali i përdorur në procesin e anketimit ka qenë në gjuhë shqipe.

Përveç paraqitjes së gjendjes aktuale dhe identifikimit të mundësive për fuqizimin e pjesëmarrjes qytetare në nivelin lokal, ky publikim ka për qëllim të ndihmojë edhe nxitjen e dialogut në mes të palëve të interesuara në komunitetin lokal si dhe pjesëmarrjen e Qytetarëve në Vendimmarrje.

Rekomandimet të cilat ndodhen në fund të këtij publikimi paraqesin bazë të mirë për ndërtimin e një strategjie efikase për forcimin e pjesëmarrjes qytetare në procesin e hartimit, miratimit dhe implementimit të politikave publike në nivelin lokal.

Kjo anketë është realizuar në adresën elektronike²⁰⁹:

²⁰⁸E që në tekstin e më tejme do ti referohemi si vendet e EJJ

²⁰⁹https://docs.google.com/forms/d/1vKm8b01gbu6t_6rH7ED6rIBuNPxNh0KrEeSt2ZJ8Sds/edit

Pyetjet

1. Moshë?

Përgjigjet e qytetarëve të anketuar

Moshë 18-25	351 (60.5%)
Moshë 26-41	156 (26.9%)
Moshë 42-60	57 (9.8%)
Moshë 60+	16 (2.8%)

580




Fig 1

Në pyetjen e parë ku është paraqitur moshë e të anketuarave vërehet se nga gjithsej 596, anketues i janë përgjigjur gjithsej 580 qytetar dhe vërehet se të gjithë kanë qenë mbi moshën 18 vjeçare kjo ngase fokusi i realizimit të anketave ka qenë edhe një pjesë e studentëve të Universiteteve përfshirë edhe stafin administrative dhe atë akademik;

2. Gjinia

Përgjigjet e qytetarëve të anketuar

F	285	(49.1%)
M	296	(50.9%)
	581	




Fig 2

Në këtë pyetje I janë përgjigjur gjithsej 581 respondent nga 596 sa ishin gjithsej pjesëmarrja e gjinisë femërore ka qene e kënaqur pasi që dihet tashmë “ ***e ardhmja i takon gruas***”, dhe këtu vërehet qartë edhe ndikimi I ligjit për barazinë gjinore pasi që me anë të tij ka filluar edhe edukimi i pjesëmarrjes së femrës në Vendimmarrje po ashtu një pjesëmarrje e tillë e bënë edhe më cilësore këtë anketë.

3. Shtetësia ?

Përgjigjet e qytetarëve të anketuar

Shqiptare	44	(7.6%)
Kosovare	493	(85.1%)
Maqedone	33	(5.7%)
Mali zi	6	(0.12%)
Bosnjak	1	(0.3%)
Gjermane	1	(0.3%)
Kanadeze	1	(0.3%)

579




Fig 3


Në këtë pyetje I janë përgjigjur gjithsej 579 respondent nga gjithsej 596, Përfshirja e vendeve të Ejl ka qenë pjesërisht e kënaqur pasi që % nga anketuesit e Malit të Zi nuk ka qene e madhe kjo ngase nuk kemi pasur hapësirë që anketa jonë të shtrihet edhe në atë pjesë por me që fokusi kryesor është tek Republika e Kosovës mund themi se plotësohen kushtet minimale në këtë pjesë ku ndodhemi tani.

4.Komuna e juaj

Pjesmarrja e qytetarëve të anketuar-Komunat

1. Bogovinë	1 (0.2%)	17. Ohër	1 (0.2%)
2. Deçan	4 (0.8%)	18.OTTAVA	1 (0.2%)
3. Dragash	9 (1.7%)	19. Viti	2 (0.4%)
4. Drenas	2 (0.4%)	20. Podujevë	1 (0.2%)
5. Ferizaj	1 (0.2%)	21. Prishtinë	80 (14.4%)
6. Fushkosove	2 (0.4%)	22. Prizren	124 (21.05)
7. Gjakovë	4 (0.7%)	23. Rahovec	(3.1%)
8. Gjilan	27 (4.9%)	24. Shkup	21 (3.8%)
9. Gostiva	1 (0.2%)	25. Shtime	1 (0.2%)
10. Istog	2 (0.4%)	26. Skenderaj	1 (0.2%)
11. Kaçanik	1 (0.2%)	27. Strugë	1 (0.2%)
12. Kamenice	2 (0.4%)	38. Suharekë	20 (4.4%)
13. Klinë	2 (0.4%)	29.TETOVË	1 (0.2%)
14. Lipjan	8 (1.5%)	30. Tiranë	16 (2.9%)
15. Malishevë	6 (1%)	31. Tivarë	1 (0.2%)
16. Pejë	14 (2.9%)	32. Ulqin	8 (1.4%)

554



Në këtë pyetje I janë përgjigjur gjithsej 554 respondent nga gjithsej 601, nga të cilët 145 apo 26.2% nuk kanë deklaruar komunën nga e cila vijnë. Dhe me këtë rast anketa bëhet edhe më objektive ndonëse për shkak se një pjesë e tyre konsiderojnë se mos deklarimi I Komunës në të cilën vijnë paraqet më shumë ruajtjen e identitetit të tyre dhe nën petkun e saj mund të jenë më objektiv në dhënien e mendimeve siç edhe vërehet Brenda këtij pyetësi.

5. Niveli arsimor?

Përgjigjet e qytetarëve të anketuar

Fillor	12	(2.2%)
Mesëm	35	(6.3%)
Universitar	383	(68.8%)
Pasuniversitar	80	(14.4%)
Dr	44	(7.9%)
Tjerë	2	(0.4 %)
Gjithsej	557	




Fig 5

Në këtë pyetje I janë përgjigjur gjithsej 557 respondent nga gjithsej 601, dhe dukshëm mund të themi se ngritet niveli i anketës përshkak të një pjesëmarrje kaq të madhe të anketuarve me përgatitje Universitare, njëherit vërehet edhe interesimi I qytetarëve për të shprehur mendimin. Nga gjithsej 557 anketues të përgjigjur pjesëmarrja e Dr. të shkencave është në 44 persona apo 7.9% me këtë mund të konsiderohet se rekomandimet e daluara nga ana tyre mund të ndihmojnë edhe në përmirësimin e Qeverisjes Lokale në vendet e Ejl, duke dhënë mendime profesionale, shkencore në këtë fushë.

6. Sa jeni ju personalisht i interesuar për atë që ndodhë në komunitetin lokal

Përgjigjet e qytetarëve të anketuar

Shumë i interesuar	186 (33.4%)
Kryesisht i interesuar	325 (58.3)
I pa interesuar	27 (4.8%)
Krejtësisht i pa interesuar	15 (2.7%)
Tjetër	15 (2.7)




Fig 6

Që qytetarët tonë janë të interesuar për ngjarjet në komunitet, tregon edhe rezultati se gati 3/4 e të anketuarve janë shumë ose kryesisht të interesuar për atë se çfarë ndodhë në komunën e Ulqinit (43% shumë të interesuar dhe 30% kryesisht të interesuar). Përqindja e atyre që janë më pak të interesuar ose që janë krejtësisht të pa interesuar për ngjarjet në komunitetin lokal, arrin në 27% të të anketuarve (14% kryesisht të pa interesuar dhe 13% krejtësisht të pa interesuar). Rezultatet tregojnë se tri të katrat e qytetarëve janë të interesuar për zhvillimet në komunitetin lokal. Por megjithatë, një analizë më e hollësishme do të tregonte se përse 27% e qytetarëve janë të pa interesuar për atë që ndodhë në komunën e tyre. Për këtë, pushteti lokal duhet të angazhohet më shumë dhe t'i sigurojë qytetarët që komuna është themel i demokracisë lokale

dhe se në të vërehet fuqia e gjithë qytetarëve të saj. "Vetëqeverisja lokale përfshinë të drejtën e qytetarëve dhe të organeve të vetëqeverisjes lokale, që të rregullojnë dhe administrojnë punët e caktuara publike dhe të tjera, nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të popullatës lokale"(neni 1 i Ligjit për vetëqeverisjen lokale) ; "Në komunë realizohet përmbushja e nevojave me interes të drejtpërdrejt dhe të përbashkët për popullatën lokale" (neni 4 i Ligj Vetëqeverisjen lokale).

7. Nga cilat burime informoheni kur dëshironi të dini se çfarë ndodhë në Komunën tuaj?

Përgjigjet e qytetarëve të anketuar

Në rrjete Sociale	290 (51.7%)
Shërbime përkatëse të Komunës ueb faqja	69 (12.3%)
Televizion lokal,gazete, radio	180 (32.1%)
Nuk jam i interesuar	19 (3.4%)
Gjithsej	558




Fig 7

Në këtë pyetje I janë përgjigjur gjithsej 558 respondent nga gjithsej 601, dhe një përqindje prej 51.7 % apo 290 qytetar informohen përmes rrjeteve sociale, dhe një % e tillë nuk është e kënaqshme për faktin se Krerët e komunave më shumë i kanë dhënë rëndësi publicitetit “Vetë reklamimit”, se interes të përgjithshëm. Vlen të theksohet se Shumica e krerëve të Komunave në të cilat është realizuar pyetësori kanë të sponzorizuara rrjetet sociale. Dhe për mbajtjen e tyre shpenzojnë mjete vetanake dhe të institucionit. Ndërsa nga respondentet një përqindje simbolike prej 12.3% apo 69 të anketuarve marrin informacione nga ueb faqet zyrtare. Pjesa tjetër prej 32.1% apo 180 të anketuarve punën e Komunës së tyre e shohin në mjete të nivelit lokal. Si dhe 3.4% apo 19 respondent nuk janë të interesuar fare që të përcjellin punën e Komunës së tyre.

8. A keni marrë pjesë (në 3 vitet e fundit) në aktivitete siç janë Iniciativat Qytetare?

Përgjigjet e qytetarëve të anketuar

Jo	328 (57.9%)
Po	197 (35.1%)
Nuk jam interesuar	36 (6.4%)
Tjetër	3 (0.5%)
Gjithsej	561




Fig 8

Në këtë pyetje I janë përgjigjur gjithsej 561 respondent nga gjithsej 601. Vlen të theksohet fakti se është shqetësues numër i vogël I qytetarëve në realizimin e demokracisë së drejtpërdrejtë pasi që një numër I madh I qytetarëve nuk kanë marrur asnjëherë pjesë në vendimmarrje në nivel komunal. Dhe kjo është edhe njëri ndër indikatorët se puna e organeve të nivelit lokal nuk është shumë transparente ngase sa më larg qytetarët nga vendimmarrja aq më e vogël është edhe llogaridhënia.

9. A keni nënshkruar ndonjë Peticion në Komunën tuaj?

Përgjigjet e qytetarëve të anketuar

Asnjëherë	251	(45.2%)
Disa herë	196	(35.3%)
Njëherë	100	(18%)
Tjetër	6	(1.1%)
Gjithsejtë	555	




Fig 9

Në pyetjen e realizmit të demokracisë së drejtpërdrejtë dhe në qytetari aktive mund të konkludojmë që në pjesën më të madhe të komunave kanë filluar shkënditë para të pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën publike kjo do të shërbejë në masë të caktuar në rritjen e parimit të efikasitetit dhe do të ndihmojë drejtë një qeverisje më të mirë dhe në të mirë të qytetarëve.

10. Për çfarë çështjeve do të dëshironit që Komuna (Qeverisja lokale) t'ju konsultonte – të merrte mendimin tuaj?

Përgjigjet e qytetarëve të anketuar

Infrastruktura (rrugët, ndriçimi) etj.	141 (25%)
Problemet komunale (parkingjet, ko...	95 (16.8%)
Ujësjiellësi, kanalizimi, mbrojtja e a...	56 (9.9%)
Problemet e të rinjve	245 (43.4%)
Nuk dëshiroj të më konsultojnë	9 (1.6%)
Gjithsej	564




Fig 10

Në këtë pyetje jemi munduar që të marrim informata se në cilat se në cilat çështje Komuna duhet të kërkojë mendimet e qytetarëve në seancat e dëgjimeve publike mund të aludojmë se pjesa më e madhe e infrastrukturës në Komunat e Kosovës tashmë është në zgjidhjen e problemeve. Por ajo që mbetet sfidë janë problemet e të rinjve e që kryesisht janë problem sociale dhe lidhen me themelimin e marrëdhënieve të punës.

11. A merrni pjesë (ju personalisht) në tubimet që organizon Komuna me qytetarë?

Përgjigjet e qytetarëve të anketuar

Nganjëherë	286 (51.1%)
Shpesh	44 (7.9%)
Asnjëherë	142 (25.4%)
Nuk di për takime të tilla	83 (14.8)
Tjetër	3 (0.5%)
Gjithsej	560



Fig 11

Në këtë pyetje jemi munduar që të marrim informata në lidhje me takimet të cilat i realizojnë Komunitat me qytetar në mënyrë që të jenë me afër qytetarëve apo realizimit të parimit të subordinimit të pushtetit. Interesimi i qytetarëve në shumicën e komunave kemi filluar një ngritje të vogël të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje ajo që mbetet për të bërë mendohet se është shtimi i kampanjave informuese për të drejtat e tyre në raport me Komunitat.

12. Sipas mendimit tuaj, a është “e drejta e qytetarëve që të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal” e garantuar me ligj apo është çështje që e vendos Qeverisja lokale?

Përgjigjet e qytetarëve të anketuar

Çështje që e vendos Kryetari i Komunës	88 (15.9%)
E garantuar me Kushtetutë dhe ligj	306 (55.3%)
Nuk e di	149 (26.9%)
Tjetër	10 (1.8%)
Gjithsej	553




Fig 12

Në këtë pyetje jemi munduar që të informohemi në lidhje me të drejtën e qytetarëve për tu informuar me vendimet e Kryetarit. Dhe mund të themi se në shumica dërmuese e qytetarëve kanë filluar që të kuptojnë pozicionin e vetë karshi Komunës. Kjo ngase më parë qytetarët kanë pasur mundësi të informohen vetëm në fushatat zgjedhore dhe një pjesë e tyre kanë qenë të ndarë në grupime të ndryshme politike. Shqetësuese tek kjo pjesë është se mbetet një pjesë prej 26% apo 149 anketues nuk kanë fare informatë dhe nga kjo pjesë na del një rekomandim shtesë që krerët e komunave duhet të bashkëpunojnë edhe me afër me qytetarët për mes Kryetarëve të fshatrave e me të cilët rrallë herë mbajnë takime.

13. A do të ndikojë negativisht Asociacioni i Komunave Serbe ne Kosovë?

Përgjigjet e qytetarëve të anketuar

Shumë	351 (63.2%)
Pjesërisht	156 (27.9)
Aspak	26 (4.7)
Tjetër	16 (2.9%)
Gjithsej	549




Fig 13

Ajo që mbetet enigmë dhe peng i shumë proceseve të rëndësishme për Kosovën përfshirë edhe çështjen e dialogut me Serbinë është çështja e asociacionit të komunave me shumicë serbe, madje, madje në këtë kontekst çështja e zgjidhjes së statusit final të Kosovës është lidhur edhe me asociacionet e komunave. Për palën serbe asociacioni i Komunave është “Mundësi për integrimin e tyre në shoqëri dhe do të ndikojë në tërheqjen e strukturave paralele serbe”. Ndërsa shumica e qytetarëve të përfshirë në këtë pyetësor e kanë parë sitë rrezikshme dhe kundër kushtetuese pasi s’i tillë edhe cenon sovranitetin e shtetit të vendit madje ata frikësohen se Asociacioni më vonë do të shndërrohet në një “Krijesë” të rrezikshme dhe të ngjashme me atë të Republikë Serbe të Bosnjës. Por në anën tjetër Qeveri a tanishme është zotuar se do të themeloj asociacionin në kuadër të frymës Kushtetuese dhe rekomandimeve nga Gjykata Kushtetuese.

14. Me krijimin e Asociacionit të komunave Serbe ne Kosovë, Qeveria do të shtrij autoritetin e vetë edhe në atë pjesë të territorit?

Përgjigjet e qytetarëve të anketuar

Po	129 (23.2%)
Jo	134 (24.1%)
Do ta humb edhe më shumë kontrollin	256 (46%)
Tjetër	35 (5.9%)
Nuk e di	
Gjithsej	556




Fig 14

Me krijimin e asociacion të komunave serbe në Kosovë vërehet se Pjesa më e madhe e respondentëve në një përqindje prej 46% mendojnë se Krijimi i një asociacioni të tillë vetëm sa do humb ndikimin dhe shtrirjen e autoritetit në komunat me shumicë serbe kjo ngase asociacioni do të krijonte pavarësi financiare dhe rritja investimeve nga shteti fqinjë (Serbia), do të bëjë orientimin e politikave zhvillimore në këto komuna. Dhe kjo do të ndikonte edhe rritjen e konflikteve ndër etnike brenda Republikës së Kosovës.

15. A ka ndërhyrje në punën e komunës suaj nga niveli Qendror ?

Përgjigjet e qytetarëve të anketuar

Pjesërisht	310 (56.5%)
Shumë	87 (11.3%)
Aspak	62 (11.3%)
Pak	50 (9.1%)
Tjetër	25 (4.6)
Gjithsej	534




Fig 15

Në këtë pyetje jemi munduar të intensifikojmë ndikimin e politikave publike nga niveli qendror në atë lokal dhe me të drejtë kemi arritur të kuptojmë se në Kosovë ka dukshëm pavarësi nga ana e pushtetit lokal, kjo për faktin se nga anketat e realizuara nga enti i statistikave në periudhën pas shpalljes së Pavarësisë në vitin 2008 ka pasur ndikim të jashtëzakonshëm. Por me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Kosovës një kapitull i posaçëm brenda kësaj kushtetute i është kushtuar Vetëqeverisjes lokale dhe parimeve të mëvetësisë në vendimmarrje. Por që vërehet edhe nga përgjigjet e respondentëve që ka një ndërhyrje të pjesërishtë e që më të drejtë mund të konkludojmë se kjo mund të jetë më shumë një koordinim i punëve ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal.

16. Si do ta vlerësonit punën e kryer nga Kryetari i Komunës suaj?

Përgjigjet e qytetarëve të anketuar

Pjesërisht	195 (30.1%)
Shumë mirë	98 (17.7%)
Mirë	198 (35.7%)
Shumë keq	43 (7.7%)
Tjetër	11 (2%)
Gjithsej	545




Fig 16

Në këtë pyetje jemi munduar ti i pet përgjigje edhe pozitës së qytetarit për të vlerësuar punën e Përfaqësuesve të vetë në nivel komunal dhe nga rezultatet e sipërshënuara mund të konkludohet që kemi rritje të vetëdijes së një qytetarie aktive pasi që një pjesë e madhe e qytetarëve përcjellin punën që bëhet nga përfaqësuesit komunal dhe madje tejkalojnë dallimet partiake pasi që nga 545 respondentë sa i janë përgjigjur kësaj pyetje vërehet kjartazi edhe efikasiteti i punës së kryetarëve në komunat që kanë qenë target i këtij hulumtimi. Dhe me kënaqësi këtë hulumtim te kjo pjesë do të mundohem që ta vazhdojë në kontinuitet dhe të analizojë edhe këtë rezultat me zgjedhjet të cilat do të mbahen ne 2020 në Kosovë.

17. Problemet kryesore në funksionimin e Qeverisjes lokale shkaktohen nga?

Përgjigjet e qytetarëve të anketuar

Faktori ndërkombëtar	13 (2.4%)
Partitë politike	261 (47.5%)
Paaftësia e qeverisjes	245 (44.5%)
Asnjëra	9 (1.6%)
Gjithsej	528




Fig 17

Te kjo pyetje është më se e dukshme se në Vendet e Evropës Juglindore problemet në keq qeverisje kryesisht janë të karakterit politik dhe të qarjeve të subjekteve politike shqiptare kjo ndikon pastaj edhe në paaftësinë në qeverisje pasi që në shumicën e subjekteve politike mbetën ende struktura të cilat edhe i kanë themeluar këto subjekte dhe vendimmarrja mbetet në duar të tyre.

18. Organizimi dhe funksionimi i vetëqeverisjes lokale në Kosovë në të ardhmen duhet të përqendrohet në zhvillimin ekonomik rural dhe mbrojtjen e ambientit jetësor veçmas në qytete (Oazat e gjelbërta, hapësira publike, menaxhimi tokës ndërtimore etj)?

Përgjigjet e qytetarëve të anketuar

Pajtohem plotësisht	462 (81.2%)
Nuk pajtohem	68 (12%)
Tjetër	30 (5.3 %)
Gjithsej	560




Fig 18

Kjo intervistë përmbyllet me pyetjen se në cilën pjesë do të orientohet politika lokale dhe ajo që është për tu admiruar se mbi 81.2 %, apo 462 % e të anketuarve janë të orientuar në menaxhimin e resurseve njerëzore dhe investimet në ta ardhmen duhet të orientohen në rregullimin e infrastrukturave dhe modernizimin e qyteteve. Pasi që tashmë rrugët dhe infrastruktura përcjellëse veçse është përfunduar.

+

Konkluzionet

- Siç është pritur, duke e marrë parasysh rëndësinë e temës, debatet e shumta televizive në lidhje vetëqeverisjen lokale si dhe me asociacionin e Komunave Serbe në Kosovë kanë shkaktuar diskutime të mëdha edhe pasiguri tek qytetarët në humbjen (Kufizimin) e sovranitetit në pjesën veriore të Kosovës.
- Shumica e të anketuarve janë pajtuar për shumë çështje kryesore, ku qëndron qeverisja lokale në raport me prioritetet e tjera të shoqërisë, cilat institucione kanë kompetencë për ta miratuar decentralizimin dhe kur pritet të ndodhë megjithatë, qëndron në trendin e përgjithshëm të pjesëmarrjes së vogël të publikut në Kosovë.
- Organizimi i vetëqeverisjes lokale në Evropën Juglindore, përcillet me një mori problemesh.
- Vetëqeverisja lokale në Republikën e Shqipërisë, që nga 20015 ka filluar organizimin e ri, në dy nivele, në nivel Bashke dhe Qarku.
- Vetëqeverisja lokale në Republikën e Shqipërisë përcillet me një varg problemesh si financiare, infrastrukturore etj.
- Vetëqeverisja lokale në Republikën e Shqipërisë përcillet me një komunikimi dhe rrjedha e informatave ndërmjet administratës komunale dhe qytetarëve te komunat rurale është shumë i kufizuar.
- Vetëqeverisja lokale në Republikën e Shqipërisë ka filluar fazën e digjitalizimit.
- Vetëqeverisja lokale në Republikën e Shqipërisë, përcillet me nepotizëm.
- Harmonizimin i parimeve të vetëqeverisjes lokale me kartën Evropiane ende nuk është përfunduar.
- Parimi i llogaridhënies ende nuk ka arritur nivel i duhur sipas hulumtimeve në teren
- Pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje është e vogël, ngase shoqërohet me pasiguri.
- Pjesëmarrja e femrës në vetëqeverisjen lokale mbetet e vogël.
- Vetëqeverisja lokale në Republikën e Shqipërisë, faza e decentralizimit është përcjell me një varg problemesh politike, ekonomike etj.

- Vetëqeverisja lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përcillet me probleme etnike.
- Vetëqeverisja lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përcillet me probleme të mëdha në shpërndarjen e financave nga niveli qendror.
- Pjesëmarrja e femrës në vetëqeverisje lokale është shumë e vogël.
- Vetëqeverisja lokale në Republikën Vetëqeverisja lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, është përcjellur me shumë problem tek decentralizimi i mbrojtjes sociale.
- Vetëqeverisja lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, shoqërohet edhe me mungesën e strategjive për kompetenca lokale.
- Vetëqeverisja lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, nuk është e ndërtuar mbi bazën e parimit të inkuadrimin të pakicave.
- Vetëqeverisja lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ballafaqohet edhe me problemet për përdorimin e ligjit për gjuhët zyrtare.
- Vetëqeverisja lokale në Republikën e Malit të zi, është harmonizuar me Kartën Evropiane.
- Legjislacioni i vetëqeverisjes lokale në Malin e Zi, është ndryshuar nga viti 2017.
- Vetëqeverisja lokale në Republikën e Malit të Zi, nuk mbështet avancimin e komuniteteve.
- Vetëqeverisja lokale në Republikën e Malin e zi, përballlet me probleme në ndarjen e buxhetit për komunat Shqiptar.
- Përcjellja e aktiviteteve komunal paraqet pa gatishmërinë eqë njerëzit ti ndjekin ngjarjet në nivel lokal.
- Për atë se shumica shprehen se zëri i tyre edhe ashtu nuk do të dëgjohet dhe se mundësia për të bërë ndryshime nuk është në duart e tyre.
- Kjo është pjesërisht për shkak të faktit se vendeve të EJT ju mungon tradita demokratike e pjesëmarrjes së publikut, dhe se qytetarët janë shoqërizuar në një sistem relativisht teknokratik, ku opinionet e njerëzve të rëndomtë rrallë janë kërkuar drejtpërsëdrejti.

- Kjo në fakt është vënë në pah në këtë anketë, ku shumë pjesëmarrës kanë shprehur dyshimin rreth mundësisë së tyre të shqyrtojnë çështjet e qeverisjes lokale, duke parapëlqyer që çështjet e tilla t'i lejnë në duart e “ekspertëve”.
- Një shkak tjetër i pjesëmarrjes së vogël – që shpesh është përsëritur edhe në debate publike – është se nga këndvështrimet e njerëzve, fuqia e vërtetë politike është në duart e politikës, dhe jo në duart e kuadrove profesionale.
- Krijimi i komunave të reja veçanërisht në Kosovë është bërë pa ndonjë përmbushje të standardeve ndërkombëtare dhe analizave të mirëfillta financiare, kjo ngase është dashur të krijohen Komunitatet veriore në Kosovë.
- Po ashtu kemi arritur në konkluzion se pjesëmarrja e femrës në përfaqësim lokal është në masë shumë të vogël. Në Kosovë nga 38 komuna asnjëra nga to nuk përfaqësohet nga Kryetare femër madje me vetëm 1 grua nënkryetare është nga radhët e gjinisë femërore. Po thuajse ky trend është i ngjashëm edhe në vendet e EJT.
- Shumica e të anketuarve janë të mendimit se problemet kryesore të qeverisjes lokale janë edhe ndërhyrjet nga politika e nivelit Qendror në atë lokal dhe nga paaftësia për qeverisje.
- Kjo ngase edhe për shkak të ndërhyrjeve financiare nga Pushteti Qendror.
- Ligjet relevante për fushën e vetëqeverisjes lokale në Kosovë nuk kanë qartësuar me dispozitë të veçantë ligjore mënyrën e themelimit të komunave të reja. Baza e vetme ligjore është Ligji për Kufijtë Administrativ të Komunave. Kjo bazë ligjore nuk krijon qartësi sa i përket kriterëve për themelimin e komunave të reja, e as si duhet të vazhdohet me kërkesën dhe në cilin institucion duhet dorëzuar atë.

REKOMANDIMET

- Krijimi i komunave të reja të bëhet kryesisht në bazë të arsyeshmërisë ekonomike dhe të shikohet mundësia e futjes së referendumit lokal si formë e vendosjes në këtë proces.
- Të mos shqyrtohen kërkesat e Qeverive e veçanërisht ajo e Kosovës për ndryshim të ligjeve në fuqi për vetëqeverisjen lokale, me qëllim që t'i hapet rrugë krijimit të komunave të reja, nëse një kërkesë e tillë nuk shoqërohet edhe me një studim të detajuar për nevojën e krijimit të komunës së re dhe vlerësimin financiar.
- Duke krijuar hapësirë në Komuna që udhëhiqen nga Kryetarët meshkuj, nënkryetari të jetë i gjinisë femërore dhe anasjelltas të aplikohen në të gjitha vendet e Evropës Juglindore.
- Pavarësisht se ligji për barazinë gjinore promovon dhe krijon mundësi të barabarta për pjesëmarrjen e femrës në vendimmarrje nga ky studim konkludojmë se hartuesit t'i hartojnë politikat e tyre duke u bazuar në barazinë gjinore dhe të marrin masa dhe t'i ndërmarrin aktivitetet e nevojshme për krijimin e mundësive të barabarta për femra dhe meshkuj.

Të bëhet decentralizimi proporcional i financave lokale në mënyrë që komunat të jenë më efektive në menaxhimin e buxhetit të tyre në përputhje me dinamikën e planeve të punës apo edhe të planifikimit të qëndrueshëm të planeve zhvillimore. Komunat duhet të rrisin kapacitetet e tyre për të kontribuar më shumë në buxhetin e tyre.

- Autonomia e VQL nuk mund të konsiderohet e qëndrueshme me një përqindje mesatare prej 82% të buxhetit të varur nga Qeveria e Republikës së Kosovës.
- Duhet të krijohen mekanizma institucional për investimet kapitale në komuna, të bazuar në parimin e mos-diskriminimit (Politik), etnik.

- Të zhvillohen plane konkrete për të rritur aktivizmin qytetar, për të përfshirë qytetarët në jetën publike dhe për t'i ndërgjegjësuar ata për mekanizmat e kontrollit dhe llogaridhënies komunale.
- Përmes planeve konkrete për nxënësit e shkollave dhe kategorive tjera shoqërore, të kultivohet ndjenja e vullnetarizmit në mënyrë që qytetarët të ndihen pronarë të proceseve në komunat e tyre.
- Të zhvillohen plane konkrete për zhvillimin dhe shfrytëzimin e diversitetit kulturor, natyror dhe gjuhësor në funksion të rritjes së kohezionit social e kulturor, të zhvillimit të turizmit kulturor, ekoturizmit dhe zhvillimit ekonomik lokal.
- Të krijohet një sistem efektiv, ndërveprues dhe bashkëpunues, i komunikimit të brendshëm dhe i komunikimit të jashtëm ndërmjet strukturave organizative brenda nivelit lokal, si dhe atë qendrorë në përgjithësi.
- Ti kushtohet më shumë hapësirë publikimit të aktiveteve komunale në ueb faqen zyrtare.
- Komunat e vogla me numër të banorëve më të vogël dhe vendbanime rurale kanë nevojë urgjente për ngritje të vetëdijes së komunitetit lokal për rëndësinë e përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrjen lokale. Kjo duhet vlejë edhe për strukturat udhëheqëse dhe administratën komunale nga njëra anë, edhe për qytetarët nga ana tjetër.
- Duhet të kjustësohet mënyra e komunikimit ndërmjet qytetarëve dhe administratave komunale dhe përfshirjes së mirëfilltë të qytetarëve në vendimmarrjen lokale.
- Komunat duhet të bëjnë këmbimin e praktikave të mira për modelet dhe teknikat e pjesëmarrjes së qytetarëve të cilat i zbatojnë. Kjo do të rriste edhe aktivizmin qytetar.

- Krerët e komunave duhet të sigurojnë buxhet për të mbuluar shpenzimet e qytetarëve në vendimmarrje. Përfshira e qytetarëve duhet të jetë praktikë e obliguar e jo të ketë varësi financiare nga donacionet e huaja.
- Kryeqyteti por edhe qytetet e mëdha duhet të përfshijnë bashkësitë e tyre urbane në një mënyrë sa më aktive. Në mënyrë që të rritet mundësia e banimeve më të largëta për pjesëmarrje dhe cilësi të vendimeve që merren.
- Komunitat të ofrojnë zyrë për krerët e fshatrave në mënyrë të përafrimit të kontakteve me vende rurale.
- Respektimi i rolit të opozitës duke ju ofruar edhe zyrë të veçantë.
- Krijimi i kontakteve me organizatave jo qeveritare, dhe rritja e bashkëpunimit me to në nivel lokal.
- Të organizohen referendume në nivel lokal në mënyrë që të rritet aktivizimi qytetar në vendimmarrje.
- Të ndahen mjete financiare për OJQ, lokale në përputhje me standardet ndërkombëtare për OJQ.
- Të bëhet ndarja e punëve në nivel lokal mbi bazën e parimit të mëvetësisë dhe efikasitetit
- Modernizimi i komunikimit me qytetar, dhe përmirësimi i tyre në masë të nevojshme të shoqëruara me analiza të politikave publike.
- Sistemet lokale për këmbimin e informatave me qytetarët duhet të përmirësohen dhe të modernizohen.
- Të gjitha vendimet komunale dhe informatat e rëndësishme duhet të publikohen në mënyrë elektronike në ueb-faqet zyrtare të komunave.

- Administrata komunal ti ofrojë shërbimet mbi bazën e parimit të efqiencës.
- Qeveria e Kosovës duhet të ofrojë një bazë të qartë ligjore për themelimin e komunave të reja. Kjo do të mund të bëhej në dy mënyra: përmes plotësim-ndryshimit të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjit për Kufijtë Administrativ të Komunave (të cilët janë paraparë për plotësim ndryshim këtë vit), ose përmes nxjerrjes së një akti nën ligjor vetëm për këtë problematikë;

Bibliografia

1. "Analizë e Funksionimit të Vetëqeverisjes Lokale në Kosovë", Prishtinë, 2013
2. "Analizë, ndryshimet ligjore të sistemit të vetëqeverisjes lokale në Kosovë", Prishtinë, 2012,
3. Abdullai, Jonuz, (2011), Politika dhe politikat publike, Tetovë
4. ASK: "Popullsia sipas Gjinisë, Etnicitetit dhe Vendbanimit", Prishtinë, 2011
5. Banka Botërore: "Evropa Juglindore Raporti i Zhvillimeve Ekonomike", Prishtinë, 2012.
6. Begolli, Fetije "Zyrtare e lartë për Menaxhimin e Buxheteve Komunale në MAPL", Prishtinë, 07.08.2013.
7. Bowman, Ann O'M., and Richard C. Kearney. State and local government. Cengage Learning, 2012.
8. Brochure "MEET LOCAL AND REGIONAL SELF-GOVERNMENT IN CROATIA", Publisher by Union of the Association of Cities / Toëns and Association of Municipalities of the Republic of Croatia
9. Council of Europe Publishing: "European Charter of Local Self – Government", March 2010.
10. Government." The Kosovo Decentralization Briefing Book (2007): 50-59.
11. Gjoni, Roland, Anna Èetterberg, and David Dunbar. "Decentralization as a conflict transformation tool: The challenge in Kosovo." Public Administration and Development 30.5 (2010): 291-312.
12. https://www.ecoi.net/file_upload/225_tmpphpiVo2M.pdfhttps://www.ecoi.net/file_upload/225_tmpphpiVo2M.pdf
13. Kadri, Kryeziu, Administrimi Lokal, cikël leksionesh 2015
14. Kadri, Kryeziu, E drejta Kushtetuese e krahasuar 2017
15. Kadri, Kryeziu, Edrejta e Zgjedhjeve 2013

16. Kadri, Kryeziu, Prizreni Qytet Shtet Perfektur, 2014
17. Këshilli Evropës: “Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale”, 1985
18. Kurtesh Salii, E drejta Kushtetuese (Kapitulli për Vetëqeverisjen Lokale), Prishtinë, 2001.
19. Kushtetuta e Kosovës (2008)
20. Kushtetuta e Malit të Zi
21. Kushtetuta e Maqedonisë veriore
22. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë (“Gazeta zyrtare” nr. 52/91
23. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
24. LAW ON LOCAL SELF-GOVERNMENT
https://www.ecoi.net/file_upload/225_tmpphpiVo2M.pdf
25. Ligji nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale.
26. Ligji për Bashkëpunim Nder-komunal Nr. 04/L-010
27. Ligji për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr. 04/L-144
28. Ligji për Financat e Pushtetit Lokale Nr. 03/L-049
29. Ligji për Kufijtë Administrativ Nr. 03/L-041
30. Ligji për qasje të lirë në informacione me karakter publik (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 13/2006, nr. 86/08, nr. 06/10, nr. 42/14, nr. 148/15)
31. Ligji për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare” nr. 5 /01)
32. Ligji për Zgjedhjet Lokale Nr. 03/L-072
33. MAPL: “Raport i Vlerësimit të Kapaciteteve në Komuna”, Prishtinë 2011
34. Marcou, Gerard. "Legal Framework and the European Charter of Local Self 4
35. Pollozhani, Bajram & Dobjani, Ermir & Stavileci, Esat & Salihu, Lazim: “E drejta administrative—aspekte krahasuese”, 2010
36. Prof.Dr.Arsim Bajrami, Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2011.
37. Qendra e Publikimeve Zyrtare: “Përmbledhje legjislacioni për pushtetin vendor”, Nëntor 2010

38. Udhëzimi Administrativ 2008/10 për Organizimin dhe Funksionimin e Komiteteve Konsultative në Komuna.
39. Udhëzimi Administrativ Nr. 2007/06 Për Procedurën e Paraqitjes dhe Vlerësimit të Kërkesave për Transport Humanitar me autobus.
40. Udhëzimi administrativ Nr. 2007/07 për Kufizimin e Veprimtarisë Politike të Shërbyesve Civil Komunal.
41. Udhëzimi Administrativ Nr. 2008/01 Për Përdorimin e automjeteve Zyrtare në Komuna.
42. Udhëzimi Administrativ Nr. 2008/08 Për Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Komunave më fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.
43. Udhëzimi Administrativ Nr. 2009/01 për Procedurën e Zgjedhjes dhe Përgjegjësitë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.
44. Udhëzimi Administrativ Nr. 2009/03 për përdorimin e automjeteve dhe telefonave fiks dhe mobil nga anëtarët e Ekipeve Përgatitore Komunale.
45. Udhëzimi Administrativ Nr. 2009/04 për Udhëtime Zyrtare Anëtareve të EPKve.
46. Udhëzimi Administrativ Nr. 2010/01 për Kufizimin e Kompensimit dhe Marrjes së Pagesës nga Zyrtaret Komunal.
47. Udhëzimi Administrativ Nr. 2010/03 për Procedurën e Përfundimit të Mandatit të Kryetarit të Komunës.
48. Udhëzimi Administrativ Nr. 2011/03 për Organizmin dhe Funksionimin e Qendrave të Shërbimeve të Qytetareve në Komuna.
49. Udhëzimi Administrativ Nr. 2011/04 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit 2011/01 për Themelimin e Njësive për të Drejtat e Njeriut në Komuna.
50. Udhëzimi administrative Nr. 2005/05 Mbi Menaxhimin dhe Shfrytëzimin e Objekteve Publike Komunale.
51. Udhëzimi Administrative Nr. 2007/08 për Themelimin e Njësive për të Drejtave të Njeriut në Komuna.
52. Udhëzimi Administrative Nr. 2008/01 për Ndryshimin e UA MAPL Nr. 2007/04 “ Për formën dhe strukturën e shkresave në komunikim zyrtar të MAPL-së.

53. Udhëzimin Administrative Nr. 2008/04 Për Ndryshimin e UA Nr 2005/07 për Zbatimin e Përgjegjësive të MAPL-së në lidhje më monitorimin dhe mbikëqyrjen e komunave.